FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 91

Tiranë – E enjte, 22 qershor 2023

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 360, datë 16.6.2023	Për një ndryshim në vendimin nr. 543, datë 29.9.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për kompensimin financiar të pronarëve të pasurive të paluajtshme, që preken nga ndërtimet e legalizuara"	9653
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 362, datë 16.6.2023	Për një shtesë në vendimin nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, "Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit", të ndryshuar	9653
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 363, datë 16.6.2023	Për disa shtesa në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara", të ndryshuar	9654
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 365, datë 16.6.2023	Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve dhe punonjësve të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare	9658
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 366, datë 16.6.2023	Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Sigurisë Ushqimore 2023–2027	9660
Udhëzim i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 8, datë 2.5.2023	Për një ndryshim në udhëzimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 3, datë 20.6.2019, "Për miratimin e procedurës së lehtësuar të autorizimit për lidhjen në sistemin e shpërndarjes të projekteve të vogla të rinovueshme për vetëprodhuesit e energjisë elektrike nga dielli"	9682
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtat të Njeriut datë 22.5.2023	Çështja Nikëhasani kundër Shqipërisë *(kërkesa nr. 58997/18)*	9682
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 26, datë 16.5.2023	Me objekt ndreqjen e gabimit në vendimin nr. 31, datë 3.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese	9708

Vendim i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 328, datë 14.6.2023	Për një ndryshim dhe shtesë në vendimin nr. 271, datë 25.5.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, "Për fillimin e funksionimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë të riorganizuar".....	9710
Urdhër i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale nr. 81, datë 16.6.2023	Për delegim kompetence.....	9710
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 9097/1, datë 13.6.2023	Për korrigjimin e datës së hyrjes në fuqi të disa marrëveshjeve ndërkombëtare.....	9711
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 107/5, datë 16.6.2023	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikonstruksioni i rrugës 'Kastriot Muço' (nga kryqëzimi me rrugën 'Mujo Ulqinaku', deri në intersektin me hekurudhën) Fier".....	9711
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 377/6, datë 14.6.2023	Për disa shtesa në VKM-në nr. 866, datë 27.12.2022, "Për shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor 'Sistemim, asfaltim e masa inxhinierike në km 21+050-22+050 në rrugën Qafëthanë–Lin–Pogradec'".....	9714
Vendim i shkurtuar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë nr. 1447, datë 15.6.2023	Me objekt për fillimin e procedurës së falimentimit.....	9714
	Kërkesë për shpalljen e vdekjes së shtetases Violeta Shqevi.....	9716

VENDIM
Nr. 360, datë 16.6.2023

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 543, DATË 29.9.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KOMPENSIMIN FINANCIAR TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, QË PREKEN NGA NDËRTIMET E LEGALIZUARA"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nenit 24, të ligjit nr. 20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", dhe të nenit 10, të ligjit nr. 133/2015, "Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 543, datë 29.9.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për kompensimin financiar të pronarëve të pasurive të paluajtshme, që preken nga ndërtimet e legalizuara", anulohet kompensimi për pasurinë nr. 14/207, në zonën kadastrale 8601, Vlorë.

2. Ngarkohen Agjencia e Trajtimit të Pronave dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 362, datë 16.6.2023

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 718, DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1, dhe 28, pika 1, të ligjit nr. 157/2013, "Për masat kundër financimit të terrorizmit", me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit ("Lista e OKB-së"), që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhet shtesa, me këtë përmbajtje:

Në listën e shkronjës "C", të titulluar "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (*Da'esh*) dhe *Al-Qaida*", shtohen dy individë të renditur në shkronjën "a", sipas shtesave që i bashkëlidhen këtij vendimi, në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues të organizatave ISIL (*Da'esh*) dhe *Al-Qaida*.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

PËRDITËSIMI NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT

SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT

("LISTA E OKB-së")

C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME ORGANIZATAT ISIL (*Da'esh*) dhe *Al-QAIDA*

a) Lista e shtuar në "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (*Da'esh*) dhe *Al-Qaida*";

1. ABDULLAHI; OSMAN; MOHAMED; CADDOW

2. MERAL; ABDEFATTAH; KHALIL; ZOGHBI

Shënim. Gjenealitetet e tjera për personin, emri i të cilit është radhitur më sipër, mbahen në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

VENDIM
Nr. 363, datë 16.6.2023

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 1128, DATË 30.12.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR ZBATIMIN NGA REPUBLIKA E SHQIPËRISË TË VENDIMEVE TË KËSHILLIT TË BASHKIMIT EVROPIAN PËR VENDOSJEN, NDRYSHIMIN DHE SHFUQIZIMIN E MASAVE SHTRËNGUESE NDËRKOMBËTARE, TË NDRYSHUARA", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3, pika 3, shkronja "c", e 6, pikat 2 e 5, të ligjit nr. 72/2019, "Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", dhe të nenit 5, të ligjit nr. 157/2013, "Për masat kundër financimit të terrorizmit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

1. Në pikën 3, të kreut I, pas fjalëve "... (CFSP) 2022/1967 ..." shtohen "... (CFSP) 2022/848 ...".

2. Në aneksin 3, bashkëlidhur vendimit, shtohet vendimi (CFSP) 2023/848, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

II. Ngarkohen organet e parashikuara në pikën 1, të nenit 11, të ligjit nr. 72/2019, "Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", dhe në pikën 1, të nenit 7, të ligjit nr. 157/2013, "Për masat kundër financimit të terrorizmit", të ndryshuar, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

L 109 I/38 AL Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian 24.4.2023

VENDIM I KËSHILLIT (CFSP) 2023/848

i datës 24 prill 2023

për ndryshimin e Vendimit (CFSP) 2016/1693 në lidhje me masat kufizuese kundër ISIL (Da'esh) dhe Al-Kaedës dhe personave, grupeve, ndërmarrjeve dhe subjekteve të lidhura me ta

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Bashkimin Evropian, dhe në veçanti nenin 29 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit për Punë të Jashtme dhe Politikë të Sigurisë,

duke marrë në konsideratë sa vijon:

(1) Më 20 shtator 2016, Këshilli miratoi Vendimin (CFSP) 2016/1693 ([1]).

(2) Duke pasur parasysh kërcënimin e vazhdueshëm të paraqitur nga ISIL (Da'esh) dhe Al-Kaeda dhe personat, grupet, ndërmarrjet dhe subjektet e lidhura me ta, dy persona dhe një grup duhet të shtohen në listën e personave, grupeve, ndërmarrjeve dhe subjekteve të përcaktuara në Aneksin e Vendimit (CFSP) 2016/1693.

(3) Vendimi (CFSP) 2016/1693 duhet të ndryshohet në përputhje me rrethanat,

KA MIRATUAR KËTË VENDIM:

Neni 1

Aneksi i Vendimit (CFSP) 2016/1693 është ndryshuar në përputhje me Aneksin e këtij Vendimi.

Neni 2

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Bërë në Luksemburg, 24 prill 2023.

Për Këshillin

Presidenti

J. BORRELL FONTELLES

([1]) Vendimi i Këshillit (CFSP) 2016/1693 i datës 20 shtator 2016 në lidhje me masat kufizuese kundër ISIL (Da'esh) dhe Al-Kaedës dhe personave, grupeve, ndërmarrjeve dhe subjekteve të lidhura me ta dhe shfuqizimin e Pozicionit të Përbashkët 2002/402/CFSP (OJ L 25 , 21.9.2016, f. 25).

ANEKS

Aneksi i Vendimit (CFSP) 2016/1693 është ndryshuar si më poshtë:

(1) shënimet e mëposhtme janë shtuar nën titullin 'A. Personat e përmendur në nenet 2 dhe 3:

'15. Ebu Jasir HASSAN (a.k.a. Sheikh Hassan, Ahmed Mahmud Hassan, Jaseer Hassan, Ebu Kasim); data e lindjes: 1981 deri 1983; vendi i lindjes: Rajoni Pwani, Tanzani; Gjinia mashkull; kombësia: Tanzaniane.

16. Bonomade Machude OMAR (a.k.a. Ibn Omar, Ebu Sulejfe Muhamed, Ebu Sorraca, Ebu Surakha, Ebu Suraka Suraka Filho, Omar Saide, Shejh Omar); data e lindjes: 15 qershor 1988; vendi i lindjes: rrethi Palma, provinca Cabo Delgado, Mozambik; Gjinia mashkull; kombësia: mozambike.';

(2) shënimi i mëposhtëm shtohet nën titullin "B. Grupet, ndërmarrjet dhe subjektet e përmendura në nenin 3:

'5. ISIS-Mozambik (a.k.a. Shteti Islamik i Irakut dhe Sirisë - Mozambik, Shteti Islamik -Mozambik, ISIL-M, Ansar Al-Sunna, Al-Shabaab, Al-Shabaab në Mozambik, Mozambik Wilaya e Shtetit Islamik, Ahlu Sunna wa Jamaah (ASwJ), Ehlul-Sunne ue el-Xhemaa, Ehlu-Sunneh uel-Xhemaah, Ehlu Sunneh Wajamo, Suahili Sunne).'.

COUNCIL DECISION (CFSP) 2023/848

of 24 April 2023

amending Decision (CFSP) 2016/1693 concerning restrictive measures against ISIL (Da'esh) and Al-Qaeda and persons, groups, undertakings and entities associated with them

THE COUNCIL OF THE EUROPEAN UNION,

Having regard to the Treaty on European Union, and in particular Article 29 thereof,

Having regard to the proposal from the High Representative of the Union for Foreign Affairs and Security Policy,

Whereas:

(1) On 20 September 2016, the Council adopted Decision (CFSP) 2016/1693 [1].

(2) In view of the continued threat posed by ISIL (Da'esh) and Al-Qaeda and persons, groups, undertakings and entities associated with them, two persons and one group should be added to the list of persons, groups, undertakings and entities set out in the Annex to Decision (CFSP) 2016/1693.

(3) Decision (CFSP) 2016/1693 should therefore be amended accordingly,

HAS ADOPTED THIS DECISION:

Article 1

The Annex to Decision (CFSP) 2016/1693 is amended in accordance with the Annex to this Decision.

Article 2

This Decision shall enter into force on the date of its publication in the *Official Journal of the European Union*.

Done at Luxembourg, 24 April 2023.

For the Council
The President
J. BORRELL FONTELLES

[1] Council Decision (CFSP) 2016/1693 of 20 September 2016 concerning restrictive measures against ISIL (Da'esh) and Al-Qaeda and persons, groups, undertakings and entities associated with them and repealing Common Position 2002/402/CFSP (OJ L 255, 21.9.2016, p. 25).

24.4.2023 EN Official Journal of the European Union L 109 I/39

ANNEX

The Annex to Decision (CFSP) 2016/1693 is amended as follows:

(1) the following entries are added under the heading 'A. Persons referred to in Articles 2 and 3':

'15. Abu Yasir HASSAN (a.k.a. Sheikh Hassan, Ahmed Mahmoud Hassan, Yaseer Hassan, Abu Qasim); date of birth: 1981 to 1983; place of birth: Pwani Region, Tanzania; gender: male; nationality: Tanzanian.

16. Bonomade Machude OMAR (a.k.a. Ibn Omar, Abu Sulayfa Muhammad, Abu Sorraca, Abu Surakha, Abu Suraqa Suraqa Filho, Omar Saide, Sheikh Omar); date of birth: 15 June 1988; place of birth: Palma district, Cabo Delgado province, Mozambique; gender: male; nationality: Mozambican.';

(2) the following entry is added under the heading 'B. Groups, undertakings and entities referred to in Article 3':

'5. ISIS-Mozambique (a.k.a. Islamic State of Iraq and Syria – Mozambique, Islamic State -Mozambique, ISIL-M, Ansar Al-Sunna, Al-Shabaab, Al-Shabaab in Mozambique, Mozambique Wilaya of the Islamic State, Ahlu Sunna wa Jamaah (ASWJ), Ahl al-Sunna wa al-Jamaa, Ahlu al-Sunnah wal-Jamaah, Ahlu Sunnah Wajamo, Swahili Sunna).'.

VENDIM
Nr. 365, datë 16.6.2023

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE DHE PUNONJËSVE TË DREJTORISË SË SHËRBIMEVE QEVERITARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 10, të ligjit nr. 35/2023, "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e strukturës së pagës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve dhe punonjësve të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare.

2. Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat "specialist" deri në "titullar institucioni" në Drejtorinë e së Shërbimeve Qeveritare, janë sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Funksioni "Sekretar i titullarit dhe bordit drejtues" përfiton një shtesë mbi pagë, në masën 7 000 (shtatë mijë) lekë në muaj.

3. Elementet përbërëse të pagës bruto mujore (paga për pozicion, shtesa për vjetërsi në punë dhe shtesa e nivelit të kualifikimit) për secilën klasë, të përcaktuar në lidhjen nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, si dhe vlerat për secilin element, janë të njëjta me ato të miratuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë në institucionet e administratës shtetërore.

4. Klasat e pagës dhe shtesat për kushte pune të punonjësve mbështetës në Drejtorinë e së Shërbimeve Qeveritare janë sipas lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

5. Vlera e pagës bazë për klasë dhe mënyra e llogaritjes së vjetërsisë për secilën klasë, të përcaktuar në lidhjen nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi, janë të njëjta me ato të miratuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për pagat e punonjësve mbështetës në institucionet e administratës publike.

6. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i miratuar për vitin 2023 për Drejtorinë e së Shërbimeve Qeveritare dhe nga fondi i kontigjencës, i miratuar për buxhetin e shtetit për vitin 2023.

7. Vendimi nr. 149, datë 29.2.2012, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave për punonjësit e Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare", i ndryshuar, shfuqizohet.

8. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 prill 2023.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LIDHJA NR. 1
STRUKTURA E PAGËS SË NËPUNËSVE TË DREJTORISË SË SHËRBIMEVE QEVERITARE

Funksioni	Kategoria/klasa	Paga e grupit (lek)
Titullar i institucionit	I-2	1
Drejtor drejtorie	II-2	1
Shef sektori	III-2	1
Specialist auditi, specialist në Kryeministri; specialist/redaktor ligjor në Kryeministri, specialist finance, specialist kontabilist; specialist buxheti, specialist kosto, specialist i burimeve njerëzore; specialist jurist; specialist prokurimesh; specialist koncep-*desing*, specialist logjistike, specialist shërbimi; specialist trajtimi, specialist merceolog, specialist transporti, specialist shërbimi.	IV-1	1 ose 2
Sekretar (i titullarit dhe i bordit drejtues)	IV-2	1 ose 2, ose 3
Specialist; specialist udhëtimesh; specialist protokoll-arkivi; specialist IT, specialist gjelbërimi, specialist inxhinier, sekretar për ish-presidentët	IV-2	1 ose 2, ose 3

LIDHJA NR. 2

STRUKTURA E PAGËS SË PUNONJËSVE MBËSHTETËS TË DREJTORISË SË SHËRBIMEVE QEVERITARE

Funksioni	Kategoria/Klasa	Shtesa për vjetërsi (%)	Shtesa për kushte pune (lekë)
1	2	3	4
Kryekuzhinier;	IX	1%	43,500
Kryepastiçier; Kryekamerier; Administrues Vila 4, Vila 30	IX	1%	17,800
Administrues Vila / Qendrash	IX	1%	12,700
Ndihmëspastiçier;	VIII	1%	12,700
Banakier;	VIII	1%	9,300
Kryepunëtor Rezidenca Qeveritare;	VIII	1%	7,300
Magazinier i Magazinës Qendrore;	VIII	1%	7,300
Kuzhinier Rezidenca e Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit; Presidentit	VII	1%	17,800
Kuzhinier Vila Qeveritare;	VII	1%	12,700
Teknik Elektricist/Hidraulik/Mirëmbajtje/Kameraman, Fotograf/ Operator shumëfishimi në Kryeministri, Shofer/Korrier; Shofer në Kryeministri, Teknik të ndryshëm; Punëtor në Rezidenca Qeveritare; Kamerier; Teknik Dispeçer	VII	1%	7,300
Magazinier (magazinë dytësore)	VII	1%	7,300
Shofer;	VI	1%	7,300
Punëtorë mirëmbajtjeje; Punëtor pastrimi, Punëtor pastrimi në Kryeministri , Punëtor lavanderie; Punëtor gjelbërimi; Roje/Recepsionist; Roje Magazina Industriale; Roje Pallati i Kongreseve, Lavazhier,	IV	1%	7,300

VENDIM
Nr. 366, datë 16.6.2023

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE TË SIGURISË USHQIMORE 2023–2027

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 11, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, "Për ushqimin", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Strategjisë Kombëtare të Sigurisë Ushqimore 2023–2027, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

STRATEGJIA KOMBËTARE E SIGURISË USHQIMORE
2023–2027

Tabela e përmbajtjes

Lista e shkurtesave
Hyrje
Vizioni i politikave
Palët e interesuara
Rolet dhe përgjegjësitë
Qëllimet e politikave
Referenca
Shtojca I

Lista e shkurtesave

AKU	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
AKVMB	Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve
AESU	Autoriteti Evropian i Sigurisë Ushqimore
BE	Bashkimi Evropian
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
AMIA	Analiza e Mangësive Institucionale dhe Administrative
SNBZHRP	Strategjia Ndërsektoriale për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Peshkimin 2022–2027
ISHP	Instituti i Shëndetit Publik
ISUV	Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë
AML	Analiza e Mangësive Legjislative
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
OZHQ	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
NVM	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
OKBZHQ	Objektivat e Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin e Qëndrueshëm
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OBT	Organizata Botërore e Tregtisë

HYRJE

Shqipëria pranon rëndësinë e faktit se shëndeti i njerëzve është i lidhur ngushtë me shëndetin e bimëve, kafshëve dhe mjedisin e përbashkët dhe se një politikë e qartë kombëtare për sigurinë agroushqimore është themeli për zbatimin efektiv të parimeve të "One Health" përmes zinxhirit ushqimor nga ferma në tavolinë.

Shqipëria, e vendosur në mënyrë strategjike në Gadishullin Ballkanik mes Azisë dhe Evropës, zotëron burime të shumta natyrore, një treg të konsiderueshëm me mundësi të mëdha investimi dhe ka potencial të fortë për zgjerim ekonomik.

Aktualisht, bujqësia dhe sektorët e biznesit agroushqimor japin një kontribut të rëndësishëm në ekonominë kombëtare. Në vitin 2019, prodhimi kryesor përfaqësonte afro 19% të PBB-së dhe 40% të punësimit kombëtar, ndërsa rreth 40% e popullsisë jetonte në zonat rurale, ku shumica e tyre punonin në bujqësi. Vlerësimet e Bankës Botërore[1] tregojnë se bujqësia ushqimore është në

[1] Forcimi i Qëndrueshmërisë së Modelit të Rritjes në Shqipëri. Memorandumi Ekonomik për Shqipërinë (2021)

mënyrë direkte dhe indirekte përgjegjës për pothuajse gjysmën e vendeve të punës në mbarë ekonominë në Shqipëri.

Integrimi i Shqipërisë në ekonominë globale, veçanërisht për sektorin agroushqimor është jetik, por sfidues. Aktualisht, aksesi i Shqipërisë në tregjet ndërkombëtare të ushqimit është ende i kufizuar. Produktet kryesore shtazore të Shqipërisë, duke përfshirë qumështin, mishin e kuq dhe shpendët, akoma nuk lejohen në BE. Është tepër e rëndësishme që produktet shqiptare të kenë akses dhe të bëhen më konkurruese në tregjet e huaja.

Forcimi i sistemit rregullator agroushqimor në Shqipëri është i nevojshëm për të përmirësuar mbrojtjen e shëndetit të konsumatorëve, shëndetit të kafshëve dhe shëndetit të bimëve. Aktualisht, në sistemin rregullator shqiptar ka disa mangësi specifike, në veçanti baza e kufizuar e provave për fusha kyç, si: i. incidenca në nivel vendi e rreziqeve dhe sëmundjeve të shkaktuara nga ushqimi, duke përfshirë rreziqet dhe sëmundjet për shëndetin e kafshëve; ii. kostoja ekonomike e ushqimeve të pasigurta; dhe iii. efikasiteti i ndërhyrjeve në sigurinë ushqimore. Këto mangësi lidhen me numrin e skenarëve ekzistues, duke përfshirë faktorë institucionalë, si copëzimi i zinxhirëve të vlerave ushqimore dhe mandatet institucionale publike, si dhe mungesa e përfaqësimit të efektshëm të konsumatorëve dhe operatorëve të bizneseve ushqimore. Për të forcuar sistemin rregullator duhen adresuar një sërë sfidash specifike, që përfshijnë disponueshmërinë e të dhënave për informim të monitorimit dhe mbikëqyrjes me bazë risku, pikat e dobëta që ekzistojnë në sistemet e sigurisë ushqimore dhe të shëndetit të kafshëve, lidhur me evidencat shkencore, infrastrukturën e nevojshme, burimet e trajnuara njerëzore, kulturën e sigurisë ushqimore dhe rregulloret e zbatueshme.

Qeveritë e Shqipërisë janë të përkushtuara për kapërcimin e këtyre sfidave dhe mbështesin vizionin e zhvillimit të sektorëve të ushqimit dhe bujqësisë për të qenë konkurrues, gjithëpërfshirës, i adaptueshëm dhe plotësisht i integruar në ekonominë globale. Siguria e furnizimit ushqimor mbështet ekonominë, tregtinë dhe turizmin e një vendi, kontribuon në sigurinë e ushqimit dhe të ushqyerit dhe stimulon zhvillimin e qëndrueshëm. Është e rëndësishme të theksohet që Shqipëria pranon se shëndeti i njerëzve është i lidhur ngushtë me shëndetin e bimëve, kafshëve dhe mjedisin e përbashkët dhe se një politikë kombëtare për sigurinë agroushqimore është baza për zbatimin efektiv të parimeve *"One health"* përmes gjithë zinxhirit ushqimor nga ferma në tavolinë.

Kostoja ekonomike e ushqimeve të pasigurta, shpërthimeve të sëmundjeve të kafshëve ose bimëve merr forma të shumta dhe ka ndikime afatshkurtra dhe afatgjata. Shembuj të këtyre kostove përfshijnë kostot e shëndetit publik dhe humbjen e produktivitetit të lidhura me sëmundjet ushqimore dhe sëmundjet e kafshëve të fermave, ndërprerjet në tregjet ushqimore kur ndodhin shpërthime sëmundjesh, pasi konsumatorët shmangin produktet ushqimore të implikuara ose zgjedhin alternativa që perceptohen si më të sigurta. Ushqimi i pasigurt ndikon, gjithashtu, në furnizimet ushqimore dhe sigurinë ushqimore.

Kjo politikë konsideron hap kyç njohjen e faktit se siguria e ushqimit, ushqimit të kafshëve, shëndetit të bimëve dhe kafshëve është jetike për rritjen dhe transformimin e sektorit të bujqësisë në Shqipëri dhe mund të kontribuojë pozitivisht në integrimin e Shqipërisë në tregjet rajonale, tregjet e Bashkimit Evropian dhe ato ndërkombëtare. Zgjerimi i tregjeve vendore dhe ndërkombëtare mund të ndikojë ndjeshëm në rritjen ekonomike dhe prosperitetin në të gjithë sektorin agroushqimor.

- Banka Botërore: https://documents1.worldbank.org/curated/en/099845001312232607/pdf/P1752090e8141b05a08afc06ea6bc385da3.pdf

Kjo politikë miraton qasjen "Një shëndet", e cila i lejon qeverisë të zbulojë, parandalojë dhe reagojë ndaj sëmundjeve të reja në ndërfaqen njeri-kafshë-mjedis, në mënyrë që të trajtojë më efektivisht çështjet e shëndetit publik të lidhura me ushqimin. Mbrojtja e shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve, shëndetit të bimëve dhe shëndetit të konsumatorëve rrit konkurrencën e produkteve agroushqimore shqiptare, si në tregun e brendshëm, ashtu edhe në atë të jashtëm.

Për të siguruar një politikë progresive të sigurisë agroushqimore, duhet të merren parasysh faktorët kryesorë të politikave brenda Shqipërisë dhe globalisht. Është e rëndësishme të theksohet se qëllimet e kësaj politike janë në përputhje me politikat dhe strategjitë kryesore kombëtare dhe ndërkombëtare.

Në nivel kombëtar synimet e politikave përputhen me:

- Strategjinë Ndërsektoriale për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Peshkimin 2022–2027 (SNBZHRP). Kjo politikë është veçanërisht e rëndësishme për realizimin e dy nga katër objektivat e përgjithshëm të kësaj strategjie, të cilat janë: i. promovimi i prodhimit dhe i cilësisë së qëndrueshme të ushqimit nëpërmjet zhvillimit të një sektori konkurrues dhe inovativ agroushqimor;[2] dhe ii. forcimi i kapacitetet institucionale dhe administrative drejt harmonizimit të *Acquis Communautaire* të BE-së në kapitujt përkatës. SNBZHRP-ja 2022–2027[3] është në përputhje me objektivat strategjikë të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI III) 2021–2030, si dhe me vizionin, objektivat dhe prioritetet e Qeverisë së Shqipërisë 2030 (2021–2025).

Në nivel ndërkombëtar, synimet e politikave përputhen me:

- Objektivat e Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin e Qëndrueshëm (OKBZHQ), të cilat përshkruajnë fushat e synuara për qeveritë ndërkombëtare, duke përfshirë qeverinë shqiptare, për arritjen e një të ardhmeje më të mirë dhe më të qëndrueshme për të gjithë. Ushqimet e mjaftueshme, të sigurta dhe ushqyese identifikohen qartë si të rëndësishme për të gjitha OZHQ-të, duke riafirmuar ndërvarësinë midis shëndetit dhe mirëqenies, të ushqyerit, padëmshmërisë ushqimore dhe sigurisë ushqimore. Në veçanti, OZHQ-ja 2 (Zero uri), OZHQ-ja 3 (Shëndet i mirë dhe mirëqenie) dhe OZHQ-ja 8 (Punë e denjë dhe rritje ekonomike). Siguria e ushqimit duhet, gjithashtu, të integrohet në arritjen e OZHQ-së 1 (Pa varfëri), OZHQ-së 12 (Konsum dhe prodhim i përgjegjshëm) dhe OZHQ-së 17 (Partneritete për qëllimet). Për më tepër, OZHQ-ja 6 (Uji i pastër dhe higjiena publike) është gur themeli i sigurisë ushqimore.

- Strategjia e OBSH-së për Sigurinë Ushqimore (2022–2030) – Drejt sistemeve më të forta të sigurisë ushqimore dhe bashkëpunimit global që synon forcimin e sistemeve të kontrollit të ushqimit, përdorimin e evidencave (të dhënave dhe shkencës) për të mbështetur vendimmarrjen dhe promovimin e angazhimit dhe partneriteteve të palëve të interesuara. Kjo politikë miraton parimet e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet qeverisë në zbatimin e qasjes "Një shëndet".

Qeverive u kërkohet të tregojnë lidership në miratimin dhe zbatimin e politikave të sigurisë agroushqimore, të cilat sigurojnë që çdo palë e interesuar të kuptojë dhe të luajë siç duhet rolin e tyre. Zbatimi efektiv i kësaj politike kërkon së pari, një kuptim të qartë të roleve dhe përgjegjësive të çdo pale të interesuar (siç përshkruhet në seksioni 4) dhe së dyti angazhimin e tyre në vijimësi për zbatimin e objektivave të politikës (seksioni 5) brenda kompetencave të tyre përkatëse përmes planeve të zbatimit të politikave (SHTOJCA I).

Kjo politikë përcakton parimet kryesore të njohura ndërkombëtarisht, sipas të cilave sistemet e prodhimit agroushqimor në Shqipëri duhet të rregullohen për të garantuar mbrojtjen e shëndetit të konsumatorit, shëndetin e kafshëve dhe bimëve, duke lehtësuar inovacionin dhe tregtinë. Këto përfshijnë parimet e transparencës, analizën e rrezikut, menaxhimin e krizave, vendimmarrjen e bazuar në shkencë, koordinimin dhe bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar, ndërgjegjësimin e konsumatorëve dhe komunikimin me ta.

Ia vlen të theksojmë se komunikimi, koordinimi dhe bashkëpunimi i mirë mes të gjitha palëve të

[2] Përmirësimi i efikasitetit dhe qëndrueshmërisë së prodhimit në fermë, rritja e orientimit drejt tregjeve të sektorit të përpunimit agroushqimor, harmonizimi progresiv i tij me standardet e BE-së, çka do të sigurojë përgjigje më të mirë ndaj kërkesave të konsumatorëve me ushqim të sigurt, ushqyes dhe të qëndrueshëm.

[3] Strategjia Ndërsektoriale për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Peshkimin 2021–2027 (SNBZHRP).

interesuara është thelbësor, duke përfshirë Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR), Autoritetin Kombëtar të Ushqimit (AKU), Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV), Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (AKVMB), Institutin për Shëndetin Publik, industrinë dhe konsumatorët. Shpërndarja e burimeve adekuate është gjithashtu thelbësore për të siguruar funksionimin efektiv të sistemit.

Rritja e sistemeve të sigurisë agroushqimore të Shqipërisë përfshin një sërë objektivash afatshkurtër dhe afatgjatë, të cilët mund të jenë sfiduese për t'u arritur, megjithatë janë investime të vlefshme që do të kontribuojnë në forcimin e reputacionit të Shqipërisë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar dhe do të ndikojnë pozitivisht në rritjen ekonomike.

Kjo Politikë Kombëtare e Sigurisë Agroushqimore do të rishikohet periodikisht dhe do të përditësohet sipas nevojës për të pasqyruar zhvillimet e reja që ndikojnë në sigurinë e ushqimeve dhe ushqimeve për kafshë ose në shëndetin e bimëve ose kafshëve.

Vizioni i politikave

Për të siguruar një politikë progresive të sigurisë agroushqimore, duhet të merren parasysh nxitësit kryesorë të politikave brenda Shqipërisë dhe globalisht.
Është e rëndësishme të theksojmë se qëllimet e kësaj politike janë përafruar me politikat dhe strategjitë kryesore kombëtare dhe ndërkombëtare.

Vizioni për Politikën Kombëtare të Sigurisë Agroushqimore është të kontribuojë në mbrojtjen e shëndetit të konsumatorit, shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve dhe të shëndetit të bimëve, duke aplikuar një qasje bashkëpunuese dhe integruese për forcimin e pajtueshmërisë dhe rregullimin e sektorit agroushqimor. Në arritjen e këtij vizioni, parashikohet që qeveria shqiptare dhe organet përkatëse qeveritare të marrin pjesë aktive në procesin e përafrimit me *acquis* të BE-së në rrugën e tyre drejt anëtarësimit në BE dhe të angazhohen me organizmat ndërkombëtarë për të siguruar përafrim me rregullat e Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT) për tregtinë ndërkombëtare.

Fushëveprimi i politikave

Kjo politikë miraton qasjen *"One Health"*, e cila njeh ndërlidhjet midis shëndetit të njerëzve, kafshëve dhe mjedisit. Kjo politikë mbulon të gjitha fazat përgjatë zinxhirit nga ferma në tavolinë, duke përfshirë sigurinë e ushqimit dhe ushqimit të kafshëve, shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve dhe shëndetin e bimëve.

Figura 2.1: Institucionet qeveritare përgjegjëse për politikëbërjen që lidhet me qasjen "One Health" në rregullimin e tyre të sektorit agroushqimor (d.m.th. njerëz/ konsumatorë të shëndetshëm, mjedis i shëndetshëm dhe kafshë të shëndetshme).



Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural drejton zbatimin e kësaj politike, në bashkëpunim me departamentet kryesore ministrore, veçanë-

risht Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit. Një sërë organesh qeveritare në varësi të këtyre ministrive përfshihen në fushëveprimin e kësaj politike dhe janë përgjegjëse për zbatimin e saj siç përshkruhet në seksionin 4.

Zbatimi do të arrihet përmes një qasjeje të koordinuar dhe bashkëpunuese ndërmjet organeve përkatëse qeveritare. MBZHR-ja është përgjegjëse për drejtimin e një qasjeje të koordinuar dhe bashkëpunuese drejt zbatimit të politikave. Një plan i zbatimit të politikave që përshkruan veprimet që duhen ndërmarrë për të arritur objektivat e politikës është përfshirë në shtojcën I. MBZHR-ja do të monitorojë zbatimin e këtij plani dhe do të përditësojë sipas nevojës në bashkëpunim me organet e tjera përkatëse qeveritare.

Palët e interesuara

Organet rregullatore shqiptare do të angazhohen me operatorët e biznesit agroushqimor, konsumatorët dhe palët e tjera të interesuara gjatë zhvillimit të masave të reja ligjore dhe do të ftohen të kontribuojnë në procesin e vendimmarrjes.

Kjo politikë ka disa palë të interesuara të cilat mund të ndahen kryesisht në tri kategori kryesore.

Rregullatorët – organet qeveritare përgjegjëse për zhvillimin dhe zbatimin e politikave dhe legjislacionit agroushqimor janë nxitës të kësaj politike dhe kyç për zbatimin e saj.

Bizneset Agroushqimore – të gjithë sektorët brenda industrisë agroushqimore janë palët kryesore të interesuara dhe kanë përgjegjësi për të garantuar shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve, shëndetin e bimëve, mbrojtjen e mjedisit dhe sigurinë e ushqimit për kafshët dhe ushqimin. Angazhimi i fermerëve dhe biznesit agroushqimor me organet qeveritare, në fusha të tilla si: sëmundjet e kafshëve dhe bimëve, mirëqenia e kafshëve, çështjet e sigurisë ushqimore dhe sigurisë ushqimore për kafshët, zhvillimi i legjislacionit dhe vendimmarrja, është i rëndësishëm për të rritur efektivitetin e sistemit të kontrollit të sigurisë agroushqimore.

Konsumatorët – konsumatorët janë palë e interesuar e rëndësishme të kësaj politike. Qeveritë kanë përgjegjësinë të mbrojnë shëndetin e këtyre konsumatorëve. Konsumatorët kanë rolin e tyre në angazhimin me organet qeveritare, drejtpërdrejt ose nëpërmjet shoqatave, për të rritur ndërgjegjësimin e tyre për çështjet e sigurisë ushqimore dhe për të fuqizuar veten për të marrë vendime të informuara, në lidhje me ushqimet që konsumojnë dhe praktikat higjienike. Konsumatorët inkurajohen të shprehin pikëpamjet e tyre mbi politikat dhe legjislacionin e ardhshëm përmes pjesëmarrjes së tyre në konsultimet e qeverisë.

Niveli i angazhimit të secilit prej këtyre palëve të interesuara mund të ndahet në tri kategori kryesore: të përfshirë; me ndikim të madh dhe të interesuar. Tabela 3.1 më poshtë liston palët kryesore të interesuara dhe nivelin e tyre të angazhimit:

Tabela 3.1: Lista e palëve kryesore të interesuara

<table>
<tr><td></td><td colspan="6">Palët e Përfshira të Interesuara</td></tr>
<tr><td></td><td colspan="4">Autoritetet Publike</td><td colspan="2">Industria</td></tr>
<tr><td></td><td>Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural</td><td>Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale</td><td>Ministria e Financave dhe Ekonomisë</td><td>Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë</td><td>Ministria e Turizmit dhe Mjedisit</td><td>Sektori i Biznesit Agro-Ushqimor</td></tr>
<tr><td></td><td>Administrues</td><td colspan="3">Koordinues dhe Bashkëpunues</td><td colspan="2">Zbatues</td></tr>
<tr><td rowspan="5">Subjektet e Asociuara</td><td>Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU)</td><td rowspan="5">Instituti i Shëndetit Publik</td><td>Drejtoria e Përgjithshme e Doganave</td><td>Universiteti Bujqësor i Tiranës</td><td>Agjencia Kombëtare e Mjedisit</td><td>Operatorët e biznesit ushqimor</td></tr>
<tr><td>Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë</td><td rowspan="3">Qendra Kombëtare e Biznesit</td><td>Universiteti i Tiranës</td><td>Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve</td><td>Tregtarët/ Importuesit</td></tr>
<tr><td rowspan="3">Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (AKVMB)</td><td rowspan="3">Shkolla Shqiptare e Administratës Publike</td><td rowspan="3"></td><td rowspan="3">Fermerët</td></tr>
<tr><td>Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve</td></tr>
<tr><td></td></tr>
<tr><td></td><td colspan="6">Palët e interesuara me ndikim të madh</td></tr>
<tr><td rowspan="5">Subjektet e Asociuara</td><td colspan="2">Autoritetet Publike</td><td>Shoqatat</td><td colspan="2">Organizatat</td><td></td></tr>
<tr><td colspan="2">Ministria e Turizmit dhe Mjedisit</td><td>Shoqata e Fermerëve</td><td colspan="2" rowspan="4">Organizatat Botërore të Tregtisë</td><td rowspan="4"></td></tr>
<tr><td colspan="2">Komisioni i BE-së</td><td rowspan="3">Shoqata e Konsumatorëve</td></tr>
<tr><td colspan="2">Prokuroria e Përgjithshme</td></tr>
<tr><td colspan="2">Zyra e Statistikave</td></tr>
<tr><td></td><td colspan="6">Palët e interesuara
Niveli i angazhimit të palëve të interesuara në zhvillimin e politikave dhe zbatimin e politikave ndryshon dhe varet nga kategoritë e palëve të interesuara.</td></tr>
<tr><td rowspan="4">Subjektet e Asociuara</td><td colspan="2">Publiku i Përgjithshëm</td><td colspan="3">Palë të Tjera të Interesuara</td><td></td></tr>
<tr><td colspan="2">Konsumatorët</td><td colspan="3">Partnerët tregtarë</td><td></td></tr>
<tr><td colspan="2" rowspan="2">Familjet</td><td colspan="3">Media</td><td></td></tr>
<tr><td colspan="3">Organizatat ndërkombëtare</td><td></td></tr>
</table>

Rolet dhe përgjegjësitë

Kërkohet një qasje e integruar efektive, e cila mund të arrihet përmes bashkëpunimit dhe koordinimit të hapur dhe transparent ndërmjet organeve përkatëse rregullatore në fazat kyçe të aktiviteteve të kontrollit zyrtar

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është autoriteti qendror kompetent përgjegjës për zhvillimin e politikave dhe legjislacionit, si dhe për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit agroushqimor në të gjithë zinxhirin agroushqimor. Institutet kyçe të krijuara në kuadër të kësaj ministrie janë:

- Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU), i cili është autoriteti kompetent i caktuar për kontrollet zyrtare për ushqimin dhe ushqimin e kafshëve. AKU-ja është gjithashtu përgjegjëse për kontrollet zyrtare të ushqimeve të importuara, ushqimeve për kafshët, kafshëve të gjalla, medikamenteve veterinare, produkteve për mbrojtjen e bimëve dhe inputeve bujqësore në pikat e ndryshme të kontrollit kufitar (PKK) dhe operon një rrjet laboratorësh zyrtarë.

- Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV), i cili ofron shërbime qendrore laboratorike dhe vepron si laborator kombëtar referencë për analiza specifike. ISUV-i ka aftësi analitike, kimike dhe mikrobiologjike në fushat e shëndetit të kafshëve, shëndetit të bimëve dhe sigurisë ushqimore.

- Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (AKVMB), i cili është autoriteti kompetent i caktuar për zbatimin e shërbimeve veterinare dhe kontrolleve zyrtare, në lidhje me shëndetin e kafshëve, mirëqenien e kafshëve dhe shëndetin e bimëve.

- Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve, i cili ka përgjegjësi për materialet e shumimit të bimëve.

- Qendrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB) (Fushë-Krujë) që ofrojnë shërbime laboratorike, si laborator kombëtar referimi për analizën e produkteve të plehrave.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është palë kryesore e interesuara që mban përgjegjësi për shëndetin publik. Instituti i Shëndetit Publik punon ngushtë me AKU-në, AKVMB-në dhe ISUV-in, në fusha të tilla si: mbikëqyrja e shpërthimeve të shkaktuara nga ushqimi, prevalencën e sëmundjeve zoonotike dhe sëmundjet ndërkufitare prioritare.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është pala kryesore e interesuara përgjegjës për shëndetin publik. Instituti për Shëndetin Publik punon ngushtë me AKU-në dhe ISUV-in në fusha të tilla si mbikëqyrja e shpërthimeve të sëmundjeve të shkaktuara nga ushqimi dhe prevalenca e sëmundjeve zoonotike.

MTM-ja është pala kryesore e interesuar përgjegjëse për shëndetin mjedisor dhe bashkëpunon me MBZHR-në dhe AKVMB-në, në fusha të tilla si: monitorimi mjedisor që mund të ndikojnë në shëndetin e bimëve, shëndetin e kafshëve ose sigurinë e ushqimit dhe ushqimit për kafshët.

Ministritë shqiptare dhe organet qeveritare përkatëse, të cilat janë direkt dhe indirekt përgjegjëse për rregullimin e sigurisë agroushqimore janë paraqitur në figurën CXG4.1 më poshtë:

Figura 4.1: Ministritë shqiptare dhe organet qeveritare përkatëse, të cilat janë direkt ose indirekt përgjegjëse për rregullimin e sigurisë agroushqimore.



Qëllimet e politikave

Kjo politikë identifikon një "objektiv të përgjithshëm", i cili konsiston në kontributin e mbrojtjes së shëndetit të konsumatorit, shëndetit të kafshëve dhe bimëve brenda Shqipërisë, duke lehtësuar inovacionin dhe tregtinë e biznesit.

Kjo politikë identifikon një "objektiv të përgjithshëm" që konsiston në mbrojtjen e shëndetit të konsumatorit, shëndetit të kafshëve dhe bimëve në Shqipëri, duke lehtësuar inovacionin dhe tregtinë e biznesit. Ka shumë faktorë që ndikojnë në mbrojtjen e shëndetit të konsumatorit, shëndetit të kafshëve dhe shëndetit të bimëve, disa prej të cilëve përfshihen në objektin e kësaj politike dhe faktorë të tjerë jashtë kompetencës së politikës (p.sh., ofrimi i kujdesit shëndetësor, kushtet mjedisore).

Politika përshkruan katër qëllime politike dhe 14 nënobjektiva, si një grup veprimesh të ndërlidhura të nevojshme për realizimin e këtij objektivi.

Objekti i kësaj politike përfshihet në kompetencën e një sërë organeve qeveritare, prandaj për zbatimin e suksesshëm të qëllimeve të politikës, është thelbësore që të zbatohet një qasje e integruar ndërmjet organeve qeveritare përkatëse. Qëllimet e përgjithshme të politikës dhe nënobjektivat përshkruhen më poshtë. Planet e zbatimit për çdo qëllim të politikës paraqiten në Shtojcën I.

Qëllimi i Politikave 1: Forcimi i Kornizës Legjislative dhe Administrative

Krijimi dhe Ruajtja enjë Kuadri Transparent Legjislativ dhe Administrativ të Përafruar me *acquis* të BE-së dhe Kërkesat Ndërkombëtare.

Si vend kandidat për anëtarësim të plotë në Bashkimin Evropian (BE), Shqipëria është e angazhuar për të transpozuar dhe zbatuar plotësisht *acquis* të BE-së. Legjislacioni i BE-së për sigurinë ushqimore, shëndetin e kafshëve dhe shëndetin e bimëve, siç përshkruhet në kapitullin 12 të *acquis* të BE-së, përbëhet nga më shumë se 440 pjesë legjislacioni. Kapitulli 12 përfshin grupin e burimeve, bujqësisë dhe kohezionit të kapitujve të negociatave, i cili përfshin gjithashtu kapitujt 11, 13, 22, 33. Për arritjen e një përafrimi të plotë, kërkohet një punë e konsiderueshme legjislative. Kjo do të kërkojë rritje të kapaciteteve të institucioneve dhe agjencive të përfshira në politikëbërje dhe në zbatimin e kontrolleve zyrtare.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) ka përgjegjësinë për zhvillimin e politikave dhe legjislacionit dhe ka bërë progres në procesin e transpozimit të BE-së. Organe të tjera rregullatorë, si Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV), Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU) dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (AKVMB), të cilët kanë përgjegjësinë për zbatimin e këtij legjislacioni, janë të angazhuar aktivisht në këtë proces transpozimi.

Gjatë gjithë këtij procesi, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural angazhohet për të siguruar një komunikim efektiv me të gjitha palët e interesuara, duke përfshirë konsumatorët, operatorët e biznesit ushqimor dhe palët e tjera të interesuara në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal.

Në kuadër të këtij qëllimi të politikës përcaktohen katër nënobjektivat e mëposhtëm:

NËNOBJEKTIVI 1: VAZHDIMI I PËRAFRIMIT TË LEGJISLACIONIT SHQIPTAR ME *ACQUIS* E BE-së DHE KËRKESAT NDËRKOMBËTARE

Plani kombëtar i Shqipërisë për Integrimin në BE (2022–2024) dhe analiza e mangësive legjislative (AML) janë mjete të përdorura nga MBZHR-ja për të monitoruar dhe për t'i dhënë prioritet zhvillimit të legjislacionit shqiptar, në përputhje me kërkesat e *acquis* të BE-së. Analiza e mangësive institucionale dhe administrative (AMIA) përdoret për të vlerësuar mangësitë në kuadrin institucional që duhet të rregullohen gjatë gjithë procesit të anëtarësimit në BE. Nevojitet përmirësimi i mëtejshëm i AML-së për të kontribuar në zhvillimin e një strategjie dhe plani veprimi që mund të shërbejë si mjet për monitorimin e progresit gjatë zbatimit dhe respektimit të *acquis* të BE-së.

Transpozimi i legjislacionit kryesor horizontal të BE-së po bën përparim të dukshëm, në lidhje me hartimin e ligjeve të reja për kontrollet zyrtare, shëndetin e kafshëve dhe shëndetin e bimëve të cilat parashikohen të zbatohen nga mesi i vitit 2023 e në vazhdim. Ky hap hedh bazat për të transpozuar në mënyrë të vazhdueshme legjislacionin horizontal dhe vertikal, i cili do të mbështesë besimin në standardet dhe sistemin rregullator të Shqipërisë dhe do të rrisë potencialin për të zgjeruar eksportet në tregjet ekzistuese dhe në tregjet e reja.

Zbatimi i *acquis* do të kërkojë planifikim dhe bashkëpunim të ngushtë mes MBZHR-së dhe të gjitha agjencive përgjegjëse për kryerjen e kontrolleve zyrtare, përkatësisht Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV), Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU) dhe

Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (AKVMB).

NËNOBJEKTIVI 2: KRIJIMI I TË GJITHA FUNKSIONEVE PËR NJË SISTEM EFEKTIV TË KONTROLLIT ZYRTAR

Kjo politikë miraton parimin e konceptit *"One Health",* i cili pranon se shëndeti i njerëzve është i lidhur me shëndetin e kafshëve, bimëve dhe mjedisin[4] .

Shqipëria po përpiqet ta miratojë këtë parim, duke synuar të sigurojë një qasje koherente dhe të integruar të zbatueshme brenda sistemit kombëtar të kontrollit agroushqimor dhe që kontrollet zyrtare të mbulojnë çdo pikë të zinxhirit agroushqimor. Sistemet kombëtare të kontrollit agroushqimor luajnë një rol kryesor në mbrojtjen e shëndetit të konsumatorëve dhe sigurimin e praktikave të drejta të tregtisë së ushqimit[5].

Forcimi i sistemit kombëtar të kontrollit agroushqimor është një përgjegjësi e përbashkët që përfshin palë të ndryshme të interesit, duke përfshirë organet qeveritare, industrinë ushqimore dhe konsumatorët. Kapaciteti i një sistemi kombëtar të kontrollit agroushqimor lidhet me aftësinë e tij për të kryer funksionet e duhura në mënyrë efektive, efikase dhe të qëndrueshme për të arritur objektivat e tij. Një sistem i fortë rregullator është i nevojshëm për të ndërtuar besimin dhe sigurinë te palët e jashtme të interesuara. Parimet kryesore për arritjen e kësaj, të përshkruara në figurën 5.1, përfshijnë transparencën, pavarësinë, zbatimin proporcional dhe analizën e rrezikut.

Elementet kryesore të nevojshme për forcimin e sistemit kombëtar të kontrollit agroushqimor përfshijnë:

Një qasje e integruar efektive: Kjo mund të arrihet përmes bashkëpunimit dhe koordinimit të hapur dhe transparent ndërmjet organeve rregullatore përkatëse në fazat kyçe të aktiviteteve të kontrollit zyrtar, në veçanti në hartimin e politikave dhe legjislacionit, si dhe në fazat e planifikimit, zbatimit dhe raportimit. Një qasje e integruar do të ndihmojë për të siguruar reduktimin e dublikimit të punës ndërmjet organeve qeveritare dhe do të rezultojë në përdorim më efikas të burimeve njerëzore dhe financiare. Përveç kësaj, të gjithë palët kryesore të interesit, brenda sistemit kombëtar të kontrollit agroushqimor, duhet të kenë role dhe përgjegjësi specifike të përcaktuara qartë për të siguruar një zinxhir të qartë komandimi.

Laboratorë dhe inspektorat zyrtar me burime adekuate: Një sistem kombëtar i kontrollit agroushqimor duhet të ketë burime të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të mundësuar përmbushjen e objektivave të sistemit në mënyrë të qëndrueshme. Në mënyrë të veçantë,

Lehtësimi i progresit të vazhdueshëm drejt akreditimit të metodave analitike prioritare dhe krijimi i vazhdueshëm i laboratorëve zyrtarë për të siguruar përmbushjen e programeve kombëtare të monitorimit dhe të mostrave zyrtare sipas nevojës.

Sigurimi i pajisjeve adekuate për kryerjen e aktiviteteve të kontrollit zyrtar (duke përfshirë inspektimet, auditimet dhe marrjen e mostrave).

[4] Bazat për *"One Health",* 2022 – Qendra për Parandalimin e Sëmundjeve dhe Kontrollit: https://www.cdc.gov/onehealth/basics/index.html#:~:text=What%20is%20One%20Health%3F,more%20important%20in%20recent%20years

[5] Draft Strategjia Globale e OBSH-së për Sigurinë Ushqimore 2022–2030: https://www.who.int/publications/m/item/draft-who-global-strategy-for-food-safety-2022-2030

Figura 5.1: Shtyllat për ndërtimin e besimit dhe sigurisë në sistemin rregullator agroushqimor

Parimi i Analizës së Rrezikut: Globalizimi në rritje i tregtisë agroushqimore, urbanizimi, ndryshimi i modeleve të konsumit, intensifikimi i bujqësisë, rritja e nivelit të udhëtimeve dhe turizmit dhe llojet e reja të prodhimit dhe sistemeve të prodhimit janë vetëm disa nga tendencat që kanë ndikim serioz mbi sigurinë e ushqimeve në shumë vende. Për më tepër, ndikimet nga ndryshimet klimatike dhe rritja e lëvizjeve të njerëzve, kafshëve dhe bimëve po çojnë në rritjen e rreziqeve për shëndetin e bimëve dhe shëndetin e kafshëve, për shkak të përhapjes së insekteve të dëmshme dhe sëmundjeve të reja. Aktivitetet brenda sistemit kombëtar të kontrollit të sigurisë agroushqimore duhet të bazohen në parimet e rrezikut, duke marrë parasysh provat dhe informacionin shkencor, sipas rastit. Kontrollet zyrtare duhet të kryhen rregullisht nga autoritetet kompetente mbi bazën e rrezikut dhe sipas periudhave të përshtatshme për të verifikuar pajtueshmërinë nga operatorët e biznesit agroushqimor. Të gjitha masat e zbatimit të kontrollit të bazuar në rrezik duhet të ndërmerren në mënyrë të pavarur, objektive dhe transparente.

Konsistenca e zbatimit: Konsistenca në zbatimin e legjislacionit agroushqimor në të gjitha nivelet administrative është thelbësore për të siguruar mbrojtjen e mirëqenies së kafshëve, shëndetit të bimëve dhe konsumatorëve në të gjithë Shqipërinë në mënyrë adekuate. Inspektimet dhe aktivitetet e tjera zyrtare duhet të kryhen në mënyrë konsistente në të gjithë vendin, duke marrë parasysh sigurimin e rregullimeve fleksibël, sipas legjislacionit për aktivitete specifike biznesi, duke garantuar drejtësi dhe transparencë për të gjitha bizneset.

Planifikimi i kontigjencave: Planet e kontigjencave ose planet e menaxhimit të krizave janë thelbësore dhe duhet të jenë funksionale në rast emergjence. Të gjitha organet përkatëse duhet të sigurojnë plane të kontigjencave në nivelet e duhura për trajtimin e sëmundjeve të shëndetit të kafshëve dhe të bimëve dhe shpërthimeve të sëmundjeve të ushqimit, krizave të lidhura me ushqimin dhe incidenteve të rëndësishme të sigurisë ushqimore. Planet duhet të jenë të përshtatshme dhe të zbatohen në mënyrë efektive dhe t'i nënshtrohen rishikimit dhe stafi duhet të trajnohet për funksionimin dhe ushtrimin e këtyre planeve të kontigjencave.

NËNOBJEKTIVI 3: KRIJIMI I NJË SISTEM MONITORIMI EFEKTIV PËR KONTROLLET ZYRTARE PËR TË MUNDËSUAR PËRMIRËSIME TË VAZHDUESHME

Sistemi kombëtar i kontrollit agroushqimor duhet të ketë kapacitetin dhe aftësinë për të monitoruar dhe për të raportuar mbi performancën e tij në arritjen e objektivit të përcaktuar dhe t'u nënshtrohet përmirësimeve të vazhdueshme aty ku është e nevojshme.

Monitorimi dhe rishikimi i performancës i mundëson rregullatorit të kuptojë pikat e forta dhe të dobëta brenda sistemeve. Përveç kësaj, duhet të

rishikohen ndryshimet në mënyrën se si kryhen kontrollet zyrtare duke marrë parasysh përparimet në shkencë dhe teknologji. Është e rëndësishme që sistemi kombëtar i kontrollit agroushqimor të demonstrojë aftësinë e tij për t'u përshtatur sipas rrethanave.

Një sistem efektiv kombëtar i kontrollit agroushqimor mund të përdorë qasje të ndryshme, elemente thelbësore dhe komponentë të ndryshëm, sipas rrethanave kombëtare dhe siç përshkruhet në Parimet dhe Udhëzimet për Sistemet Kombëtare të Kontrollit të Ushqimit (CXG 82-2013).

Shqipëria njeh rëndësinë e rishikimit të sistemit zyrtar të kontrollit në mënyrë që të sigurojë rivlerësimin dhe forcimin e sistemit në mënyrë të vazhdueshme. Shqipëria është e përkushtuar ndaj një procesi përmirësimi të vazhdueshëm nëpërmjet zbatimit të elementeve të mëposhtme, siç përshkruhet në figurën 5.2 më poshtë:

Verifikimi i kontrollit të brendshëm (p.sh. kontrollet mbikëqyrëse) i cili duhet të funksionojë në mënyrë të vazhdueshme dhe auditimi i brendshëm, i cili duhet të sigurojë mbulim adekuat të të gjitha fushave përkatëse të aktivitetit dhe të të gjitha autoriteteve kompetente përkatëse në periudha të përshtatshme të bazuar në rrezik.

Figura 5.2: Mekanizmat e përmirësimit të vazhdueshëm për sigurimin e rishikimit efektiv të kontrolleve zyrtare

Burimi: Farrelly and Mitchell

NËNOBJEKTIVI 4: TRANSPARENCA DHE ANGAZHIMI I PALËVE TË INTERESUARA

Transparenca është e rëndësishme për të ndërtuar dhe ruajtur besimin në integritetin e sistemit rregullator. Sigurimi i sistemit transparent në sytë e palëve të tjera të interesuara është një mënyrë për të nxitur besimin dhe për të ndihmuar në shpërndarjen e informacionit, veçanërisht në ndarjen e praktikave më të mira me organet e tjera rregullatore dhe palët e interesuara të industrisë.

Rregullatorët e Shqipërisë kanë përgjegjësi për kryerjen e aktiviteteve të tyre në një shkallë të lartë transparence, veçanërisht duke dhënë informacionin përkatës në kohën e duhur. Publiku duhet të ketë akses në legjislacion, në informacionin që lidhet me aktivitetet e kontrollit të autoritetit kompetent dhe efektivitetin e tyre, në informacionin mbi rreziqet e ushqimit ose të ushqimit për kafshët, kur ka raste të tilla, dhe në masat që duhen marrë për të parandaluar, reduktuar ose eliminuar këto rreziqe. Shqipëria duhet të balancojë nevojën për transparencë kundër rrezikut të dobësimit të aftësisë së sistemit të kontrollit për të arritur objektivat e tij.

Çdo organ rregullator brenda sistemit shqiptar të kontrollit agroushqimor do të përpiqet të promovojë transparencën brenda kompetencave të tyre rregullatore nëpërmjet objektivave të mëposhtëm;

Angazhimi për të siguruar që operatorët e biznesit agroushqimor të kenë akses në legjislacionin përkatës, standardet, udhëzimet dhe informacionin e nevojshëm për të lehtësuar dhe ndërtuar pajtueshmërinë.

Zhvillimi dhe zbatimi i masave të sigurisë agroushqimore shqiptare do të ndërmerret në mënyrë transparente.

Organet rregullatore do të angazhohen me operatorët e biznesit agroushqimor, konsumatorët

dhe palët e tjera të interesuara gjatë zhvillimit të masave të reja ligjore dhe do të ftohen të kontribuojnë në procesin e vendimmarrjes.

Të dhëna lehtësisht të aksesueshme mbi rezultatet e kontrolleve zyrtare dhe veprimeve të zbatimit.

Qëllimi i Politikave 2: Rritja e Efektivitetit të Sistemit të Kontrollit Agroushqimor

Sigurimi i një sistemi kontrolli të fortë dhe të bazuar në shkencë me burime të mjaftueshme për menaxhimin dhe zbatimin e kontrolleve zyrtare.

Një sistem efektiv i Sigurisë Agroushqimore mund të arrihet vetëm nëpërmjet kontrolleve zyrtare të bazuara në shkencë, shpërndarjes së burimeve të mjaftueshme dhe bashkëpunimit ndërmjet të gjitha palëve të interesuara.

Investimi për zhvillimin e burimeve njerëzore të Shqipërisë dhe trajnimi i stafit zyrtar të kontrollit për t'u siguruar që kanë njohuritë për kryerjen e detyrave të tyre, do të ndihmojë në përmbushjen e objektivave për të ndërtuar dhe zbatuar një sistem kombëtar kontrolli të bazuar në shkencë, rregullore dhe bashkëpunim për ofrimin e kontrolleve të sigurisë agroushqimore që në fund mbrojnë konsumatorët.

Katër nënobjektivat e mëposhtëm përcaktohen sipas këtij qëllimi të politikave:

NËNOBJEKTIVI 1: SIGURIMI I NIVELEVE DHE KOMPETENCAVE TË MJAFTUESHME TË STAFIT NË TË GJITHA ORGANET RREGULLATORË

Kapaciteti i një sistemi kombëtar të kontrollit agroushqimor lidhet me aftësinë e tij për të kryer funksionet e duhura në mënyrë efektive, efikase dhe të qëndrueshme, në mënyrë që të arrihen objektivat e tij.

Një sistem kombëtar kontrolli duhet të ketë burime të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të mundësuar përmbushjen e objektivave të sistemit në një mënyrë të qëndrueshme. Ndërtimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore do të kontribuojë për t'u siguruar që zyrtarët të kenë njohuri në fushat e tyre dhe të kuptojnë rolin rregullator dhe përgjegjësitë e tyre. Të gjithë zyrtarët duhet të trajnohen në përputhje me rolin e tyre specifik në zbatimin e sigurisë agroushqimore. Zyrtarët kompetentë në të gjitha nivelet administrative kontribuojnë në rritjen e besimit te rregullatori nëpërmjet transparencës dhe vazhdimësisë në zbatimin e ligjit për sigurinë agroushqimore.

Shqipëria njeh rëndësinë e zhvillimit dhe mbajtjes së kompetencave brenda sistemit të kontrollit dhe angazhohet për forcimin e kësaj fushe nëpërmjet zhvillimit të:

- Një rrjeti inspektorësh kompetentë brenda Shqipërisë, që është thelbësor për zbatimin efektiv të bazuar në rrezik.
- Një rrjeti laboratorësh zyrtarë, me kapacitet për të vepruar në përputhje me standardet ndërkombëtare, është thelbësor për të mbështetur inspektimin zyrtar dhe aktivitetet e zbatimit.

NËNOBJEKTIVI 2: FORCIMI I MENAXHIMIT TË TË DHËNAVE NË SISTEMIN E KONTROLLIT DHE LIDHJA E MJEDISIT, E SISTEMEVE TË SHËNDETIT TË KAFSHËVE DHE TË SHËNDETIT PUBLIK PËR

MBROJTJE MË TË MADHE TË KONSUMATORIT

Disponueshmëria e informacionit të besueshëm dhe të përditësuar është thelbësore për të forcuar sistemin kombëtar të kontrollit agroushqimor. Monitorimi i të dhënave kryesore prej rregullatorëve nga monitorimi i mjedisit, mbikëqyrja e shëndetit të kafshëve dhe shëndeti publik është thelbësor për të informuar masat që të merren me rreziqet ekzistuese dhe ato në zhvillim.

Përmirësimi i sistemeve të menaxhimit të informacionit elektronik në të gjitha nivelet administrative brenda vendit është thelbësor për fushat kyçe të rregullimit, duke përfshirë vlerësimin e rrezikut, menaxhimin e rrezikut dhe komunikimin e rrezikut dhe hartimin e programeve vjetore të kontrollit, të bazuara në rrezik (inspektime dhe marrje kampionësh.

Shqipëria synon të forcojë këto fusha nëpërmjet:

- Krijimit të mekanizmave të shkëmbimit të të dhënave brenda dhe ndërmjet organeve rregullatore dhe agjencive të tjera

- Përmirësimeve të vazhdueshme të sistemeve kyçe të informacionit si sistemit *e-Inspektorat,* sistemit të identifikimit dhe lëvizjes së kafshëve dhe sistemit të menaxhimit të informacionit laboratorik

NËNOBJEKTIVI 3: SIGURIMI I KAPACITETEVE PROFESIONALE DHE ORGANIZATIVE PËR TË GJITHA ORGANIZATAT E PËRFSHIRA PËR ZBATIMIN E SISTEMIT ZYRTAR TË KONTROLLIT

Të gjitha autoritetet kompetente të përfshira në sistemin agroushqimor duhet të forcojnë kapacitetet organizative dhe njerëzit e tyre për të siguruar një sistem të fortë sigurie agroushqimore dhe një sistem zyrtar kontrolli.

Për të zhvilluar kapacitetet profesionale dhe organizative, Shqipëria angazhohet, për:

- Përmirësim të aftësive, njohurive dhe performancës së stafit të kontrollit zyrtar përmes trajnimeve;

- Përmirësim të kapaciteteve organizative përmes politikave, planeve, legjislacionit dhe roleve dhe përgjegjësive të qarta;

- Përmirësim të komunikimit dhe bashkëpunimit ndërmjet agjencive zyrtare për të punuar së bashku për të arritur të njëjtat qëllime.

NËNOBJEKTIVI 4: VENDOSJA E BASHKËPUNIMIT TË FORTË DHE EFEKTIV KOMBËTAR DHE NDËRKOMBËTAR, DHE SHKËMBIMI I INFORMACIONIT PËR TË SIGURUAR QASJE TË INTEGRUAR EFEKTIVE NDAJ PLANIFIKIMIT, ZBATIMIT DHE MONITORIMIT

Një sistem efektiv i sigurisë agroushqimore mund të arrihet vetëm përmes bashkëpunimit ndërmjet të gjithë aktorëve. Angazhimi i përforcuar midis palëve të interesuara është jetik për të garantuar që kërkesat dhe mundësitë që një sistem efektiv i sigurisë ushqimore mund të sjellë, të kuptohen, diskutohen dhe hapat për të forcuar sistemin të ndërmerren në mënyrë të drejtë, të dakordësuar dhe transparente.

Shqipëria synon të përmirësojë bashkëpunimin duke:

- Krijimi i një grupi pune për të lehtësuar bashkëpunimin ndërmjet MBZHR-së, AKU-së, AKVMB-së, ISUV-së MBZHR-së, AKU-së dhe mbështetjen e planifikimit të programeve vjetore kontrollit të bazuara në rrezik (inspektime dhe marrjes së kampioneve);

- Zhvillimi i një protokolli ndërinstitucional / institucional për t'u marrë me krizat agroushqimore /situatat emergjente;

- Angazhimi dhe pjesëmarrja në forume në nivel ndërkombëtar, për shembull, OBSH, OBSHK, INFOSAN, AESU, dhe CodexAlimentarius.

Qëllimi i politikave 3: Forcimi i pajtueshmërisë në të gjithë sektorin agroushqimor

Sektori ushqimor

Bizneset agroushqimore në Shqipëri kanë përgjegjësinë parësore dhe ligjore për të siguruar që ushqimi që hedhin në treg të jetë i sigurt. Rritja e kulturës së sigurisë ushqimore dhe angazhimit të bizneseve agroushqimore është e dobishme për rregullatorin, konsumatorin dhe vetë biznesin. Demonstrimi i përkushtimit për hedhjen e ushqimit të sigurt në tregun vendës dhe atë ndërkombëtar mund të çojë në rritjen e besimit të konsumatorëve, rritjen e besimit nga organet qeveritare, njohjen si liderë të industrisë dhe rritje të mundësive të tregut.

Ndërhyrjet e qeverisë për rritjen e angazhimit për sigurinë ushqimore mund të përfshijnë mekanizma të thjeshtë si angazhimi i hapur, transparent dhe i vazhdueshëm dhe shkëmbimi i informacionit me industrinë për çështjet rregullatore dhe mekanizma me më shumë burime intensive, si mbështetja dhe asistenca për

ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) për t'i ndihmuar ato për arritjen e përputhshmërisë me kërkesat kombëtare të sigurisë agroushqimore.

Tre nënobjektivat e mëposhtëm përcaktohen nën këtë qëllim të politikave:

NËNOBJEKTIVI 1: KRIJIMI I BASHKËPUNIMIT TË AFËRT ME SEKTORIN AGROUSHQIMOR

Niveli i lartë i angazhimit dhe shkëmbimi i informacionit është thelbësor për të siguruar që bizneset agroushqimore në Shqipëri të kenë akses në informacionin e përditësuar dhe të saktë për t'i ndihmuar ata që të sigurojnë që ushqime të pasigurta të mos hidhen në treg. Është e rëndësishme që sektori agroushqimor të ketë një platformë për të ngritur çdo problem që ata përjetojnë, në mënyrë që çështjet të shqyrtohen dhe bizneset të mund të mbështeten dhe drejtohen aty ku është e mundur. Mekanizmat për komunikimin e informacionit, në veçanti, gjatë periudhave të krizave ose situatave emergjente janë thelbësore për të garantuar që masat korrigjuese veprojnë në kohën e duhur.

MBZHR-ja merr përsipër të angazhohet në mënyrë aktive me aktorët kryesorë për të nxitur dhe promovuar kulturën e sigurisë ushqimore dhe pajtueshmëri brenda industrisë agroushqimore të Shqipërisë.

NËNOBJEKTIVI 2: KRIJIMI I NJË QASJEJE TË KOMUNIKIMIT EFEKTIV PËR TË SIGURUAR INFORMACION TË PËRDITËSUAR DHE KËSHILLA PRAKTIKE PËR SEKTORIN MBI PËRMIRËSIMIN E SIGURISË USHQIMORE DHE TË PLOTËSIMIN E STANDARDEVE TË SIGURISË USHQIMORE

Si organ qeveritar, MBZHR-ja duhet të sigurojë komunikim të mirë me palët e interesit, veçanërisht për të siguruar që sektori agroushqimor të mbahet i përditësuar dhe të informohet rregullisht për çdo fushë që përbën interes për ta.

MBZHR-ja dhe autoritetet e tjera kompetente përpiqen të bashkëpunojnë në fushatat e sigurisë agroushqimore dhe të punojnë së bashku për të siguruar që mesazhet të arrijnë te palët e duhura të interesit. Trajnimet dhe seminaret janë mjete të rëndësishme të komunikimit të mesazheve dhe duhet të përdoren për të ndihmuar bizneset ushqimore të përmirësojnë sigurinë ushqimore dhe standardet e sigurisë ushqimore.

MBZHR-ja dhe autoritetet e tjera kompetente përdorin faqet e tyre të internetit dhe venë në përdorim faqet e medieve sociale si mjete komunikimi për të ndërvepruar në mënyrë proaktive me sektorin agroushqimor dhe për të ndërtuar një komunitet informues për këtë sektor.

MBZHR-ja do të vazhdojë të ndërtojë marrëdhënie me medien dhe të nxjerrë njoftime për shtyp për t'i komunikuar industrisë informacion mbi sigurinë agroushqimore.

MBZHR-ja angazhohet të krijojë grupet e industrisë për të ndihmuar në arritjen e pajtueshmërisë me ligjin e ushqimit dhe për të ruajtur standarde të larta

NËNOBJEKTIVI 3: PËRMIRËSIMI I EKSPERTIZËS TEKNIKE TË OPERATORËVE MBI ZBATIMIN E STANDARDEVE TË SIGURISË USHQIMORE

Rritja e ndërgjegjësimit se si të garantohet siguria ushqimore ndihmon në forcimin e praktikave të industrisë ushqimore.

Seminaret dhe uebinaret janë një mënyrë e dobishme për t'ua përcjellë njohuritë dhe ekspertizën teknike grupeve më të mëdha. MBZHR-ja planifikon seminare dhe uebinare të synuara gjatë gjithë vitit, ku sektori agroushqimor mund të marrë pjesë për të përmirësuar aftësitë në fusha të caktuara, për t'i ndihmuar ata në përputhje me legjislacionin për ushqimin dhe arritjen e standardeve të larta

Qëllimi i politikave 4: Fuqizimi i konsumatorit për të marrë vendime të informuara

Vendimet

Të gjitha organet zyrtare të kontrollit përgjegjëse për sigurinë ushqimore në Shqipëri janë të angazhuar për të rregulluar në mënyrë efikase, të harmonizuar dhe të qëndrueshme, në mënyrë që të garantojnë mbrojtjen e të gjitha grupeve të konsumatorëve, të rinj dhe të vjetër, në të gjithë vendin. Konsumatorët, gjithashtu, luajnë një rol të rëndësishëm në sistemin e sigurisë ushqimore, pasi praktikat dhe sjellja e tyre mund të ndikojnë në shkallën e sëmundjeve të shkaktuara nga ushqimi. Konsumimi i ushqimeve të pasigurta mund të shkaktojë efekte të menjëhershme, akute negative shëndetësore ose në disa raste efekte të heshtura kronike, më afatgjata.

Komunikimi dhe edukimi efektiv i rrezikut mund t'i fuqizojë konsumatorët të bëjnë zgjedhje të sigurta dhe të shëndetshme ushqimore. Në

Shqipëri, MBZHR-ja dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKF) janë përgjegjës për angazhimin aktiv me konsumatorët për të ofruar informacion të saktë dhe mesazhe të synuara mbi sigurinë ushqimore në mënyrë që të minimizohen rreziqet që lidhen me ushqimin e trajtuar, përgatitur dhe konsumuar në shtëpi dhe si të bëhen zgjedhje më të mira ushqimore

Angazhimi proaktiv midis organeve rregullatore dhe medies është i nevojshëm për të siguruar që media të ketë akses në informacion të saktë dhe në kohë, që të reduktohet rreziku i informacionit të rremë dhe potencialisht të dëmshëm që arrin te konsumatori. Kjo është sfiduese duke pasur parasysh numrin e lartë të platformave të medieve sociale dhe medieve të tjera që shpërndajnë informacion, veçanërisht gjatë situatave të krizës ushqimore.

Tre nënobjektivat e mëposhtëm përcaktohen nën këtë objektiv politike:

NËNOBJEKTIVI 1: RRITJEN E ANGAZHIMIT ME KONSUMATORËT PËR T'I FORCUAR TË BËJNË ZGJEDHJE USHQIMORE TË SIGURTA DHE TË SHËNDETSHME

Sigurimi i konsumatorëve se mund të mbështeten te organet rregullatore për t'u ofruar atyre informacion të qartë dhe të saktë në mënyrë të hapur, transparente dhe në kohë, ndihmon në ndërtimin e besimit te sistemi i kontrollit të ushqimit në Shqipëri. Ndërtimi i burimeve të qëndrueshme dhe të besueshme të informacionit i pajis konsumatorët me njohuri dhe mënyra se si të praktikojnë zakone të mira të sigurisë ushqimore brenda dhe jashtë shtëpie.

AKU-ja është përgjegjëse për komunikimin e informacionit te konsumatorët mbi sigurinë ushqimore dhe rreziqet e identifikuara. Kjo synohet të arrihet duke:

- Publikuar sinjalizime për tërheqjet e produkteve në faqen e saj të internetit dhe kanalet e medieve sociale për të njoftuar konsumatorët rreth rreziqeve të identifikuara, në lidhje me ushqimet e hedhura në treg në Shqipëri. Këto sinjalizime përcaktojnë qartë atë që dihet për ushqimin (përfshirë emrin e produktit, kodet e serisë/ prodhimit, madhësinë e enës, datat e jetëgjatësisë etj.), rrezikun, riskun dhe veprimin specifik të kërkuar;

- Mbajtur konsumatorët të përditësuar gjatë situatave të krizave ushqimore, duke u ofruar atyre informacion të saktë dhe në kohë përmes medieve të tilla, si: TV, radio, shtyp, faqet e internetit dhe mediet sociale.

NËNOBJEKTIVI 2: RRITJA E NDËRGJEGJËSIMIT PËR SIGURINË USHQIMORE NËPËRMJET EDUKIMIT DHE FUSHATAVE TË NDËRGJEGJËSIMIT PUBLIK

Rritja e ndërgjegjësimit për praktikat e mira të higjienës ushqimore dhe çështjet që lidhen me sigurinë ushqimore kontribuon në uljen e incidencës së sëmundjeve që vijnë nga ushqimi. Përfshirja e programeve të sigurisë ushqimore në shkolla është thelbësore për të sjellë ndryshime në sjelljen e popullatës së re. Angazhimi aktiv për të arritur konsumatorët kryhet përmes fushatave reklamuese, intervistave televizive, postimeve në mediet sociale, ndërveprimit në panaire dhe ngjarjeve të tjera publike.

MBZHR-ja përkushtohet për rritjen e ndërgjegjësimit të publikut, duke:

- Punuar me AKU-në, AKVMB-në, ISUV-në, ISHP-në dhe organe të tjera rregullatore për të zhvilluar fushata të rregullta ndërgjegjësimi publik për të ofruar mesazhe dhe informacione të synuara për sigurinë ushqimore për konsumatorët;

- Punuar me AKU-në, Ministrinë e Arsimit dhe institucione të tjera arsimore për të zhvilluar dhe integruar programet e sigurisë ushqimore në kurrikulat shkollore;

- Organizuar ngjarje publike për të bashkëvepruar me konsumatorët.

NËNOBJEKTIVI 3: ANGAZHIMI PROAKTIV ME MEDIET PËR TË SIGU-RUAR KOMUNIKIM TË SAKTË DHE NË KOHË

MBZHR-ja, AKU-ja dhe organe të tjera rregullatore angazhohen të punojnë ngushtë me mediet për të siguruar që ato të kenë akses në informacionin e saktë nëpërmjet burimeve të qëndrueshme dhe të besueshme.

MBZHR-ja, AKU-ja dhe organe të tjera rregullatore përkatëse angazhohen që:

- Të vendosin qartë detajet e kontaktit për pyetjet e medies në faqet përkatëse të internetit dhe të gjitha kanalet e komunikimit të lidhura me to;

- T'iu përgjigjen pyetjeve të medies në mënyrë të qartë dhe në kohë;

- Të zvogëlojnë rrezikun e informacionit të rremë dhe potencialisht të dëmshëm që arrin konsumatorët, duke nxjerrë njoftime për shtyp dhe ku është e përshtatshme të mbajnë konferenca shtypi, ku përfaqësuesit e medieve mund të marrin informacion mbi incidentet/çështjet e sigurisë ushqimore drejtpërdrejt nga burimi.

REFERENCA

CXG 82-2013: PARIMET DHE UDHËZIMET PËR SISTEMET KOMBËTARE TË KONTROLLIT USHQIMOR, CODEX ALIMENTARIUM, CAC-GL 82-2013. PRINCIPLES AND GUIDELINES FOR NATIONAL FOOD CONTROLSYSTEMS, Codex Alimentarium, CAC-GL 82-2013.

SHTOJCA I

Plani i Zbatimit të Strategjisë

Veprimtaritë që lidhen me qëllimet e politikës dhe nënobjektivat përkatës (nr.)

Qëllimi i politikës 1 - Forcimi i kuadrit ligjor dhe administrativ

Nr. 1: Përafrim i vazhdueshëm i legjislacionit shqiptar me *acquis* të BE-së dhe kërkesat ndërkombëtare

Nr. 2: Përcaktimi i të gjitha funksioneve për sisteme efikase të kontrolleve zyrtare

Nr. 3: Krijimi i një sistemi të efektshëm monitorimi që kontrollet zyrtare të mundësojnë përmirësime të vazhdueshme

Nr. 4: Transparenca dhe angazhimi i palëve të interesit

Qëllimi i politikës 2 - Forcimi i efektshmërisë së sistemit të kontrollit agroushqimor

Nr. 1: Sigurimi i mjaftueshëm i stafit dhe kompetencave në të gjitha organet rregullatore

Nr. 2: Forcimi i menaxhimit të të dhënave në sistemin e kontrollit dhe lidhja e sistemeve të mjedisit, shëndetit të kafshëve, shëndetit të bimëve dhe shëndetit publik për mbrojtje më të mirë të konsumatorit

Nr. 3: Sigurimi i kapaciteteve profesionale dhe organizative për të gjitha organizatat e përfshira në zbatimin e sistemeve zyrtare të kontrollit

Nr. 4: Krijimi i marrëdhënieve të ngushta dhe efikase për bashkëpunim dhe shkëmbim informacioni për të siguruar qasje efikase të integruar kundrejt planifikimit, zbatimit dhe monitorimit

Qëllimi i politikës 3 - Forcimi i përputhshmërisë në të gjithë sektorin agroushqimor

Nr. 1: Krijimi i marrëdhënieve të ngushta të bashkëpunimit me sektorin agroushqimor

Nr. 2: Krijimi i një qasjeje efikase komunikimi për të ofruar informacion të përditësuar dhe dhënë këshilla praktike për sektorin lidhur me përmirësimin e sigurisë ushqimore dhe përmbushjen e standardeve të sigurisë ushqimore

Nr. 3: Përmirësimi i ekspertizës teknike të operatorëve për zbatimin e standardeve të sigurisë ushqimore

Qëllimi i politikës 4: Fuqizimi i konsumatorit për të marrë vendime të informuara

Nr. 1: Rritja e angazhimit me konsumatorët për t'i fuqizuar ata në mënyrë që të bëjnë zgjedhje të sigurta dhe të shëndetshme ushqimore

Nr. 2: Ndërgjegjësimi për sigurinë ushqimore përmes fushatave edukuese dhe ndërgjegjësuese

Nr. 3: Angazhim proaktiv me median për të siguruar komunikime të sakta dhe në kohë

Nr.	Fusha	Përshkrimi	Rezultati	Treguesi	Qëllimi i politikës	Data e fillimit	Data e përfundimit	Kostot/ në lek TOTALI	Kostot PBA/në lek	Burimi i financimit Donatorët/në lek	Hendeku buxhetor
1a	Zhvillimi i kuadrit ligjor (kapitulli 12 - *acquis*).	MBZHR-ja të zhvillojë strategjinë dhe planin e veprimit të kapitullit 12 për të gjitha kërkesat e transpozimit të *acquis* të BE-së.	Hartimi i strategjisë dhe plani të veprimit së bashku me afatet kohore për kapitullin 12.	Strategjia dhe plani i veprimit për kapitullin 12 të rishikohet të paktën çdo vit. Publikimi i legjislacionit në Fletoren Zyrtare.	1	Tremujori (TM) i 3- 2023	TM4 2027 *Legjislacioni është proces që do të vazhdojë deri në anëtarësimin në BE.*	60.5 mln	1.5 mln (2024), 1.5 mln (2025)	TM1 2026 - (2021-2027) IPA III (EU 4 FOOD SAFETY) 57.5 mln	
1b	Zhvillimi i kuadrit ligjor (kapitulli 12 – *acquis*).	Rishikimi i masave ekzistuese për zbatimin e legjislacionit për të vlerësuar efektivitetin dhe për të marrë masa për forcimin e mekanizmave të zbatimit.	Grup mekanizmash zbatimi në Shqipëri, që janë të përshtatshëm për të mbrojtur sigurinë e zinxhirit agroushqimor dhe për të nxitur krijimin e kulturës së përputhshmërisë.	Është kryer analiza e masave ekzistuese të zbatimit. Janë identifikuar mangësitë dhe janë zbatuar masa për të forcuar mekanizmat e zbatimit.	2	TM3 2023	TM4 2027 *Legjislacioni është proces që do të vazhdojë deri në anëtarësimin në BE.*	231 mln	0.5 mln (2024), 0.5 mln (2025)	IPA III (2021–2027) 230 mln	
2a	Qasja "Një shëndet".	Dakordësimi i memorandumit të mirëkuptimit (MM) midis MBZHR-së, ISUV-së, AKU-së, AKVMB-së, MIE-s dhe MSHMS-së për të lehtësuar qasjen "Një shëndet" të kontrolleve zyrtare.	Bashkëpunim aktiv midis të gjitha palëve për hartimin e një rregulloreje të bazuar në shkencë.	Nënshkrimi i MM-së.	1,2	TM2 2023	TM4 2023	0	0	0	
2b	Qasja "Një shëndet".	Ngritja e "Komisionit Një Shëndet" që të përfshijë përfaqësues nga MBZHR-ja, ISUV-i, AKU-ja, ESHFF, AKVMB-ja, MIE dhe MSHMS-ja, i cili do të mblidhet dy herë në vit për të zbatuar qasjen "Një Shëndet " për programimin e kontrolleve zyrtare	Ngritja dhe funksionimi i Komisionit "Një shëndet".	Informacion mbi mbledhjet e Komisionit "Një shëndet" dhe pikat e veprimit të trajtuara në mbledhje.	1, 2	TM2 2023	TM4 2023	0.115 mln	0	Projekti i Sigurisë Ushqimore i financuar nga IPA II (2018/403-625) 0.115 mln	
3a	Burimet njerëzore	Rishikimi i nevojave të plotësimit me personel dhe zhvillimi i planeve për plotësim me personel për sa më poshtë vijon: - **MBZHR** për përmbushjen e strategjisë dhe planit të veprimit të kapitullit 12. - **ISUV** për sigurimin e një Laboratori Kombëtar Reference funksional. - **AKU** për sigurimin e zbatimit efektiv të legjislacionit brenda kompetencave të tyre. **- AKVMB** për sigurimin e zbatimit efektiv të legjislacionit brenda kompetencave të tyre. - **ESHFF** për të siguruar përmbushjen efektive të kompetencave të tyre për certifikimin e materialeve të shumëzimit të bimëve.	Hartimi i planeve të përshtatshme për plotësimin me personel të burimeve njerëzore për të gjitha palët.	Finalizimi i planeve për plotësimin me personel.	1, 2	- **MBZHR** TM1 2024 - **ISUV** TM1 2024 - **AKU** TM1 2024 - **AKVMB** TM1 2024 - **ESHFF** TM1 2024	-**MBZHR** TM4 2027 -**ISUV** TM4 2027 -**AKU** TM4 2027 -**AKVMB** TM4 2027 -**ESHFF** TM4 2027	-**MBZHR** 32 mln **-ISUV** 48 mln **-AKU** 100 mln **-AKVMB** 100 mln -**ESHFF** 5 mln *Shënim:1 mln është kostoja e 1 personi për një vit*		0	-**MBZHR** 8 mln (2024) 8 mln (2025) 8 mln (2026) 8 mln (2027) **-ISUV** 12 mln (2024) 12 mln (2025) 12 mln (2026) 12 mln (2027) **-AKU** 25 mln (2024) 25 mln (2025) 25 mln (2026) 25 mln (2027) -**AKVMB** 25 mln (2024) 25 mln (2025) 25 mln (2026) 25 mln (2027) **-ESHFF** 2 mln (2024) 1 mln (2025) 1 mln (2026) 1 mln (2027)
3b	Burimet njerëzore	Zhvillimi i planit të rekrutimit të personelit të MBZHR-së mbi një	Numri i personelit është në përputhje me planin për	Shpërndarje dhe/ose shtim stafi në përputhje me planin për plotësim me	1, 2	TM1 2024	TM4 2027	- **MBZHR** Kostuar në pikën	0	0	

Nr.	Fusha	Përshkrimi	Rezultati	Treguesi	Qëllimi i politikës	Data e fillimit	Data e përfundimit	Kostot/ në lek TOTALI	Kostot PBA/në lek	Burimi i financimit Donatorët/në lek	Hendeku buxhetor
		plan afatgjatë në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.	plotësimin e personelit.	personel.				3a			
3c	Burimet njerëzore	Stafi i trajnuar në përputhje me rolin e tyre.	Rritje e kompetencave të stafit.	Informacion për trajnimin orientues për rekrutët e rinj, zhvillimin e vazhdueshëm profesional për të gjithë stafin, si dhe hartimi i një plani shumëvjeçar trajnimi për stafin në përputhje me rolin që ka.	1, 2	TM1 2024	TM4 2027	0	0	0	
4a	Burimet (pajisjet etj.)	Laboratori ISUV Linja buxhetore adekuate e alokuar çdo vit për të mundësuar që laboratorët të funksionojnë në mënyrë efektive, të ruajnë dhe zgjerojnë numrin e metodave të akreditua ra dhe të ofrojnë shërbime që mbështesin në mënyrë adekuate kontrollet zyrtare.	Shërbimi laboratorik zyrtar i financuar në mënyrë adekuate.	Të dhëna për kontrollet zyrtare që tregojnë përmbushjen e Programeve vjetore të mostrave në kuadër të kontrollit zyrtar, të programeve të mbikëqyrjes (survejancës) dhe të programeve të monitorimit të shëndetit të bimëve.	1, 2	TM1 2023	TM4 2027	799.5 mln	112 mln 2023 100 mln për çdo vit në vijim	Projekti i Bankës Botërore: Bujqësia e qëndrueshme ndaj klimës në Shqipëri 287.5 mln	
4b	Burimet (pajisjet etj.)	Shërbimet AKVMB Linja buxhetore adekuate e alokuar çdo vit për t'u mundësuar inspektorëve të veterinarisë dhe shëndetit të bimëve që të kryejnë kontrolle zyrtare në mënyrë efektive, veçanërisht në lidhje me veshjet mbrojtëse, transportin dhe pajisje për marrje mostre.	Shërbimi i veterinarisë dhe i shëndetit të bimëve të jetë i pajisur mjaftueshëm për të kryer kontrolle zyrtare (p.sh. veshje mbrojtëse dhe transport të përshtatshme), si dhe pajisje për marrje mostre.	Të dhënat zyrtare të kontrollit që tregojnë kryerjen e kontrolleve te fermat dhe stabilimentet nga inspektorët e bimëve dhe të veterinaries. Të dhëna mbi pajisjet (p.sh., veshje mbrojtëse) të alokuara për inspektorët.	1, 2	TM1 2024	TM4 2027	329.7 mln	20.5 mln 2023 50 mln për çdo vit në vijim	Projekti i Bankës Botërore: Bujqësia e qëndrueshme ndaj klimës në Shqipëri. 109.2 mln	
4c	Burimet (pajisjet etj.)	Shërbimet AKU Linja buxhetore adekuate e alokuar çdo vit për t'u mundësuar laboratorëve të AKU-së dhe inspektorëve zyrtarë marrjen e mostrave dhe kryerjen e kontrolleve zyrtare në mënyrë efikase. Veçanërisht lidhur me pajisjet (frigoriferët, pajisjet për marrjen e mostrave) në pikat e inspektimit kufitar.	Shërbimi AKU ka pajisjet e mjaftueshme për kontrolle zyrtare dhe për marrjen e mostrave (p.sh. pajisje për marrjen e mostrave dhe frigoriferë në pikat e inspektimit kufitar).	Të dhënat zyrtare të kontrollit që tregojnë përmbushjen e programeve vjetore të kampionimit dhe mbikëqyrjes së kontrollit zyrtar. Të dhëna mbi pajisjet që suportojnë kontrollin zyrtar dhe marrjen e mostrave.	1, 2	TM1 2023	TM4 2027	462 mln	101 mln 2023 50 mln për çdo vit në vijim	Projekti i Bankës Botërore: Bujqësia e qëndrueshme ndaj klimës në Shqipëri. 161 mln	
4d	Burimet (pajisjet etj.).	Shërbimet ESHFF Linja buxhetore adekuate e alokuar çdo vit për t'i mundësuar stafit të ESHFF-së të kryejë marrjen e mostrave dhe kontrollet zyrtare në mënyrë efektive.	Shërbimi ESHFF të jetë i pajisur mjaftueshëm për të kryer marrjen e mostrave dhe kontrollet zyrtare.	Të dhëna për kontrollet zyrtare që tregojnë realizimin e kontrolleve zyrtare vjetore dhe marrjen e mostrave, si dhe programet e monitorimit.		TM1 2024	TM4 2027	115 mln	0	Projekti IPA III EU 4 FOOD SAFETY 115 mln	
5	Transparenca - konsultimi me palët e interesit.	MBZH-jaR të vazhdojë procesin e konsultimit publik për legjislacionin e ri për kapitullin e 12-të të *acquis* të BE-së, aty ku nevojitet.	Proces funksional për konsultimin publik.	Angazhim me publikun për legjislacionin e hartuar.	1	TM1 2024	TM4 2027	8 mln	2 mln për çdo vit	0	
6a	Transparenca-Angazhimi i palëve të interesit	Krijimi i mekanizmit afatgjatë për bashkëpunim, shkëmbim informacioni dhe pikëpamjesh me sektorin e biznesit. Ky mekanizëm duhet të përfshijë nëngrupe specifike të industrive që janë të një rëndësie të veçantë, si fermerët,	Shkëmbim i vazhdueshëm i pikëpamjeve dhe përditësimeve të komunitetit të biznesit në lidhje me sigurinë agroushqimore dhe zbatimin e standardeve përkatëse. *Feedback*-u i dhënë nga sektori i	Minimumi dy botime në vit për sektorin e biznesit.	3	TM1 2026	TM4 2027	4 mln	2 mln për çdo vit	0	

Nr.	Fusha	Përshkrimi	Rezultati	Treguesi	Qëllimi i politikës	Data e fillimit	Data e përfundimit	Kostot/ në lek TOTALI	Kostot PBA/në lek	Burimi i financimit Donatorët/në lek	Hendeku buxhetor
		thertoret, përpunuesit e ushqimit, hotelet, shitësit me pakicë etj.	administrimit të sfidave dhe vështirësive kryesore për të informuar zhvillimin e politikave dhe legjislacionit.								
6b	Transparenca-angazhimi i palëve dhe grupeve të interesit.	MBZHR, AKU dhe AKVMB të njoftojnë menjëherë konsumatorët për rreziqet e identifikuara në lidhje me ushqimet e vendosura në treg.	Komunikimi i njoftimeve dhe përditësimeve në kohë për konsumatorët përmes kanaleve të duhura të komunikimit.	Njoftime për shtyp dhe njoftime të menjëhershme.	4	TM3 2023	TM4 2027	0	0	0	
6c	Transparenca-angazhimi i palëve të interesit.	Kryerja e fushatave të ndërgjegjësimit publik nëpërmjet medieve sociale të paktën çdo vit që synojnë rritjen e praktikave të mira të sigurisë ushqimore në shtëpi.	Rritja e ndërgjegjësimit për çështjet e sigurisë ushqimore dhe praktikave të higjienës në shtëpi.	"Akseso" të dhëna nga kanalet e komunikimit duke përfshirë faqet e internetit, mediet sociale, statistikat e shikuesve televizivë.	4	TM1 2024	TM4 2027	4 mln	1 mln për çdo vit	0	
6d	Transparenca-angazhimi i palëve të interesit.	Java e përvitshme e Sigurisë Ushqimore në shkollat fillore për të edukuar fëmijët e vegjël mbi sigurinë ushqimore.	Rritja e ndërgjegjësimit për çështjet e sigurisë ushqimore dhe praktikat e higjienës në shtëpi.	Numri i nxënësve të përfshirë në shkolla.	4	TM1 2024	TM4 2027	16 mln	4 mln për çdo vit	0	
6e	Transparenca-angazhimi i palëve të interesit.	Ministria e Arsimit dhe Sportit, në bashkëpunim me MBZHR-në dhe institucionet përkatëse të zhvillojnë një plan afatgjatë për të ulur kostot e fushatave të ndërgjegjësimit për sigurinë ushqimore dhe të eksplorojnë mundësinë e përfshirjes së sigurisë ushqimore brenda kurrikulës shkollore.	Hartimi dhe implementimi në shkolla i programit arsimor për sigurinë ushqimore (nga ferma në pirun).	Numri i nxënësve të përfshirë në shkolla.	4	TM1 2024	TM4 2027	5.75 mln	0	IPA III (2021-2027) 5.75 mln	
6f	Transparenca - angazhimi i palëve të interesit.	Angazhim me palët e treta për kryerjen e anketimeve për konsumatorët (çdo 3 deri në 5 vjet mbi ndërgjegjësimin dhe perceptimet e konsumatorëve për sigurinë ushqimore.	Planifikim dhe programim i anketimeve për konsumatorët çdo 3 deri në 5 vjet.	Raportet përfundimtare të anketimit.	4	TM1 2024	TM4 2027	6.75 mln	1 mln lekë për anketë	IPA III (2021-2027) 5.75 mln	
7a	Analiza e riskut - vlerësimi i riskut.	Rishikimi dhe ndryshimi i legjislacionit për vlerësimin e riskut për t'i caktuar atributet e vlerësimit të riskut të sigurisë së ushqimit dhe ushqimit për kafshë tek institucioni më i përshtatshëm.	Vlerësues të pavarur dhe kompetent të riskut për ushqimin dhe ushqimin për kafshë në Shqipëri.	Vlerësimi i riskut për sigurinë e ushqimit dhe ushqimit për kafshë, i kryer nga institucioni përkatës dhe i komunikuar organeve përkatëse.	2	TM2 2023	TM1 2026	1.15 mln	0	IPA III (2021-2027) 1.15 mln	
7b	Analiza e riskut - Vlerësimi i riskut.	Rishikimi dhe ndryshimi i legjislacionit për vlerësimin e riskut për t'i caktuar atributet e vlerësimit të riskut për shëndetin e bimëve tek institucioni më i përshtatshëm.	Vlerësues të pavarur dhe kompetent të riskut për shëndetin e bimëve në Shqipëri.	Vlerësimi i riskut për shëndetin e bimëve i kryer nga ISUV-ja dhe i komunikuar organeve përkatëse (p.sh. AKVMB).	2	TM2 2023	TM1 2026	1.15 mln	0	IPA III (2021-2027) 1.15 mln	
7c	Analiza e riskut - vlerësimi i riskut.	Rishikimi dhe ndryshimi i legjislacionit për vlerësimin e riskut për t'i caktuar atributet e vlerësimit të riskut për fushën e shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve atributet tek institucioni më i përshtatshëm.	Vlerësues të pavarur dhe kompetent të riskut për shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve në Shqipëri.	Vlerësimi i riskut për shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve i kryer nga ISUV dhe i komunikuar organeve përkatëse (p.sh. AKVMB).	2	TM2 2023	TM1 2026	1.15 mln	0	IPA III (2021-2027) 1.15 mln	
7d	Analiza e riskut: menaxhimi i riskut.	Zhvillimi i kapaciteteve të MBZHR-së, AKU-së, dhe AKVMB-së, në fushat e menaxhimit të riskut.	Forcim i kompetencave të menaxhimit të riskut në të gjithë rregullatorin agroushqimor.	Vendimi i menaxhimit të riskut i ndërmarrë në lidhje me sektorin agroushqimor (p.sh. zhvillimi i legjislacionit, kërkesat për tërheqjen nga tregu/tërheqja nga tregu, aktivitetet proporcionale të zbatimit etj.).	2	TM1 2024	TM4 2027	12.6 mln	0	IPA III (2021 – 2027) 12.6 mln	
7e	Analiza e riskut:	Zhvillimi i kapaciteteve të	Forcim i kompetencave të	Komunikimi i riskut i ndërmarrë në lidhje	2, 3, 4	TM1 2024	TM4 2027	0	0	0	

Nr.	Fusha	Përshkrimi	Rezultati	Treguesi	Qëllimi i politikës	Data e fillimit	Data e përfundimit	Kostot/ në lek TOTALI	Kostot PBA/në lek	Burimi i financimit Donatorët/në lek	Hendeku buxhetor
	Komunikimi i riskut.	MBZHR-së, AKU-së, dhe AKVMB në fushën e komunikimit të riskut.	komunikimit të riskut në të gjithë rregullatorin agroushqimor.	me sektorin agroushqimor (p.sh. zhvillimi i legjislacionit, kërkesat për tërheqjen nga tregu/tërheqja nga tregu, aktivitetet proporcionale të zbatimit etj.).							
8	Bashkëpunimi ndërinstitucional.	Bazuar në miratimin e bazës ligjore zbatimi i mekanizmave për forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional mbi grupet e punës ndërinstitucionale në fushat më prioritare, si: Kontrollet e importit (Dogana, AKU, ISUV, MBZHR) Mashtrimi me ushqimet: (AKU, ISUV, MBZHR, QTBB, Policia, Dogana) dhe MANCP (rolet dhe përgjegjësitë ndërmjet sektorëve): AKU, ISUV, MBZHR, AKVMB, ESHFF	Rritja e bashkëpunimit ndërinstitucional Funksionimi i grupeve ndërinstitucionale të punës në fushat kryesore duke përfshirë: Kontrollin e importit, mashtrimin me ushqimin dhe planin e kontrollit me bazë risku (MANCP).	Evidencë për takimet e grupeve të punës dhe ndjekja e veprimeve nga takimet. Raportet e progresit me tregues të matshëm në fusha kyçe, të tilla si gjurmimi i mashtrimit me ushqimet dhe përputhshmëria me kërkesat strukturore.	2	TM1 2024	TM4 2027	0	0	0	
9	Menaxhimi i Krizave - Planifikimi i kontigjencës/ emergjencës	Hartoni/rishikoni planifikimin e kontigjencave/ emergjencave për ushqimin/ushqimin për kafshë, shëndetin e kafshëve dhe shëndetin e bimëve. Hartimi i planit ndërinstitucional/agjencive të komunikimit të krizave për të mbuluar komunikimet gjatë situatës së emergjencave/krizave	Kryeni ushtrime simuluese për të testuar sistemet dhe për të rregulluar planet bazuar në mësimet e nxjerra. Plani i komunikimit të krizave dhe staf i trajnuar.	Planet e kontigjences/emergjencës për sëmundjet kryesore të kafshëve dhe dëmtuesit e bimëve. Është finalizuar protokolli ndërinstitucional për menaxhimin e krizave të ushqimit dhe ushqimit për kafshë si dhe përfshihet plani i komunikimit të krizave.	2, 3 4	TM1 2024	TM4 2027	0.35 mln	0	Planifikimi i emergjencave të shëndetit të kafshëve dhe bimëve: Projekti IPA - ADEWB II (korrik 2022–korrik 2025) Planifikimi i menaxhimit të krizës së ushqimit/ushqimit për kafshë: IPA II (2016) Projekti i Sigurisë Ushqimore 0.35 mln Plani i komunikimit për krizën e shpërthimit të sëmundjeve nga ushqimi: 2022 nisma e OBSH-së e koordinuar nga ISPH-ja	
10a	Rishikimi i efektivitetit të kontrolleve zyrtare	Bazuar në miratimin e bazës ligjore, të zhvillohen procedura standarde operative për kontrollet e vazhdueshme të brendshme (monitorimi, rishikimi dhe përshtatjen e kontrolleve zyrtare) me MBZHR-në, ISUV-in, AKU-në, ESHFF-në dhe AKVMB-në.	Qasje konsistente ndërmjet institucioneve për monitorimin, rishikimin dhe përshtatjen e kontrolleve zyrtare.	Të dhëna për kontrollin e auditit të brendshëm, rezultatet dhe ndikimet.	1	TM1 2025	TM4 2027	0.6-1.2 mln	0.2-0.4 mln për çdo vit	0	
10b	Rishikimi i efektivitetit të kontrolleve zyrtare. Rishikimi i efektivitetit të kontrollit zyrtar.	Zhvillimi i procedurave standarde operative për auditimin e brendshëm të kontrolleve zyrtare me MBZHR-në, ISUV-in, AKU-në, AKVMB-në ESHFF.	Qasje konsistente ndërmjet institucioneve ndaj auditimit të brendshëm të kontrolleve zyrtare. Ngritja e njësisë së auditimit teknik.	Raportimet e auditimeve të brendshme dhe mbyllja e planeve korrigjuese të veprimit.	1	TM1 2025	TM4 2027	0.6-1.2 mln	0.2-0.4 mln për çdo vit	0	
11	Digjitalizimi dhe menaxhimi i të dhënave	Forcimi i sistemeve të digjitalizuara të informacionit të autoriteteve rregullatore dhe industrisë për të mbështetur zbatimin dhe politikëbërjen e bazuar në prova (p.sh. të dhëna për kontrollin zyrtar, sëmundje të shkaktuara nga ushqimi, biosiguria,	Të dhëna në kohë reale dhe të aksesueshme për kontrollet zyrtare për shëndetin e bimëve, sigurinë ushqimore të ushqimit dhe ushqimit për kafshë, sektorin e shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve.	Raportim në kohë reale mbi kontrollet zyrtare ndërmjet sektorëve të shëndetit të bimëve, sigurisë ushqimore të ushqimit dhe ushqimit për kafshë dhe sektorit të shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve. Të dhëna në kohë reale të disponueshme për fusha kyç, si sëmundjet e shkaktuara nga	2	TM2 2023	TM4 2024	1.7 mln	0	Food Safety Project – IPA 2016 1.7 mln	

Nr.	Fusha	Përshkrimi	Rezultati	Treguesi	Qëllimi i politikës	Data e fillimit	Data e përfundimit	Kostot/ në lek TOTALI	Kostot PBA/në lek	Burimi i financimit Donatorët/në lek	Hendeku buxhetor
		gjurmueshmëria nga ferma në pirun, përdorimi i medikamenteve veterinare, përdorimi i pesticideve, mbarështimi i kafshëve dhe mbajtja e dokumentacionit etj.).	Përmirësimi i qarkullimit të informacionit në kohë reale për të mbështetur zbatimin dhe politikëbërjen e bazuar në prova.	ushqimi, statusi i sëmundjeve, përdorimi i medikamenteve veterinare, përdorimi i pesticideve, gjurmueshmëria e produkteve, numri i bizneseve agroushqimore të licencuar, vendndodhja dhe veprimtaritë e tyre.							
12	Bashkëpunimi ndërkombëtar	Angazhim i vazhdueshëm aktiv i MBZHR-së, ISUV-it, AKU-së, AKVMB-së me institucionet ndërkombëtare, si WHO, FAO, INFOSAN, WOAH, EFSA, IPPC dhe EPPO, CODEX.	Pjesëmarrja aktive e Shqipërisë në forumet ndërkombëtare për sigurinë agroushqimore.	Raportet e takimeve me institucionet ndërkombëtare, si: OBSH, FAO, INFOSAN, EFSA, WOAH, IPPC, EPPO dhe CODEX.	2	TM3 2023	TM4 2027	57.5 mln	11.5 mln	0	
13a	Mbulim i përshtatshëm përgjatë të gjithë zinxhirit agroushqimor	Rishikimi i të gjitha termave të referencës dhe identifikimi i boshllëqeve dhe mbivendosjeve në sistemin e kontrollit.	Boshllëqet/mbivendosjet e identifikuara, përgjegjësitë dhe rolet e identifikuara qartë.	Plani Vjetor Kombëtar i Kontrollit.	1, 2	TM2 2024	TM4 2027	0	0	0	
13b	Mbulim i përshtatshëm përgjatë të gjithë zinxhirit agroushqimor	Siguroni që të gjitha bizneset e ushqimit dhe ushqimit për kafshë që operojnë në Shqipëri të jenë të licencuara nga AKU-ja dhe t'u nënshtrohen kontrolleve zyrtare me bazë risku. Siguroni regjistrimin e operatoreve profesionist nga AKVMB.	Të gjitha bizneset e ushqimit dhe ushqimit për kafshë janë të licencuara nga AKU-ja dhe u nënshtrohen kontrolleve zyrtare me bazë risku. Të gjithë operatorët profesionistë janë të regjistruar nga NAVPP-ja dhe u nënshtrohen kontrolleve zyrtare të shëndetit të bimëve.	Ulje e vazhdueshme e numrit të bizneseve të palicencuara të ushqimit dhe ushqimit për kafshë që operojnë në Shqipëri. Vazhdon të parandalojë futjen në territorin e Republikës së Shqipërisë, zhvendosjen ose mbajtjen, shumëzimin ose lëshimin në territorin e Republikës së Shqipërisë.	3	TM3 2023	TM4 2027	0	0	0	
13c	Mbulim i përshtatshëm përgjatë të gjithë zinxhirit agroushqimor	Rishikimi i bazës ligjore për gjurmueshmërinë dhe të sigurohet që standartet minimale për gjurmueshmërinë janë në fuqi dhe zbatohen. Hartoni udhëzime për të mbështetur zbatimin e gjurmueshmërisë nga industria.	Rritja e ndërgjegjësimit për kërkesat e gjurmueshmërisë përgjatë të gjithë zinxhirit nga ferma në pirun. Forcimi i zbatimit të gjurmueshmërisë përgjatë të gjithë zinxhirit agroushqimor.	Përmirësimi i gjurmueshmërisë përgjatë të gjithë zinxhirit agroushqimor. Tërheqje më efektive të ushqimit nga tregu (sasia e produktit të gjurmuar dhe koha e nevojshme për kryerjen e gjurmimit).	2,3,4	TM3 2023	TM4 2027	0	0	0	
TOTALI								**2,405,440,000**	**1,415,400,000**	**990,040,000**	**285,000,000**

UDHËZIM
Nr. 8, datë 2.5.2023

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN E MINISTRIT TË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË NR. 3, DATË 20.6.2019, "PËR MIRATIMIN E PROCEDURËS SË LEHTËSUAR TË AUTORIZIMIT PËR LIDHJEN NË SISTEMIN E SHPËRNDARJES TË PROJEKTEVE TË VOGLA TË RINOVUESHME PËR VETËPRODHUESIT E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA DIELLI"

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe të pikës 10, të nenit 30, të ligjit nr. 24/2023, "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme të energjisë",

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 3, datë 20.6.2019, "Për miratimin e procedurës së lehtësuar të autorizimit për lidhjen në sistemin e shpërndarjes të projekteve të vogla të rinovueshme për vetëprodhuesit e energjisë elektrike nga dielli", bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1, ndryshohet si më poshtë vijon:

"Një klient privat, publik apo një klient familjar mund të instalojë një kapacitet total deri në 500 kwp për vetëprodhimin e energjisë elektrike nga dielli ose era, për të mbuluar një pjesë apo të gjithë energjinë që nevojitet për nevojat e tij dhe të injektojë energjinë e tepërt të prodhuar në rrjetin e shpërndarjes, në përputhje me parashikimet e nenit 30, të ligjit nr. 24/2023, "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme të energjisë".".

2. Pika 2, ndryshohet si më poshtë vijon:

"Injektimi në rrjet do të lejohet për kategorinë e konsumatorëve të përcaktuar, sipas pikës 1 të këtij udhëzimi, të cilët mund të prodhojnë një pjesë ose të gjithë energjinë elektrike që konsumojnë nga impianti fotovoltaik ose eolik. Bilanci neto dhe faturimi të bëhen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a. në baza vjetore për secilën pikë matjeje të autorizuar të klientit. Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a. të marrë masa që të reflektojë në faturën mujore gjendjen kumulative kreditore ose debitore të klientit.".

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR DHE
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE
TË NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

ÇËSHTJA NIKËHASANI KUNDËR SHQIPËRISË
(Kërkesa nr. 58997/18)

VENDIM

Neni 8 – Jeta private – Shkarkim i justifikuar i prokurores nga detyra për shkak të dyshimeve serioze, në lidhje me përshtatshmërinë e financave të saj mbështetur në konstatimet e procesit të rivlerësimit (*vetting*-ut) – Ndalim i përhershëm proporcional për të rihyrë në sistemin e drejtësisë për shkelje të rëndë etike

STRASBURG
13 dhjetor 2022

I FORMËS SË PRERË
22.5.2023

Ky vendim është bërë i formës së prerë sipas nenit 44 § 2 të Konventës. Ai mund të bëhet objekt i një rishikimi redaktues.

Në çështjen Nikëhasani kundër Shqipërisë,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur si një Dhomë e përbërë nga:

Pere Pastor Vilanova, *kryetar,*
Georgios A. Serghides,
Jolien Schukking,
Darian Pavli,
Peeter Roosma,
Ioannis Ktistakis,
Andreas Zünd, *gjyqtarë*
dhe Milan Blaško, *sekretar i Seksionit;*

Duke pasur në konsideratë:

kërkesën (nr. 58997/18) kundër Republikës së Shqipërisë paraqitur pranë Gjykatës, në mbështetje të nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore ("Konventa") nga një shtetase shqiptare, znj. Besa Nikëhasani ("ankuesja"), më 17 dhjetor 2018;

vendimin për të njoftuar Qeverinë shqiptare ("Qeveria") për ankesën dhe për t'i dhënë prioritet, sipas Rregullit 41 të Rregullores së Gjykatës;

komentet e palëve të treta marrë nga Res Publica dhe Komisioni Evropian, të cilave iu ishte dhënë leja nga kryetari i Seksionit për të ndërhyrë në procedurën me shkrim (neni 36 § 2 i Konventës dhe rregulli 44 § 3 i Rregullores së Gjykatës);

Pasi diskutoi me dyer të mbyllura më datë 22 nëntor 2022;

Shpall vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua në po atë datë.

HYRJE

1. Çështja ka të bëjë me procedurat e rivlerësimit në lidhje me kërkuesen, e cila në atë periudhë ishte një prokurore në detyrë, në mbështetje të ligjit nr. 84 të datës 30 gusht 2016 ("Ligji për rivlerësimin"). Procedurat rezultuan në shkarkimin e saj nga detyra.

FAKTET

2. Kërkuesja ka lindur në vitin 1971 dhe jeton në Tiranë. Ajo u përfaqësua nga z. A. Saccucci dhe znj. G. Borgna, avokatë të cilët e ushtrojnë profesionin në Romë.

3. Qeveria u përfaqësua fillimisht nga agjenti i saj z. A. Metani, dhe në vijim, nga znj. J. Mansaku, znj. E. Muçaj dhe z. O. Moçka, Avokat i Përgjithshëm i Shtetit.

4. Faktet e çështjes mund të përmblidhen si më poshtë.

5. Kërkuesja u emërua në pozicionin e prokurores në vitin 1993. Pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Deklarimin e Pasurisë në vitin 2003 (shih paragrafin 24 më poshtë), ajo filloi të dorëzonte deklaratat vjetore për pasurinë pranë Inspektoratit të Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Konfliktit të Interesave ("ILDKPKI").

I. PROCESI I RIVLERËSIMIT (*VETTING*-ut) NË SHQIPËRI

6. Në vitin 2016, Shqipëria ndërmori reforma të thella në sistemin e drejtësisë, të cilat çuan në ndryshime në Kushtetutë dhe në hyrjen në fuqi të një sërë statutesh, në lidhje me to, midis gjërave të tjera, rivlerësimin e të gjithë prokurorëve në detyrë (në vijim referuar si "procesi i *vetting*-ut") (shih *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, nr. 15227/19, §§ 4–7, 9 shkurt 2021). Procesi i *vetting*-ut do të kryhej nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ("KPK") në shkallë të parë dhe – në rastin e një apelimi – nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit (në vijim referuar si "KPA") pranë Gjykatës Kushtetuese (së bashku referuar si "organet e *vetting*-ut"). Organet e *vetting*-ut do të duhej të rivlerësonin çdo prokuror në detyrë mbi bazën e tri kritereve: i. vlerësimi i pasurisë; ii. kontrolli i figurës me synimin për të konstatuar ndonjë lidhje të mundshme me krimin e organizuar; dhe iii. vlerësim i aftësive profesionale. Në përfundim të secilit grup të procedurave të rivlerësimit, organet e *vetting*-ut do të duhej të jepnin vendime të arsyetuara, duke konfirmuar në detyrë ose pezulluar ose shkarkuar nga detyra personin e rivlerësuar.

II. PROCEDURAT PËR KËRKUESEN

A. Në KPK

7. Në periudhën kur filloi procesi i *vetting*-ut, kërkuesja ushtronte profesionin si prokurore në prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Shkodër. Në janar 2017, ajo paraqiti deklaratat për *vetting*-un të parashikuara në ligj. Ajo deklaronte, *inter alia,* pasuritë kryesore si e më poshtë:

a) një apartament me një sipërfaqe prej 144 m^2 në Tiranë, blerë në vitin 2009 për 90,000 euro (EUR) me kursimet familjare ndër vite; të ardhurat nga shitja e disa trojeve në vitin 2008 dhe 2010; dhe një hua bankare prej 7.1 milionë lekësh (ALL), e ekuivalentuar në euro në vlerën prej 50,000 eurosh;

b) një apartament me një sipërfaqe prej 76 m^2 në Lezhë përftuar sipas një kontrate të vitit 2010 nga një kompani ndërtimi, sipas një marrëveshjeje, pas prishjes së një tjetër banese në Lezhë përftuar në vitin 1998 në pronësi të familjes; dhe 3,000 euro nga kursimet familjare në vitin 2009;

c) një njësi tregtare shërbimi me një sipërfaqe prej 150 m^2 në Lezhë përftuar në vitin 2011 sipas marrëveshjes përmendur më sipër; dhe

d) një automjet Toyota blerë për 19,500 euro në vitin 2016, ku 12,000 euro ishin marrë me anë të një kontrate huamarrjeje nga një individ privat, A. M.; 4,000 euro marrë nga shitja e një automjeti tjetër sipas një kontrate të vitit 2016; dhe nga kursimet familjare në vitet 2015 dhe 2016.

8. Për shkak të kandidaturës së kërkueses në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, organi drejtues i Prokurorisë, ajo u shtua në listën e personave që do të rivlerësoheshin me prioritet. Më 30 nëntor 2017, u hodh shorti pranë KPK-së për trupin gjykues që do të rivlerësonte kërkuesen.

9. ILDKPKI-ja paraqiti një raport pranë KPK-së në lidhje me vlerësimin e pasurisë (shih paragrafin 28 më poshtë), duke arritur në përfundimin se deklarata e kërkueses ishte e saktë, në përputhje me ligjin, e mbështetur me burime financiare të ligjshme dhe se nuk kishte asnjë konflikt interesi, nuk kishte mungesë të burimeve të ligjshme financiare për justifikimin e pasurisë, nuk kishte pasuri të fshehura dhe asnjë deklaratë false.

10. KPK-ja vijoi me një hetim të detajuar administrativ në lidhje me njërin prej tri kritereve të rivlerësimit, më konkretisht, me vlerësimin e pasurisë, në lidhje me, *inter alia*, prova të tjera të tilla si deklaratat e mëparshme vjetore të kërkueses. Më 15 dhjetor 2017, KPK-ja i dërgoi kërkueses pyetësorin e parë në vijim të deklaratave të bëra, me anë të së cilit kërkonte sqarime në lidhje me pasuri të caktuara dhe kostot e arsimimit të fëmijëve të saj. Kërkuesja paraqiti informacionet shtesë brenda afatit të parashikuar. Më 31 janar 2018, KPK-ja dërgoi një pyetësor të dytë në vijim të deklaratave të bëra, me anë të së cilit kërkueses i kërkohej, *inter alia:* i. të paraqiste kontratën sipas së cilës ishte përftuar pronësia e apartamentit në Lezhë, me një përcaktim të qartë të vitit të blerjes, të sipërfaqes dhe çmimit të blerjes; dokumentacion provues në lidhje me të ardhurat e përdorura për përftimin e tij; aktin noterial, sipas së cilit kërkuesja kishte përfituar nga shuma prej 25,000 eurosh marrë prej kompanisë së ndërtimit; dhe iii. të paraqiste informacion për datën e saktë në të cilën ajo kishte marrë të ardhurat nga shitja e trojeve nga vjehrra e saj të cilat ishin përdorur për të njëjtën blerje. Kërkuesja u përgjigj më 8 shkurt 2018 dhe paraqiti disa dokumente. Më 13 shkurt 2018, KPK-ja dërgoi një pyetësor të tretë në vijim të deklaratave të bëra, me anë të së cilit kërkoheshin informacione shtesë. Kërkuesja u përgjigj më 20 shkurt 2018.

11. Më 13 mars 2018, KPK-ja mbylli hetimin administrativ. Më 14 mars 2018, KPK-ja informoi kërkuesen për mbylljen e hetimeve mbështetur vetëm në vlerësimin e pasurisë dhe e njohu atë me gjetjet paraprake së bashku me raportin e ILDKPKI-së dhe dokumente të tjera nga dosja e çështjes.

12. Gjetjet paraprake të KPK-së ishin si më poshtë:

a) Në lidhje me apartamentin në Tiranë, kërkuesja nuk kishte listuar dy garazhe në deklarimin e saj për *vetting*-un dhe nuk kishte paraqitur prova për burimin e shumës prej 752,880 lekësh të përdorur për të paguar një pjesë të çmimit të blerjes, dhe se kishte mjaftueshëm kursime për të paguar pjesën tjetër të çmimit të blerjes.

b) Kërkuesja kishte pasur të ardhura të pamjaftueshme për të përftuar apartamentin dhe njësinë e shërbimeve në Lezhë, dhe për të justifikuar blerjen e automjetit në vitin 2016.

KPK-ja e kaloi barrën e provës te kërkuesja në lidhje me këto pasuri dhe problematika, dhe i dha asaj një afat prej njëzet ditësh për të paraqitur argumentet dhe dokumentet provuese si përgjigje të kësaj kërkese.

13. Më 3 prill 2018, kërkuesja paraqiti parashtrimet e saj, duke adresuar problematikat e theksuara nga KPK-ja dhe duke paraqitur dokumente në mbështetje të argumenteve të saj. Ajo shpjegoi se garazhet nuk ishin përfshirë në deklaratën e *vetting*-ut, për shkak të një gabimi, dhe se nuk kishte pasur asnjë qëllim që të fshiheshin ato pasuri, siç edhe provohej qartazi nga fakti se ajo kishte paraqitur një kopje të plotë të marrëveshjes së blerjes në të cilën përmendeshin shprehimisht garazhet. Ajo sqaronte se shumica e çmimit të blerjes ishte shlyer me anë të kredisë bankare dhe pjesa tjetër me kursimet, duke përfshirë edhe të ardhurat nga shitja e trojeve nën pronësinë e vjehrrës së saj. Ajo shpjegonte se ato të ardhura ishin përftuar nga vjehrra e saj në vitin 2008. Për sa u përket pronave në Lezhë, kërkuesja shpjegonte se familja e saj kishte blerë një apartament në qytet në vitin 1998. Për shkak të problematikave me lejen e ndërtimit, ndërtesa ishte shembur. Kompania e ndërtimit e kishte kompensuar familjen e saj me 25,000 euro, të cilat më pas ishin përdorur për të blerë një apartament tjetër, si edhe me kalimin në pronësinë e saj të njësisë së shërbimit. Në lidhje me blerjen e automjetit në vitin 2016, kërkuesja shpjegonte se ai ishte paguar me kursimet dhe me një hua nga shoku i bashkëshortit, A.M.

14. Më 10 prill 2018, KPK-ja njoftoi kërkuesen se seanca ishte planifikuar për t'u mbajtur më 17

prill 2018. Në seancë, ajo afroi shpjegime të tjera, në lidhje me çështjet e ngritura nga KPK-ja.

15. Me anë të vendimit nr. 15, të datës 20 prill 2018, KPK-ja e shkarkoi kërkuesen nga detyra, pasi në total kishte deklaruar pasuri me vlerë dyfish më të madhe sesa të ardhurat e saj legjitime. Sipas KPK-së, ajo kishte bërë deklarime të pasakta në deklaratat e saj vjetore dhe në deklaratën e saj për *vetting*-un; nuk kishte provuar burimet e ligjshme për të justifikuar pasuri të caktuara, duke u përpjekur t'i justifikonte ato duke u kthyer pas në kohë me anë të dokumenteve të marra kohët e fundit; dhe kishte fshehur pasuri në shuma të vogla. KPK-ja paraqiti gjetjet e mëposhtme.

a) Kërkuesja kishte paraqitur një kopje të plotë të marrëveshjes së blerjes për apartamentin në Tiranë, por, sidoqoftë, ajo nuk kishte listuar dy garazhet në deklaratën e saj të *vetting*-ut. Ajo nuk kishte paraqitur prova se në vitin 2008, vjehrra i kishte dhënë asaj dhe bashkëshortit të saj shumën prej 752,880 lekësh, nga të ardhurat e shitjes së dy trojeve, shumë e cila më pas u përdor për të paguar një pjesë të çmimit të blerjes së apartamentit. Në këtë mënyrë, ajo kishte bërë një deklaratë false. Sipas përllogaritjes së shpenzimeve për periudhën 2004-11 bërë nga familja e saj (duke përfshirë tre fëmijë dhe, ndoshta, vjehrrën që jetonte me familjen) dhe duke pasur parasysh shpenzime të tjera, si udhëtimi drejt vendit të saj të punë në Shkodër, ekzistonin "dyshime të arsyeshme", se shuma prej 108,750 lekësh në muaj për shpenzimet familjare (siç pohohej nga kërkuesja) ishte mjaftueshëm, dhe kishte edhe më pak mundësi që kërkuesja të mund të kishte mbledhur kursime në vlerën prej 2,019,700 lekësh për të paguar pjesën e mbetur të çmimit të blerjes.

b) Në lidhje me apartamentin dhe njësinë e shërbimit në Lezhë, edhe pse kërkuesja kishte deklaruar 25,000 euro në deklaratën e saj vjetor, fakti ishte se ajo nuk kishte dokumente që të provonte (në përputhje me parashikimet e Kodit Civil) pronësinë e apartamentit i cili ishte shembur, dhe për të cilin, më pas, ajo kishte përftuar ato prona. Marrëveshja noteriale e nënshkruar në vitin 2011 midis kompanisë së ndërtimit dhe bashkëshortit të kërkueses, e cila parashikonte kushtet për kompensimin e apartamentit të shembur ishte e pamjaftueshme për të provuar se ajo kishte pasur të drejta pronësie ndaj tij. Gjithashtu, theksohej se ajo nuk e kishte deklaruar atë apartament të parë në deklaratën e saj të parë vjetore, gjë e cila ishte e pafalshme për një prokurore me dhjetë vjet në detyrë në atë periudhë; se ajo kishte paraqitur informacione që nuk përputheshin me njëri-tjetrin në vitin 2004 dhe në deklaratën e *vetting*-ut në vitin 2017 për vitin e blerjes së apartamentit, vlerën e tij, sipërfaqen dhe burimet e të ardhurave të përdorura për përftimin e tij; dhe se nuk ishin deklaruar 2,100,000 lekë bë lidhje me atë apartament.

c) Pasi automjeti tip Toyota ishte importuar në Shqipëri me vlerën e deklaruar 23,900 euro dhe pasi ishte paguar taksa përkatëse për këtë shumë, dy javë më pas, në gusht 2016, bashkëshorti i kërkueses kishte paguar 19,500 euro për ta blerë atë. Në mungesë të shpjegimeve bindëse, ky mund të konsiderohet si transaksion i pajustifikuar. Shuma prej 4,000 eurosh nga shitja e makinës së vjetër u përvetësua vetëm në shtatorin e vitit 2016. A.M. kishte bërë deklarata kontradiktore, në lidhje me origjinën e shumës prej 12,000 eurosh që ai i kishte dhënë hua bashkëshortit të kërkueses, dhe sipas të dhënave të disponueshme, nuk kishte pasur mjaftueshëm të ardhura të ligjshme për ta bërë një gjë të tillë.

B. Përpara KPA-së

16. Më 4 qershor 2018, kërkuesja apeloi pranë KPA-së, duke argumentuar si më poshtë.

a) KPK-ja nuk e ngriti çështjen se kërkuesja kishte deklaruar pasuri me vlerë dy herë më të madhe sesa të ardhurat e saj të ligjshme në asnjë fazë të procedurave, për këtë arsye vendimi përfundimtar i KPK-së e kishte zënë në befasi kërkuesen. Ajo pretendoi për një shkelje të të drejtave të saj për gjykim të drejtë duke u mbështetur tek argumenti se nuk kishte pasur mundësi të mbronte veten për atë problematik, gjë e cila ishte vendimtare për rezultatin e çështjes.

b) KPK-ja nuk i kishte marrë në konsideratë gjetjet e ILDKPKI-së dhe kishte realizuar vlerësimin e vet ekonomik dhe financiar për pasurinë e saj pa pasur ekspertizën e nevojshme për ta bërë një gjë të tillë. Përfundimet e KPK-së për këtë aspekt ishin të paargumentuara.

c) Shkarkimi i saj nga detyra ishte qartazi joproporcional, duke pasur parasysh mungesën e çfarëdo qëllimi për të fshehur pasurinë dhe problematikat e vogla në deklaratën e saj të *vetting*-ut.

d) Gjetjet e KPK-së në lidhje me dhuratën nga vjehrra e saj ishin të gabuara. Marrëveshja e shitjeve të trojeve konfirmonin se vjehrra e saj i kishte marrë ato para në vitin 2008. Më pas, ato para i ishin dhënë kërkueses dhe bashkëshortit të saj, siç provohet edhe nga fakti se ajo i kishte deklaruar paratë në deklaratat e saj vjetore për pasurinë nga viti 2008 e në vijim.

e) Pronat në Lezhë ishin përftuar pas marrëveshjes së arritur me kompaninë e ndërtimit për apartamentin e shembur, që më herët kishte qenë në pronësinë e saj. Në vitin 2010, bashkëshorti i saj dhe kompania kishin lidhur një marrëveshje paraprake, sipas së cilës ajo kishte marrë një kompensim prej 25,000 eurosh. Ajo marrëveshje ishte formalizuar në një dokument me shkrim në vitin 2011, i cili njihte pagesën e shumës së sipërpërmendur dhe shtonte, si kompensim të mëtejshëm, pronësinë e njësisë së shërbimit.

f) KPK-ja kishte vendosur një barrë të paarsyeshme ndaj saj, sipas së cilës ajo duhej të provonte se një person tjetër, A.M., kishte pasur të ardhura të ligjshme për t'i dhënë asaj hua një shumë të vogël për blerjen e automjetit të përdorur.

17. Kërkuesja paraqiti prova shtesë në mbështetje të pretendimeve të saj. Rezulton se ajo paraqiti një kërkesë që në dosjen e saj të pranoheshin prova dokumentare në lidhje me të ardhurat nga shitja e dy trojeve dhe pronësinë e apartamentit të shembur në Lezhë. Gjithashtu, ajo paraqiti edhe një raport të përgatitur nga eksperti, në të cilin përllogariteshin të ardhurat dhe shpenzimet e saj ndër vite, me qëllim përgënjeshtrimin e gjetjeve të KPK-së.

18. Me anë të një vendimi procedural, KPA e rrëzoi kërkesën e saj për të pranuar prova të reja, pasi nuk ishte paraqitur asnjë arsye e përshtatshme për faktin se përse ajo nuk i kishte paraqitur këto prova më herët pranë KPK-së, dhe në çdo rast, pas një vlerësimi paraprak, dukej se ishte e pavend që të merrej një vendim për apelim. Sipas kërkueses, ajo nuk ishte njoftuar për atë vendim procedural gjatë procedurave në apel.

19. Kërkuesja dorëzoi parashtrime të tjera, më 20 dhe 28 qershor 2018. Më 7 shtator 2018, ajo paraqiti të dhëna të tjera, ku përshihej një deklaratë e noterizuar nga A.M. dhe një faturë bankare, me qëllimin për të provuar se ajo e kishte shlyer pjesën substanciale të asaj huaje. Rezulton se KPA nuk mori një vendim, në lidhje me kërkesën e saj në atë periudhë.

20. Me anë të vendimit nr. 6, të datës 12 shtator 2018, trupi gjykues i KPA-së la në fuqi vendimin e datës 20 prill 2018.

a) KPA-ja deklaroi se i kishte hedhur poshtë kërkesat e kërkueses për të paraqitur prova shtesë. KPA-ja rrëzoi pretendimin e saj se nuk ishte njoftuar nga KPK për "akuzën" se kishte pasuri në një vlerë dyfish më të madhe sesa të ardhurat e saj të ligjshme, sepse ai përfundim ishte pasojë e parashikueshme e çështjeve të përcaktuara si problematike në përfundim të hetimit administrativ dhe se ai përfundim mund të arrihej si rezultat përfundimtar i vlerësimit të pasurisë. KPA-ja u shpreh se vendimi i KPK-së për të mos marrë në konsideratë gjetjet e ILDKPKI-së dhe të mbështetej në perceptimin e vet të provave ishte legjitim. Në vijim, KPA-ja gjykonte se mospërputhjet ose mungesat e rëndësishme në deklaratën e *vetting*-ut mund të justifikonin shkarkimin nga detyra edhe në mungesë të elementit subjektiv të përgjegjësisë, dhe se vendimi i KPK-së për të mbyllur hetimin paraprak vetëm për pasurinë ishte legjitim.

b) KPA-ja la në fuqi përfundimet e arritura nga KPK-ja për meritat, se: deklarata e *vetting*-ut e kërkueses nuk ishte e saktë dhe se ajo kishte bërë gabime dhe pasaktësi në mënyrë të përsëritur në deklaratat e saj; se burimet financiare të ligjshme ishin të pamjaftueshme për të justifikuar përftimin e pronave të mëdha; se mungonin burimet financiare të ligjshme për pasuritë në pronësinë e saj dhe mungonte dokumentacioni ligjor në lidhje me pronësinë e burimeve të pretenduara; dhe se ajo kishte fshehur pasurinë dhe kishte bërë deklarata të rreme.

c) KPA-ja la në fuqi konstatimin e KPK-së se pasuria e përgjithshme ishte dy herë më e madhe sesa të ardhurat e vlerësuara si të ligjshme mbështetur në të gjitha shpjegimet dhe provat e paraqitura nga kërkuesja, dhe të gjitha të dhënat e mbledhura gjatë hetimit dhe të bëra me dije kërkueses. Ai përfundim ishte pasoja logjike e arsyetimit në lidhje me çdo pasuri, dhe e krahasimit midis shumës së pasurisë së akumuluar në vite dhe të deklaruar në deklaratën e *vetting*-ut në vitin 2017 dhe në vlerësimin e ligjshmërisë së burimeve të të ardhurave. Parashikimet e zbatueshme kushtetuese dhe të tjera nuk e lidhnin pamjaftueshmërinë e

deklaratës me elementet subjektive, me qëllimin për të fshehur pasurinë. Kërkuesja duhej të shpjegonte në mënyrë bindëse burimin legjitim të pasurisë dhe të ardhurave, dhe nuk mund të fshihte, apo të paraqiste në mënyrë të pasaktë, pasuritë e zotëruara, e fituara dhe të përdorura. Sipas nenit 4 të Ligjit për Rivlerësimin, vendimi mund të bëhej mbështetur në një ose më shumë kritere ose në një vlerësim të përgjithshëm të të tria kritereve. Pas nisjes së hetimeve për të tria kriteret, dhe pas përfundimit të pjesës për kriterin e pasurisë, KPK-ja mori në konsideratë vlerën provuese të të dhënave të mbledhura, dhe vendosi ta kufizonte vlerësimin vetëm në atë kriter. KPK-ja e kishte kaluar barrën e provës te kërkuesja, e cila ishte (vënë) në dijeni se ajo kjo barrë kishte të bënte vetëm me vlerësimin e pasurisë. Parashikimet kushtetuese dhe parashikime të tjera që kanë të bëjnë me çështjen parashikojnë masa disiplinore mbështetur qoftë edhe në vetëm një kriter.

21. Trupi gjykues i KPA-së bëri konstatimet e mëposhtme në lidhje me pasurinë kryesore.

a) Apartamenti në Tiranë ishte deklaruar si i blerë për shumën e ekuivalentuar prej 90,000 eurosh (12,345,300 lekë), paguar me kursimet familjare gjatë viteve, të ardhurat nga shitja e trojeve dhe një kredi bankare ekuivalente në vlerën 50,000 euro (7,100,000 lekë). Në një kontratë të muajit dhjetor 2009, lidhur nga bashkëshorti i kërkueses, 80,000 euro ishte caktuar si çmimi për atë apartament dhe 10,000 euro si çmimi për dy garazhet. Në deklaratën e saj të vitit 2009, kërkuesja kishte deklaruar vetëm apartamentin. Në vitin 2010, ajo i kishte deklaruar të dy për shumën në total prej 90,000 eurosh. Sipas të dhënave nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, dy garazhet ishin regjistruar si prona të veçanta. Deklarata e pasurisë kërkonte një përshkrim të detajuar të të gjithë pasurisë së akumuluar gjatë viteve deri në datën e deklarimit. Në këtë mënyre, KPK-ja, me të drejtë, kishte gjykuar se kërkuesja nuk kishte qenë e saktë në deklaratën e saj të *vetting*-ut në lidhje me dy garazhet.

Për sa u përket të ardhurave nga shitjet e dy trojeve të vjehrrës së saj në vitin 2008 për shumën 376,400 secili, me anë të një akti noterial dhurate të datës 22 gusht 2013, ajo ia kishte dhënë këto të ardhura djalit të saj, bashkëshortit të kërkueses. Kërkuesja nuk kishte paraqitur asnjë provë (tjetër) dokumentare me deklaratën e saj të vitit 2008, apo në deklaratën e pronave në vitin 2017, me anë të së cilës të konfirmonte transfertën e të ardhurave. Akti i dhuratës përcaktonte datën 22 gusht 2013 si datën e dhuratës, gjë e cila binte në kundërshtim me deklaratat e bëra në vitin 2008 dhe 2017, ku deklarohej se kërkuesja dhe bashkëshorti i saj kishin përfituar nga të ardhurat në vitin 2008. Pas shqyrtimit të një deklarate nga noteri në mars 2018, KPK-ja me të drejtë kishte hedhur poshtë argumentin sipas së cilit pretendohej se noteri kishte bërë një gabim kur kishte redaktuar/ndryshuar dokumentin në vitin 2013. Noteri e pranoi gabimin; ai e bëri këtë gjë pesë vjet më vonë (pas dhuratës) dhe e bëri këtë në mungesë të personit që kishte dhuruar shumën dhe në shkelje të legjislacionit të zbatueshëm që lejonte redaktimin/ndryshimin teksa dokumenti ligjor po hartohej për t'u nënshkruar nga pala/palët. KPK-ja ishte justifikuar për përfundimin se kërkuesja kishte bërë deklaratë të rreme për burimin e të ardhurave përftuar nga shitja e trojeve nga vjehrra e saj, në përpjekje për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të përdorur për të blerë apartamentin.

Në lidhje me të ardhurat nga shitja e një trualli tjetër me sipërfaqe 2,040 m^2 në vitin 2010 si burim i të ardhurave për apartamentin, në deklaratën e saj të vitit 2010, kërkuesja kishte deklaruar atë shitje bërë nga vjehrra e saj. Megjithatë, në deklaratën e vitit 2008, pjesa e mbetur e truallit nën pronësinë e saj ishte 1,500 m^2. Kërkuesja nuk kishte paraqitur dokumente me deklaratën e saj të pasurisë të vitit 2017 me anë të së cilës të konfirmonte transfertën nga vjehrra e saj për të apo bashkëshortin e saj. Vjehrra e saj nuk ishte e listuar në certifikatat familjare si pjesë e familjes së kërkueses. Edhe nëse pranohet se ajo kishte jetuar me ta gjatë asaj periudhe, ajo kishte qenë e lirë të paraqiste të ardhurat. Mbetej detyrë e kërkueses që të provonte në mënyrë bindëse, në mbështetje të nenit D § 3 të Aneksit të Kushtetutës, se ajo kishte përfituar nga ato para (shih paragrafin 27 më poshtë).

Në lidhje me kursimet familjare, nga deklarimet vjetore rezultonte se ato janë përdorur për të paguar apartamentin si më poshtë: 10,000 euro në vitin 2009, 20,000 euro në vitin 2010, dhe 10,000 euro në vitin 2011, me një total prej 5,530,900.

Kërkuesja nuk kishte deklaruar kursime për periudhën nga viti 2003 deri në vitin 2006. Ajo kishte deklaruar 6,365,920 euro nga kursimet familjare më periudhën nga viti 2007 deri në vitin

2011: 300,000 lekë në vitin 2007, 1,700,000 lekë në vitin 2008; 1,300,00 lekë në vitin 2009; 1,677,620 lekë (1,400,000 lekë dhe 2,000 euro) në vitin 2010; dhe 1,388,300 lekë (1,250,000 lekë dhe 1,000 euro) në vitin 2011. Megjithatë, mbështetur në të ardhurat e deklaruara prej saj në deklaratat vjetore për periudhën 2007-11, duke hequr shpenzimet për jetesën sipas të dhënave zyrtare të publikuara nga Instituti i Statistikave në Shqipëri për atë periudhë, kursimet reale për secilin vit do të duhej të ishin si më poshtë: 149,568 lekë në vitin 2007; 2,068,880 lekë në vitin 2008; 132,182 lekë në vitin 2009; minus 650,918 lekë në vitin 2010; dhe minus 83,141 lekë në vitin 2011. Duke krahasuar kursimet e llogaritura si më sipër me ato të deklaruara nga kërkuesja në deklarimet vjetore, diferencat e pajustifikuara ishin si më poshtë: teksa për vitin 2008 ajo kishte deklaruar më pak sesa ajo mund të kursente në shumën prej 368,380 lekësh, për vitin 2007 dhe 2009-11 ajo kishte deklaruar më shumë sesa mund të kursente në shumat e si më poshtë: 150,432 lekë në vitin 2007; 1,167,818 lekë në vitin 2009; 2,328,538 lekë në vitin 2010; dhe 1,471,441 lekë në vitin 2011. Në këtë mënyrë, shuma në total prej 4,749,349 lekësh nuk mund të justifikohej ligjërisht si kursime. Thënë ndryshe, ajo mund të justifikonte vetëm diferencën si shumë e arsyeshme kursimesh.

b) Për sa ka të bëjë me automjetin Toyota, KPA-ja la në fuqi gjetjet e KPK-së në lidhje me çmimin e blerjes. Gjithashtu, sipas të dhënave nga Drejtoria për Parandalimin e Pastrimit të Parave, 12,000 euro ishin deklaruar se vinin nga kursimet familjare dhe kursimet nga puna të A.M. Nga të dhënat zyrtare rezultonte se A.M. nuk kishte pasur burime të mjaftueshme nga të ardhurat e fituara nga puna, për t'i dhënë hua familjes së kërkueses 12,000 euro. Provat e dorëzuara në vitin 2018 për të justifikuar se A.M. i kishte marrë paratë nga kushëriri i tij në Greqi binin në kundërshtim me të dhënat e mëparshme. Gjithashtu, nuk dukej bindës as fakti se A.M. kishte marrë një hua prej 50,000 eurosh në vitin 2016 që do të shlyhej në vitin 2017, dhe në të njëjtën kohë i kishte dhënë hua një pjesë të asaj shume bashkëshortit të kërkueses për t'u shlyer në vitin 2018. Përsëri, kërkuesja nuk kishte paraqitur ndonjë provë se në fakt ajo kishte marrë 12,000 euro.

Sipas kontratës për shitjen e makinës së vjetër në muajin shtator 2016, çmimi i blerjes prej 4,000 eurosh ishte paguar në një datë të pacaktuar. Nuk ekzistonin prova të përshtatshme për shlyerjen reale të asaj shume, veçanërisht përpara blerjes së automjetit Toyota. Një deklaratë e noterizuar e hartuar në muajin mars 2018 përcaktonte se ajo shumë ishte shlyer në vitin 2016 dhe se më pas, palët kishin formalizuar transaksionin e tyre me anë të kontratës. Në këtë mënyrë, nuk kishte prova se kërkuesja kishte 4,000 euro nga shitja e makinës së vjetër dhe më pas, e kishte përdorur këtë shumë për të blerë makinën Toyota. Ajo kishte bërë një deklaratë të rreme dhe nuk kishte provuar ligjshmërinë e asaj shume.

c) Në deklaratën e saj të *vetting*-ut, kërkuesja nuk kishte deklaruar shitjen e një tjetër makine në vitin 2008, duke fshehur në këtë mënyrë të ardhurat prej 200,000 lekësh. Në deklaratën vjetore për vitin 2007, ajo kishte deklaruar se ajo i kishte dhënë hua 300,000 lekë kunatit të saj, pa ndonjë dokumentacion për ta provuar këtë gjë. Në deklaratat e saj të mëpasshme ose në deklaratën e *vetting*-ut, ajo nuk kishte përmendur kthimin e asaj shume, për të cilën, sidoqoftë, ajo nuk kishte kapacitetin e mjaftueshëm financiar për të dhënë hua. Në këtë mënyrë, ajo kishte bërë një deklaratë të rreme.

22. Në përgjigje të ankesës së kërkueses në lidhje me konstatimin e KPK-së se pasuria e saj i tejkalonte më shumë sesa dyfish të ardhurat e ligjshme, dhe pas vlerësimit të të gjitha fakteve përkatëse dhe të gjitha provave, në lidhje me të dhe pronat e bashkëshortit të saj nga viti 2003 deri në vitin 2016, trupi gjykues i KPA-së arriti në përfundimin se kërkuesja nuk kishte provuar ligjshmërinë për sa më poshtë:

a) apartamenti në Tiranë – 4,749,349 lekë, pasi kjo shumë ishte më shumë sesa kërkuesja mund të kishte kursyer në mënyrë të arsyeshme gjatë periudhës 2007-11, duke pasur parasysh të ardhurat e saj të ligjshme.

b) apartamenti në Lezhë – 3,418,000 lekë (25,000 euro), sepse kërkuesja nuk kishte pasur kurrë një dokument që të konfirmonte pronësinë e saj ndaj apartamentit të shembur; njësia e shërbimeve – 6,000,000 lekë për të njëjtën arsye;

c) automjeti Toyota – 16,000 euro (2,184,160 lekë) sepse A.M. nuk kishte pasur kapacitetin financiar për të dhënë hua 12,000 euro dhe kërkuesja nuk kishte asnjë provë dokumentare për

të provuar birimin e 4,000 eurove të përdorura për blerjen e asaj makine.

Trupi gjykues i KPA-së arriti në përfundimin se në total pasuria familjare e kërkueses ishte 24,637,339 lekë, ndërsa pasuria e saj e përftuar ligjërisht ishte 8,772,156 lekë, që është 2.8 herë më pak. Duke iu referuar nenit D §§ 3 dhe 4 të aneksit të Kushtetutës (shih paragrafët 27 dhe 35 më poshtë), trupi gjykues i KPA-së la në fuqi masën disiplinore dhënë me anë të vendimit të KPK-së më 20 prill 2018.

III. INFORMACIONE TË TJERA

23. Pasi qeveria ishte njoftuar për kërkesën, në vitin 2020, kërkuesja informoi Gjykatën se në vitin 2018 ajo kishte aplikuar pranë Dhomës Kombëtare të Avokatisë (Shoqata e Avokatëve) për t'u "regjistruar" si avokate. Sipas Qeverisë, ajo thjesht depozitoi një kërkesë për informacion për legjislacionin përkatës. Me anë të shkresës së datës 9 nëntor 2018, kryetari i Dhomës u përgjigj si më poshtë:

"Lënda: një përgjigje

Në përgjigje të kërkesës suaj depozituar pranë nesh nëpërmjet shkresës suaj për informacion në lidhje me ushtrimin e profesionit të avokatit dhe së drejtës për t'iu nënshtruar provimit [përkatës], ju bëjmë me dijeni si më poshtë.

- Sipas ligjit nr. 55/2018..., ushtrimi i profesionit të avokatit është një e drejtë e çdo shtetasi shqiptar apo të huaj, i cili përmbush kriteret e parashikuara në nenet 13 dhe 14 të ligjit. Pjesa më e rëndësishme e shprehur në ato dispozita për rregullimin e së drejtës për të ushtruar profesionin e avokatit është marrja e titullit të "avokatit", që, sipas nenit 13 ... duhet të merret duke kaluar me sukses provimin kualifikues.

- Duke qenë se ju nuk keni kaluar me sukses procesin e rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, mbështetur në seksionin 13(2)(e) ..., juve ju është mohuar me ligj e drejta për të aplikuar për titullin e "avokatit" – dhe, rrjedhimisht, e drejta për të ushtruar profesionin e avokatit – derisa të shuhet masa disiplinore sipas legjislacionit të posaçëm.".

KUADRI DHE PRAKTIKA LIGJORE PËRKATËSE

I. LEGJISLACIONI DHE PRAKTIKA SHQIPTARE

A. Ligji për Deklarimin e Pasurive (ligji nr. 9094 i datës 10 prill 2003), i ndryshuar

24. Sipas nenit 4 të Ligjit për Deklarimin e Pasurive, zyrtarëve publikë iu kërkohet të paraqesin deklarimet vjetore pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave ("ILDKPKI") për interesat privatë, burimet e përdorura për krijimin e tyre, si edhe për detyrimet financiare, në lidhje me, *inter alia,* pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale ndaj tyre; pasurive të luajtshme, që mund të regjistrohen në regjistrat publikë; artikujt me vlerë të veçantë mbi 300,000 lekë; detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë; të ardhurat personale për atë vit nga paga ose pjesëmarrja në borde, komisione ose çdo aktivitet që sjell të ardhura personale; interesat privatë që lidhen me, përmbajnë, mbështeten në ose vijnë nga marrëdhëniet familjare ose të bashkëjetesës; çdo shpenzim i deklarueshëm, me vlerë më të madhe sesa 300,000 lekë, i bërë gjatë vitit të deklaratës.

25. Sipas nenit 38 të ligjit, deklarimi i rremë i pasurive përbën vepër penale sipas legjislacionit penal të zbatueshëm (neni 257/a i Kodit Penal).

B. Procesi i *vetting*-ut

26. Për një përmbledhje të legjislacionit vendës të zbatueshëm dhe referencave të tjera shih *Xhoxhaj kundër Shqipërisë* (nr. 15227/19, §§ 93-209, 9 Shkurt 2021). Dispozitat që kanë veçanërisht lidhje me procesin e *vetting*-ut në çështjen konkrete janë si më poshtë.

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

27. Neni D i Aneksit të Kushtetutës parashikon si më poshtë:

Neni D – Vlerësimi i pasurive

"1. Subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklarimit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur.

2. Subjekti i rivlerësimit dorëzon një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë në përputhje me ligjin. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave kontrollon deklaratën e pasurisë dhe i dorëzon Komisionit një

raport për ligjshmërinë e pasurive, për saktësinë dhe plotësinë e deklarimit, sipas ligjit.

3. Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj.

4. Nëse subjekti i rivlerësimit ka një pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme, ai prezumohet fajtor për shkeljen disiplinore, përveçse kur ai paraqet prova që vërtetojnë të kundërtën.

5. Nëse subjekti i rivlerësimit nuk e dorëzon deklaratën e pasurisë në kohë sipas ligjit, ai shkarkohet nga detyra. Nëse subjekti i rivlerësimit përpiqet të fshehë ose të paraqesë, në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën.".

2. Ligji për Rivlerësimin (ligji nr. 84/2016 për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve)

28. Neni 4(1) parashikon se rivlerësimi kryhet mbështetur në tri kritere: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale. Neni 4(a) parashikon se KPK-ja dhe KPA-ja janë institucionet që vendosin për rivlerësimin përfundimtar të personave të kontrolluar, dhe se vendimi bëhet mbështetur në një ose më shumë kritere, në vlerësimin e përgjithshëm të të tria kritereve, ose në një vlerësim tërësor të procedurave. Sipas nenit 4(5), si KPK-ja edhe KPA-ja ushtrojnë funksionet e tyre si organe të pavarura, mbështetur në parimet e barazisë përpara ligjit, kushtetueshmërisë, ligjshmërisë, propocionalitetit dhe parimeve të tjera që garantojnë të drejtën për një gjykim të drejtë të personit të rivlerësuar/vetuar. Sipas nenit 4(6), organet e *vetting*-ut mund të zbatojnë procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, ose në Ligjin për Gjykatat Administrative (ligji nr. 49/2012; shih për shembull paragrafin 45 më poshtë), kur këto procedura nuk referohen në Kushtetutë ose në Ligjin për Rivlerësimin.

29. Neni 30 parashikon se objektivi i vlerësimit të pasurive është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, ligjshmëria e burimit të përdorur për përftimin ose krijimin e tyre, përmbushja e detyrimeve financiare, duke përfshirë interesat privatë të personit të rivlerësuar dhe të personave të lidhur me të. Sipas nenit 31(1), personi i rivlerësuar duhet të dorëzojë një deklaratë për pasuritë pranë ILDKPKI-së.

30. Neni 32 parashikon si më poshtë:

"1. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën e pasurisë, paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.

2. Nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t'i vërtetojë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër. Institucionet e rivlerësimit vendosin nëse mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkaqe të arsyeshme. Ky rregull zbatohet edhe në ato raste kur organi përgjegjës për lëshimin e dokumenteve justifikuese nuk përgjigjet brenda afatit ligjor.

...

4. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.

5. Deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelimit."

31. Neni 33 parashikon se ILDKPKI-ja është institucioni përgjegjës për verifikimin e deklaratës së pasurive. Sipas nenit 33(5), ILDKPKI-ja, pas përfundimit të vlerësimit, përgatit një raport të arsyetuar dhe të detajuar ku përcakton, nëse: i. deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin, i mbështetur me burime financiare të ligjshme, dhe nëse ka ndonjë konflikt interesi; ii. ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; iii. janë fshehur pasuri; iv. personi i rivlerësuar ka bërë deklaratë të rremë; v. personi i rivlerësuar është përfshirë në konflikt interesi.

32. Sipas nenit 45, KPK-ja, KPA-ja dhe vëzhguesit ndërkombëtarë (të emëruar nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit) hetojnë dhe shqyrtojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e

nevojshme për procedurat e rivlerësimit. Ata mund të kërkojnë informacione nga çdo autoritet publik. Ata administrojnë dokumente që provojnë ekzistencën e veprimeve, fakteve ose ndonjë situate tjetër të nevojshme për realizimin e hetimit administrativ.

33. Sipas nenit 49(1), organet e rivlerësimit marrin dokumente ligjore, mbledhin deklarata nga personi i rivlerësuar, dëshmitarët, ekspertët dhe nga publiku, dhe marrin dokumente të tjera me shkrim për të përcaktuar faktet dhe rrethanat për secilën çështje. Sipas nenit 49(6)(a), organet e rivlerësimit mund të mos pranojnë marrjen e provave të reja, nëse për shembull, marrja e atyre provave është e panevojshme. Sipas nenit 49(9), organet e *vetting*-ut japin arsye për kundërshtimin e kërkesës për marrjen e provave të reja. Sipas nenit 51, nëse personi i rivlerësuar nuk paraqet prova, ose provat e ofruara nuk janë të plota, organet e rivlerësimit mund të vendosin mbështetur në provat që tashmë janë vënë në dispozicionin e tyre.

34. Neni 52 parashikon se organet e *vetting*-ut duhet të udhëhiqen nga parimet e objektivitetit dhe të proporcionalitetit. Nëse ata arrijnë në përfundimin se provat e mbledhura gjatë hetimit administrativ në përputhje me nenin 45 kanë nivelin e pranueshmërisë, personi i rivlerësuar ka barrën e provës për të paraqitur prova ose të japë shpjegime të tjera për të kundërtën.

35. Sipas nenit 61, shkarkimi nga detyra mund të urdhërohet në këto raste:

"1. Kur rezulton se ka deklaruar më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme gjatë vlerësimit të pasurisë, përfshirë edhe personat e lidhur me të.

2. Kur rezulton me probleme serioze gjatë kontrollit të figurës, sepse ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar që bën të pamundur vazhdimin e detyrës.

3. Kur rezulton se ka bërë deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës dhe pasurisë, sipas parashikimeve të neneve 39 dhe 33 të këtij ligji.

4. Kur rezulton si i papërshtatshëm nga vlerësimi i aftësive profesionale.

5. Në rast se nga vlerësimi tërësor, në kuptim të nenit 4, pika 2, të këtij ligji, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit."

C. Statusi i prokurorëve në Shqipëri

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

36. Neni 148 i Kushtetutës (ndryshuar me ligjin nr. 76 të datës 22 korrik 2016) parashikon si më poshtë:

"1. Prokuroria ushtron ndjekjen penale, si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit. Prokuroria kryen edhe detyra të tjera të caktuara me ligj.

2. Prokuroria është organ i pavarur që garanton mbarëvajtjen, kontrollin e veprimeve të saj dhe respekton pavarësinë e brendshme të prokurorëve për hetimin dhe ndjekjen penale, sipas ligjit.

3. Prokuroria është organizuar dhe funksionon pranë sistemit gjyqësor...".

2. Ligji për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve (ligji nr. 96/2016 për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve)

37. Neni 2 parashikon statusin e "magjistratëve", i cili shtrihet për prokurorët dhe gjyqtarët, me përjashtim të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

38. Neni 3 ("Vlerat themelore") parashikon si më poshtë:

"1. Magjistrati ushtron funksionet e tij, në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin.

2. Magjistrati ushtron funksionet në mënyrë të pavarur, duke vlerësuar faktet dhe interpretuar ligjin, sipas bindjes së tij të brendshme, i lirë nga çdo ndikim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë nga çdo palë dhe për çdo arsye.

3. Magjistrati nuk duhet të krijojë kontakte të papërshtatshme dhe nuk duhet të ndikohet nga pushteti ekzekutiv ose nga pushteti legjislativ. Magjistrati duhet të marrë çdo masë për të qenë dhe të duket se është jashtë çdo ndikimi prej tyre. Magjistrati njofton menjëherë Këshillin dhe kryetarin, në rast se evidenton ndërhyrje ose ushtrim të ndikimit të papërshtatshëm ndaj tij.

4. Magjistrati ushtron funksionet gjyqësore në mënyrë të paanshme, pa ndikim dhe pa paragjykime.

5. Sjellja e magjistratit gjatë ushtrimit të funksionit dhe jashtë tij garanton ruajtjen dhe forcimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, profesioni ligjor dhe palëve në proces. Magjistrati ushtron funksionet me drejtësi, në mënyrë korrekte, në kohë të arsyeshme, të ndërgjegjshme,

të kujdesshme, të zellshme dhe sistematike, me objektivitet, vetëpërmbajtje dhe maturi.".

3. Ligji për Prokurorinë

a) Ligji nr. 8737 i datës 12 shkurt 2001 (i ndryshuar në vitin 2003 dhe 2008)

39. Sipas nenit 17 të ish-Ligjit për Prokurorinë (zëvendësuar nga ligji nr. 97/2016, i datës 6 tetor 2016), për t'u emëruar si prokuror, një person duhej, *inter alia*, të kishte arsimin e lartë, të kishte përfunduar kursin përkatës të Shkollës së Magjistraturës dhe të kishte moral të lartë dhe cilësi profesionale.

40. Shkeljet disiplinore përfshinin, *inter alia,* veprimet që diskreditonin rëndë funksionin e prokurorit, ose që, sipas ligjit, nuk pajtoheshin me të (neni 32). Shkelje të tilla dënoheshin me vërejtje, vërejtje me paralajmërim për pushim nga detyra, ulje në detyrë ose shkarkim nga detyra (neni 33).

41. Gjykata Kushtetuese parashikonte se veprimet e rënda që diskreditonin funksionin zyrtar përfshinin sjelljen e papërshtatshme dhe të padenjë si gjatë kryerjes së detyrave zyrtare ashtu edhe jashtë atyre detyrave (vendimi nr. 75/2002).

b) Ligji nr. 97/2016 i datës 6 tetor 2016

42. Neni 6 ("Pavarësia e Prokurorëve") parashikon si më poshtë:

"1. Në ushtrimin e funksioneve të tyre, prokurorët kryejnë veprime, parashtrojnë kërkesa dhe marrin vendime në mënyrë të pavarur, bazuar në parimet e ligjshmërisë, objektivitetit dhe paanshmërisë.

2. Prokurorët u nënshtrohen udhëzimeve të përgjithshme me shkrim të prokurorit më të lartë, sipas dispozitave të këtij ligji.

3. Ligji garanton pavarësinë dhe autonominë e nevojshme për marrjen e vendimeve gjatë ushtrimit nga prokurorët të funksionit të tyre kushtetues e ligjor, pavarësisht ndikimit të paligjshëm të brendshëm apo të jashtëm nga çdo autoritet publik a privat.".

43. Sipas nenit 95, në rastin kur provohet një shkelje disiplinore, organi kompetent vendos një masë disiplinore në përputhje me parashikimet e Ligjit për Nëpunësin Civil (ligji nr. 152/2013 për nëpunësin civil). Masat disiplinore përfshijnë vërejtje, mbajtje deri në një të tretën nga paga e plotë deri në gjashtë muaj, pezullim nga e drejta për t'u rritur në detyrë dhe shkarkim nga shërbimi civil (neni 58 i ligjit për Nëpunësin Civil).

4. Kodi i Etikës për Prokurorët

44. Kodi u miratua më 19 qershor 2014 me anë të urdhrit nr. 141 të Prokurorit të Përgjithshëm. Ai përmban kërkesat mbështetur në standarde të larta për sjelljen profesionale të prokurorëve brenda dhe jashtë aktiviteteve të tyre profesionale (*inter alia,* seksioni 8 i Kodit). Veprimet që diskreditojnë figurën e prokurorit sipas parashikimit të Nenit 149 të Kushtetutës dhe nenit 32 të ish-Ligjit për Prokurorinë (shih paragrafët 40–41 më sipër), përbëjnë shkelje të këtyre kërkesave dhe mund të çojnë në procedura disiplinore (neni 17 i Kodit).

D. Legjislacioni dhe dokumente të tjera përkatëse

1. Ligji për Gjykatat Administrative (ligji nr. 49/2012 për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative)

45. Neni 47 parashikon se një ankues mund të mos paraqesë fakte të reja apo të kërkojë prova të reja për apelimin, në rast se ai ose ajo nuk mund ta demonstrojë këtë gjë, pasi jo për fajin e tij apo të saj, nuk u bë e mundur që të paraqiteshin faktet e reja apo të kërkoheshin prova të reja gjatë shqyrtimit të çështjes në shkallë të parë sipas afateve të parashikuara në ligj.

2. Ligji për Avokatët (ligji nr. 55/2018, për profesionin e avokatit)

46. Sipas nenit 5, një personi i cili nuk ka marrë titullin e avokatit, sipas parashikimeve të ligjit, nuk i lejohet që të veprojë si përfaqësues i palëve ose të hartojë dokumente me shkrim për palët në proceset gjyqësore ku palët mund të përfaqësohen nga një avokat sipas legjislacionit në fuqi, apo të jetë përfaqësues i palës kur nuk është pjesë e njërës prej kategorive të subjekteve që mund të përfaqësojnë palët në mbështetje të legjislacionit procedural në fuqi.

47. Sipas nenit 7, teksa ushtron profesionin, një avokat nuk mund të ushtrojë njëkohësisht detyrat e gjyqtarit, prokurorit, noterit, përmbaruesit, si edhe as ndonjë funksion apo detyrë tjetër në organet publike, përveç mësimdhënies në institucionet e arsimit të lartë brenda ose jashtë vendit. Avokatët e punësuar nga subjekte private mund të ushtrojnë profesionin e avokatit vetëm mbështetur në një marrëveshje me shkrim të nënshkruar për këtë qëllim midis avokatit dhe punëdhënësit privat për të siguruar mbarëvajtjen e detyrave të avokatit sipas ligjit. Një kopje e marrëveshjes me shkrim e nënshkruar në përputhje me nenin 7(2) duhet të

depozitohet pranë Dhomës Kombëtare të Avokatisë.

48. Sipas nenit 13(1), e drejta për të ushtruar profesionin fillon në momentin e marrjes së titullit të "avokatit". Sipas nenit 13(a)(e), e drejta për të marrë titullin "avokat" është e hapur për qytetarët shqiptarë të cilët nuk janë shkarkuar nga detyra ose nga një funksion publik, për një shkelje të integritetit etik, me anë të një vendimi të formës së prerë nga autoriteti kompetent, me përjashtim të çështjeve kur masa disiplinore është shuar sipas legjislacionit të zbatueshëm.

49. Neni 51 parashikon se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë është gjykata kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative krijuar nga vendimet e Komisionit Disiplinor parashikuar nga Ligji për Avokatët.

3. Statuti i Dhomës së Avokatëve Shqipëri

50. Neni 49 i Statutit të Dhomës Kombëtare të Avokatëve të vitit 2019 parashikon afatin referuar në nenin 13(2)(e) të Ligjit për Avokatët për përfundimin e masës disiplinore ndaj personave të cilët aplikojnë për marrjen e titullit të avokatit. Për gjyqtarët dhe prokurorët, të cilët me anë të një vendimi të formës së prerë, nuk kalojnë procesin e *vetting*-ut, për shkak të vlerësimit të pasurive dhe kontrollit të figurës, afati për shuarjen e masës disiplinore është pesë vjet. Nëse shkarkimi nga detyra bëhet për shkak të vlerësimit të kompetencës profesionale, afati nuk është i zbatueshëm.

II. MATERIALE TË TJERA TË LIDHURA ME ÇËSHTJEN

A. Komisioni i Venecias

51. Raporti për standardet evropiane në lidhje me pavarësinë në sistemin gjyqësor: Pjesa II: Prokuroria (miratuar në vitin 2010) parashikon se prokurori – duke qenë se ai ose ajo vepron në emër të shoqërisë në tërësi dhe për shkak të pasojave të rënda të dënimit penal – duhet të veprojë me një standard më të lartë sesa pala ndërgjyqëse në çështjen civile. Edhe në sistemet të cilët nuk e konsiderojnë prokurorin si pjesë të gjyqësorit, prokurori pritet që të veprojë në mënyrë të ligjshme. Një prokuror, ashtu si edhe një gjyqtar, nuk mund të trajtojë një çështje ku ai ose ajo ka interes personal, dhe mund t'u nënshtrohet kufizimeve të caktuara, me qëllim ruajtjen e paanshmërisë dhe integritetit të tij. Të gjitha këto detyra theksojnë nevojën për të punësuar si prokurorë personat e duhur me një reputacion të lartë dhe karakter të mirë. Cilësitë e kërkuara nga një prokuror janë të ngjashme me ato të një gjyqtari dhe kërkojnë që të zbatohen procedurat e duhura për emërimin dhe promovimin. Është e nevojshme që një prokuror, ashtu edhe si një gjyqtar, mund të ketë raste të marrë vendime që nuk mirëpriten nga publiku, dhe që mund të bëhen subjekt i kritikave në medie dhe mund të bëhen subjekt edhe i polemikave politike. Për këto arsye, është e nevojshme që të sigurohet afati i duhur në detyrë dhe organizimet e duhura për promovimin, disiplinën dhe shkarkimin, të cilat do të garantojnë se një prokuror nuk mund të viktimizohet për marrjen e një vendimi që nuk mirëpritet. Në rastin kur një gjyqtar nuk plotëson standardin e kërkuar, gjyqtari i paanshëm mund të korrigjojë gabimin që është bërë. Megjithatë, nuk ka garanci për një korrigjim të tillë dhe, në çdo rast, mund të shkaktohet një dëm i madh. Një sistem ku si prokurori edhe gjyqtari veprojnë sipas standardeve më të larta të integritetit dhe paanshmërisë ofron një mbrojtje më të madhe të të drejtave të njeriut sesa një sistem i cili mbështetet vetëm te gjyqtari.

52. Opinioni CDL-AD(2021)028 për përgjegjësinë e zyrtarëve publikë për deklarimin e pasaktë të pasurisë në Ukrainë përcakton se detyra e zyrtarëve publikë për të dorëzuar deklarata të sakta për pasuritë ekziston në forma të ndryshme, në shumë sisteme juridike demokratike. Për të qenë efikas, ky mekanizëm ligjor duhet të shoqërohet me sanksionet e duhura, në varësi të një sërë faktorëve të tillë si kategoria e zyrtarëve publikë të përfshirë, shuma e pasurive të padeklaruara, të ardhurat mesatare në një shtet të caktuar si edhe niveli i problemit të korrupsionit në këtë shtet.

B. Këshilli Konsultativ i Prokurorëve Evropianë (KKPE)

53. Opinioni nr. 13 (2018) për pavarësinë, llogaridhënien dhe etikën e prokurorëve, nga KKPE-ja që vepron sipas mandatit të dhënë nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës parashikon si më poshtë:

"21. Respektimi i rregullave etikë është një detyrë themelore që duhet të udhëheqë aktivitetet e prokurorëve. Është e rëndësishme të jetë e mundur referimi te përpilimet që përmbajnë parime etike të prokurorëve të cilat duhet të udhëheqin sjelljen e tyre.

22. Sjellja e prokurorëve, ashtu edhe si gjyqtarët, nuk mund të lihet vetëm në diskrecionin e tyre, si gjatë detyrës edhe jashtë saj. Një gjë e tillë është veçanërisht e rëndësishme kur vlerësohen aktivitete të prokurorëve dhe në procedurat disiplinore ndaj tyre.

...

51. Respektimi i shtetit të së drejtës kërkon standardet më të larta etike dhe profesionale në sjelljen e prokurorëve, ashtu si edhe të gjyqtarëve, si gjatë detyrës edhe jashtë saj, gjë e cila bën të mundur fitimin e besimit të shoqërisë te drejtësia. Prokurorët veprojnë në emër të njerëzve dhe në interesin publik. Për këtë arsye, ata duhet të kujdesen gjithmonë për integritetin personal dhe të veprojnë në përputhje me ligjin, në mënyrë të drejtë, të paanshme dhe objektive, duke respektuar dhe ruajtur të drejtat dhe liritë themelore, duke përfshirë prezumimin e pafajësisë, të drejtën për një gjykim të drejtë, dhe parimet e barazisë së armëve, ndarjeve të pushteteve, dhe forcën detyruese të vendimeve gjyqësore. Ata kanë për detyrë të jenë të lirë nga ndikimi politik dhe ndikime të tjera.

...

55. Ata duhet të demonstrojnë integritet të plotë në sjelljen e tyre dhe të mos pranojnë asnjë lloj përfitimi apo pagese që kanë lidhje me përmbajtjen e zgjedhjeve të tyre, dhe as të zhvillojnë ambicie profesionale që mund të udhëheqin vendimet e tyre në mënyrë të gabuar (për shembull për të kënaqur një autoritet të caktuar politik ose administrativ).".

C. Konferenca e Prokurorëve të Përgjithshëm të Evropës (KPPE)

54. Udhëzimet Evropiane për etikën dhe sjelljen e prokurorëve publikë ("Udhëzimet e Budapestit"), KPPE (2005) 05, rekomandojnë se prokurorët publikë gjatë gjithë kohës duhet të ushtrojnë standardet më të larta të integritetit dhe të kujdesit, dhe – ashtu si edhe me sjelljen në jetën private – nuk duhet të kompromet ojnë integritetin real ose të perceptuar në mënyrë të arsyeshme, drejtësinë dhe paanshmërinë e prokurorisë publike me anë të veprimtarive në jetën e tyre private. Ata duhet të respektojnë dhe t'i binden ligjit gjatë gjithë kohës, dhe duhet të sillen në mënyrë të tillë që të përforcojnë dhe ruajnë besimin e publikut në profesionin e tyre.

D. Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO)

55. GRECO monitoron respektimin nga ana e shteteve të standardeve kundër korrupsionit të Këshillit të Evropës. Ai punon në cikle, të njohura si raundet e vlerësimit, ku secili cikël trajton tema specifike. Ekipi i vlerësimit të GRECO (GET) përgatit një raport vlerësimi, i cili mund të përmbajë rekomandime që kërkojnë marrjen e masave nga shteti për të garantuar pajtueshmërinë me të (shih edhe *Xhoxhaj kundër Shqipërisë,* nr. 15227/19, §§ 217-20, 9 shkurt 2021).

56. Në lidhje me prokurorët në Shqipëri, Raporti i Vlerësimit të GRECO-s, i publikuar në vitin 2014 brenda raundit të katërt të vlerësimit, përcakton si më poshtë:

"106. Prokuroria ... nuk është as pjesë e ekzekutivit dhe as e degëve të pushtetit gjyqësor, për shkak të natyrës së funksioneve të saj; ajo është një organ *sui generis*, i vetmi në llojin e tij, garancitë e autonomisë së saj përforcohen me anë të ndalimit të anëtarësimit në një parti politike dhe administrimit të buxhetit të saj...

115. "Cilësitë e moralit të lartë" janë vendosur si një kërkesë e përgjithshme për emërimin dhe rritjen në detyrë të prokurorëve. Megjithatë, GET u bë me dije se teksa shqyrton të dhënat për kandidatët për prokurorë, Këshilli i Prokurorëve mbështetet në opinionin paraprak të departamenteve të burimeve njerëzore të Shkollës së Magjistraturës dhe të policisë gjyqësore, dhe nuk kryen kontrolle të veçanta për integritetin. GET thekson se rregullat e detajuar për paraqitjen, përzgjedhjen, verifikimin dhe testimin e kandidatëve për prokurorë përcaktohen nga Prokurori i Përgjithshëm. Ky i fundit përcakton edhe kriteret për vlerësimin e brendshëm dhe lëshon rregulla për sistemin e pikëve për rritjen në detyrë. Shqyrtimi i një formulari tip për vlerësimin megjithatë tregon se kriteret për vlerësimin e moralit të prokurorëve dhe cilësitë etike nuk janë përcaktuar. Në këtë mënyrë, me qëllim përforcimin e uniformitetit, parashikueshmërisë dhe transparencës për emërimin dhe rritjen në detyrë të prokurorëve, GRECO rekomandon përmirësimin e mëtejshëm të kritereve për vlerësimin e cilësive etike të prokurorëve, veçanërisht duke garantuar se kriteret janë objektive dhe transparente...

Parimet etike dhe rregullat për sjelljen

....

127. Për Prokurorinë në tërësi nuk zbatohet asnjë kod sjellje apo etike. Duke qenë se

anëtarësimi në Shoqatën e Prokurorëve është vullnetar dhe nuk mbulon të gjithë prokurorët shqiptarë, jo të gjithë janë të lidhur me Kodin e përgatitur nga Shoqata, dhe nuk janë nën juridiksionin e Komisionit të saj të Etikës. Gjithashtu, GET u vu në dijeni se vet Komisioni nuk është operacional dhe, që prej krijimit të tij, ai nuk ka shqyrtuar ndonjë shkelje të rregullave të etikës... GRECO rekomandon, se: i. duhet të përgatitet dhe të zbatohet rregullisht një grup standardesh/kod i qartë etik për sjelljen profesionale që duhet të jetë i zbatueshëm për të gjithë prokurorët; dhe ii. prokurorëve iu duhet ofruar udhëzime, këshillim dhe trajnim i detyruar në vendin e punës mbi etikën, konfliktet e interesit dhe parandalimin e korrupsionit brenda niveleve të tyre.

...

Deklarimi i pasurisë, të ardhurave, detyrimeve dhe interesave

135. Të gjithë prokurorët duhet të deklarojnë pronat, të ardhurat, detyrimet dhe interesat e tyre, brenda së njëjtës fushë veprimi dhe me të njëjtat kushte si deputetët dhe gjyqtarët pranë Inspektoratit të Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurisë (ILDKP). Shkeljet sanksionohen me anë të gjobave administrative, me përjashtim të refuzimit për të deklaruar apo mosdeklarimit, fshehjes ose deklarimit të rremë të pasurisë, të cilat janë vepra penale dhe shkelje shumë të rënda disiplinore që çojnë në shkarkimin nga detyra. Ashtu si edhe me gjyqtarët, mungesa e deklarimit në kohë, *online*, të elementeve përbërëse në deklarimet e prokurorëve për pasurinë shkatërron transparencën dhe dëmton interesin legjitim të publikut në marrjen e informacioneve për personat që ushtrojnë një funksion zyrtar. Edhe pse GRECO tërhiqet nga adresimi i kësaj çështje me anë të një rekomandimi të veçantë, ai i fton autoritetet të publikojnë të dhëna në faqen zyrtare të Prokurorisë ose të ILDKP-së, duke u kushtuar vëmendje privatësisë dhe sigurisë së prokurorëve dhe personave të lidhur me ta, të cilët kanë detyrimin për të raportuar.

....

137. Deklarimet e prokurorëve për pasurinë monitorohen nga ILDKP-ja në të njëjtën mënyrë dhe qëllim edhe për gjyqtarët dhe deputetët, me disa përjashtime: deklarimet e Prokurorit të Përgjithshëm duhet të kontrollohen çdo dy vjet, deklarimet e prokurorëve të apelit dhe të atyre të caktuar në Prokurorinë e Përgjithshme çdo tre vjet, dhe deklarimet e bëra nga kategoritë e tjera të prokurorëve i nënshtrohen kontrollit rastësor të përvitshëm. Drejtoria e Inspektimeve dhe e Burimeve Njerëzore nën Prokurorinë e Përgjithshme parashikon udhëzimet për mënyrën e plotësimit të deklaratave për të gjithë prokurorët dhe paraqet formularët e plotësuar rregullisht pranë ILDKP-së, brenda afateve të caktuara nga ligji... Ashtu si me gjyqtarët, zbatohet një qasje me nivele, sipas së cilës, në varësi të vjetërsisë në pozicion, disa kategori prokurorësh u nënshtrohen kontrolleve më të shpeshta dhe të detajuara. Sipas kontekstit të Prokurorisë, një qasje e tillë e rregullt rezulton të jetë e justifikuar, por mangësitë në funksionimin e ILDKP-së, tashmë të diskutuara në këtë raport, nuk duhet të anashkalohen.".

E. Konventat e Këshillit të Evropës

57. Sipas Konventës së Ligjit Penal për Korrupsionin (ETS nr. 173), një "zyrtar publik" kuptohet duke iu referuar përkufizimit të fjalës "zyrtar", "zyrtar publik", "kryebashkiak", "ministër" ose "gjyqtar" në ligjin vendës të shtetit në të cilin personi konkret kryen atë funksion dhe sipas legjislacionit penal; termi "gjyqtar" përfshin prokurorët dhe mbajtësit e funksioneve gjyqësore (neni 1, shih edhe nenet 26 § 3 dhe 30 § 2). Një qëndrim i ngjashëm rezulton të miratohet në Konventën e Këshillit të Evropës për Pastrimin, Kërkimin, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e të Ardhurave nga Krimi dhe për Financimin e Terrorizmit (CET Nr. 198) (Neni 28 §§ 3 dhe 7, dhe Neni 34 § 2).

LIGJI

I. PRETENDIM PËR SHKELJE TË NENIT 6 TË KONVENTËS

58. Kërkuesja u ankua për një shkelje të nenit 6 të Konventës, pjesët përkatëse të së cilës parashikojnë si më poshtë:

"1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile...".

A. Parashtrimet e palëve

1. Kërkuesja

a) Zbatueshmëria e nenit 6

59. Kërkuesja argumentoi se neni 6 ishte i zbatueshëm për procedurat vendëse, në aspektin civil dhe atë penal (krahaso *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, nr. 15227/19, § 235, 9 shkurt 2021), dhe deklaroi se organet e *vetting*-ut kryenin një funksion gjyqësor dhe ishin "gjykata" sipas interpretimit të atij neni.

b) Pavarësia dhe paanshmëria

60. Kërkuesja kundërshtoi në lidhje me pavarësinë dhe paanshmërinë e organeve të *vetting*-ut, në tërësi dhe, veçanërisht, për sa upërket trupave gjykuese në çështjen e saj. Ajo argumentoi se anëtarët e tyre nuk i nënshtroheshin ndonjë forme *vetting*-u, se mandati i tyre ishte i kufizuar në kohë dhe se nuk ekzistonte ndonjë njohje formale për mosndryshimin e tyre. Ata ishin të ekspozuar ndaj presionit politik dhe merrnin një "bonus për performancën" të posaçëm vetëm një herë. Trupat gjykuese në çështjen e saj nuk kishte në përbërje dikë që të kishte mbajtur një pozicion në gjyqësor ose të kishte eksperiencën dhe ekspertizën e mjaftueshme profesionale për të trajtuar çështjet faktike dhe ligjore që kishin dalë në këtë çështje. Një anëtar i trupës gjykuese të KPA-së në çështjen e saj, A.H., ishte diplomuar me një notë mesatare nën mesataren e kërkuar për një anëtar të organit të *vetting*-ut sipas Ligjit të *Vetting*-ut. Një person që ishte pjesë e një trupi gjykues të KPA-së (jo në çështjen e saj) ishte ndjekur penalisht (shih *Xhoxhaj*, cituar më sipër, §§ 90-92). Trupi gjykues i KPK-së kishte kryer hetimin paraprak dhe kishte vendosur për meritat e çështjes. Organet e *vetting*-ut nuk kishin marrë në konsideratë raportin pozitiv të ILDKPKI-së, pa dhënë arsye.

c) Drejtësi

61. Kërkuesja argumentoi se proceset e *vetting*-ut kishin shkaktuar një mohim flagrant të drejtësisë për arsyet në vijim. Duke mbyllur hetimin vetëm për vlerësimin e pasurisë, organet e *vetting*-ut kishin gjykuar para kohe rezultatin e çështjes, dhe ndërsa ajo u shkarkua pasi nuk kaloi vlerësimin e pasurive, ajo do të mund të ishte konfirmuar në detyrë nëse do të kishte kaluar me sukses në të tria vlerësimet (pasuritë, integriteti dhe aftësia profesionale). Përfundimi se ajo kishte pasuri në një vlerë dyfish më të madhe sesa të ardhurat e saj të ligjshme ishte arritur vetëm me anë të vendimit të datës 20 prill 2018. Një gjë e tillë nuk ishte diskutuar gjatë hetimit ose procedurave përpara KPK-së. Ajo nuk ishte përcaktuar si problematike – që do të thotë, teksa kërkoheshin parashtrimet e kërkueses pas ndryshimit të barrës së provës – në vendimin e datës 13 mars 2018, i cili kishte përmbyllur hetimin. KPA-ja nuk e kishte kompensuar atë të metë të rëndë, duke menduar se ai përfundim kishte nënkuptime në akuzat ndaj saj në fund të hetimit, dhe se ajo duhej ta kishte paraparë këtë gjë. Kjo kishte rënduar shkeljen, duke ndryshuar në mënyrë radikale gjetjet e KPK-së në vendimin e saj, përsëri duke e gjetur mbrojtjen të papërgatitur (shih më poshtë).

62. Asaj nuk iu lejua të dorëzonte përpara KPA-së prova të tjera shfajësuese për të provuar fakte të caktuara e të rëndësishme dhe elemente ligjore në çështjen kundër saj, se: ajo kishte pasur pronësi reale ndaj ndërtesës së shembur në Lezhë; se vjehrra e saj kishte marrë të ardhura nga shitja e dy trojeve në vitin 2008; se A.M. kishte pasur mjaftueshëm të ardhura për t'i dhënë familjes së saj një hua të vogël për të blerë makinën e tyre të vetme; dhe se në çdo rast, ajo kishte pasur burime legjitime për t'ia kthyer borxhin; dhe se ajo kishte pasur burime financiare për të mbledhur kursime të rëndësishme gjatë viteve, duke pasur në konsideratë shpenzimet familjare për jetesën.

d) Ankesa të tjera

63. Ankesat e tjera të kërkueses dhe parashtrimet e tjera janë të ngjashme me ato në vendimin *Xhoxhaj* (cituar më sipër, §§ 259-65, 318-20, 337 dhe 345).

2. Qeveria

64. Qeveria argumentoi se aspekti civil në nenin 6 ishte i zbatueshëm në proceset e *vetting*-ut dhe se organet e *vetting*-ut ishin "gjykata" sipas kuptimit të nenit 6.

65. Kërkuesja nuk kishte dorëzuar pranë organeve të *vetting*-ut ndonjë kërkesë në lidhje me kohën e pamjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen; se ajo nuk kishte kërkuar shtyrje apo kohë shtesë për të studiuar apo sjellë prova. Ajo nuk kishte kërkuar përjashtimin e ndonjërit prej anëtarëve të trupës gjykuese të KPA-së. Vendimi i tyre për të shqyrtuar apelimin me dyer të mbyllura pa praninë e palëve kishte qenë i ligjshëm dhe i justifikuar.

66. KPA-ja kishte gjykuar se burimet e të ardhurave për krijimin e pasurive të saj nuk ishin qartësuar me anë të provave dokumentare të parashikuara nga legjislacioni. Kërkuesja dhe bashkëshorti i saj kishin vepruar si pronarët

legjitimë të apartamentit në Lezhë edhe pse nuk kishin pasur të drejtë ligjore për të pretenduar se ai apartament ishte pronë e tyre. Në këtë mënyrë, ajo nuk kishte provuar ligjshmërinë e burimit të përdorur për krijimin e pasurive të saj, sipas parashikimit të nenit 32(4) të Ligjit për *Vetting*-ut. Kërkuesja nuk kishte pasur burime të mjaftueshme për t'i përftuar ato dhe kishte bërë deklaratë të rreme.

67. Parashtrimet e Qeverisë janë thelbësisht të ngjashme me ato në vendimin *Xhoxhaj (*cituar më sipër, §§ 266-69, 321-23, 338 dhe 346-47).

3. Palët e treta

68. Parashtrimet e palëve të treta janë të përmbledhura në vendimin *Xhoxhaj* (cituar më sipër, §§ 270-79).

69. Në vendimin *Xhoxhaj* (cituar më sipër, §§ 236-46), Gjykata vendosi se aspekti civil i nenit 6 ishte i zbatueshëm në procedurat e *vetting*-ut, por aspekti penal nuk ishte i zbatueshëm. Duke pasur në konsideratë zbatueshmërinë e aspektit civil dhe mungesën e vërtetueshmërisë në lidhje me aspektin penal, Gjykata do të vlerësojë vetëm, ashtu si në *Xhoxhaj*, ankesën e kërkueses duke iu referuar aspektit civil të nenit 6.

70. Në *Xhoxhaj* (cituar më sipër, §§ 284-86), Gjykata shprehej se organet e *vetting*-ut ishin "gjykata" sipas interpretimit të nenit 6 § 1. Gjykata nuk gjen arsye të gjykojë ndryshe në çështjen konkrete.

1. Pavarësia dhe paanshmëria

71. Nocioni "gjykatë" nënkupton se ajo duhet të përbëhet nga gjyqtarë të përzgjedhur mbi bazë të meritës – që do të thotë, gjyqtarë të cilët përmbushin kërkesat e kompetencës teknike dhe të integritetit moral për të kryer funksionet gjyqësore të kërkuara prej saj në një shtet të drejtuar nga shteti i së drejtës (shih *Guðmundur Andri Ástráðsson kundër Islandës* [DHM], nr. 26374/18, §§ 220-21, 1 dhjetor 2020). Një proces rigoroz për emërimin e gjyqtarëve të zakonshëm është i një rëndësie kryesore për të garantuar se në postet gjyqësore emërohen kandidatët më të kualifikuar në të dy këto aspekte. Sa më lart të pozicionohet një "gjykatë" në hierarkinë gjyqësore, aq më kërkuese duhet të jenë kriteret e zbatueshme për përzgjedhjen. Një përzgjedhje e tillë e mbështetur në meritë jo vetëm që garanton kapacitetin teknik të një organi gjyqësor për dhënien e drejtësisë si "gjykatë", por është thelbësore edhe në termat e garantimit të sigurisë së publikut në gjyqësor dhe shërben si një garanci shtesë për pavarësinë personale të gjyqtarëve (ibid., § 222). Duke marrë në konsideratë gjetjet në vendimin *Xhoxhaj* (cituar më sipër, §§ 295-304), Gjykata vendos se mënyra e përzgjedhjes dhe e emërimit të anëtarëve të trupit gjykues të KPK-së në çështjen e kërkueses nuk paraqiste, *per se,* një shkelje të kërkesave për pavarësi ose paanshmëri objektive.

72. Fillimisht, Gjykata u referohet gjetjeve të saj në *Xhoxhaj* (ibid., §§ 305-08), në lidhje me kërkesën për paanshmëri objektive. Ndryshe nga procedurat e zakonshme disiplinore, procedurat e *vetting*-ut nuk fillonin me depozitimin e një ankese ose me një akuzë për sjellje të keqe. Si rezultat i veprimit automatik të Ligjit të *Vetting*-ut, KPK-ja nisi një hetim për tri deklarimet e depozituara nga kërkuesja në vend që të mbështetej në gjetjet e saj për nisjen e procedurave disiplinore ndaj saj. Trupi gjykues i KPK-së nuk mori rolin e një prokurori duke mos ngritur akuza ndaj saj. Në këtë mënyrë, detyrat e këtij trupi gjykues kufizoheshin vetëm në rivlerësim mbështetur në kriteret e parashikuara në aneksin e Kushtetutës dhe në Ligjin e *Vetting*-ut. Prandaj, ekzistonte konfuzion midis detyrimit statutor të KPK-së për të nisur një hetim, në të cilin nuk u ngrit asnjë akuzë apo gjetje për shkelje ndaj kërkueses, dhe detyrës së tij për të marrë një vendim për përgjegjësinë e saj disiplinore. Fakti se KPK-ja paraqiti gjetje paraprake nuk ishte mjaftueshëm për të nxitur pasiguri objektivisht të justifikuara për anshmërinë e tij. Sipas Gjykatës, e njëjta linjë arsyetimi qëndron e vërtetë në çështjen konkrete.

2. Drejtësia

73. Gjykata vëren se, ndryshe nga *Xhoxhaj*, në çështjen konkrete, KPK-ja ndoqi dhe përfundoi vetëm hetimet paraprake në lidhje me vlerësimin e pasurive, dhe më pas vendosi mbështetur në meritat e çështjes, pa u kaluar te kontrolli i figurës dhe vlerësimi i kompetencës profesionale. Një gjë e tillë ishte në linjë me Ligjin e *Vetting*-ut sipas interpretimit të KPA-së. Sipas Gjykatës, një qasje e tillë nuk shkaktonte, *per se*, një shkelje të së drejtës së kërkueses për një gjykim të drejtë.

74. Mbetet i pakundërshtuar fakti se pasuritë kryesore që ishin subjekt i vlerësimit dhe që u përcaktuan si problematike ishin të njëjtat në të gjitha fazat e procedurave pranë KPK-së, siç pohohej edhe në vendimet e datave 13 mars dhe 20

prill 2018. Baza ligjore (specifikisht, neni D § 3 i Aneksit të Kushtetutës, cituar në paragrafin 27 më sipër), argumentet dhe arsyet kryesore ligjore për të cilat fillimisht ato u morën në shqyrtim dhe më pas u gjykuan nga KPK-ja si problematike, mbetën kryesisht të njëjtat.

75. Neni 4(6) i Ligjit të *Vetting*-ut, së bashku me nenin 47 të Ligjit për Gjykatat Administrative, parashikon bazën ligjore për trajtimin e (pranimin e) provave rreth apelimit (shih paragrafët 28 dhe 45 më sipër). Nuk ekziston asnjë tregues se kërkuesja nuk kishte pasur mundësi të paraqiste, ose ndryshe ishte ndaluar të paraqiste prova të caktuara tashmë në procedurat pranë KPK-së. Sipas rrethanave të çështjes, Gjykata gjykon se mënyra me të cilën KPA-ja trajtoi provat nuk shkelte nenin 6 § 1 të Konventës. Në çdo rast, KPA-ja sqaroi se provat e reja të propozuara nuk do të kishin ndonjë ndikim vendimtar në rezultatin e çështjes.

76. Veçanërisht, si gjatë hetimit paraprak dhe gjatë procedurave të mëtejshme në KPK, kërkuesja ishte në dijeni për kërkesën për të paraqitur të dhëna me datën kur ajo (ose bashkëshorti i saj) kishte marrë të ardhurat nga shitja e trojeve, të cilat ishin deklaruar nga ajo se ishin përdorur për të marrë një apartament në Tiranë (shih paragrafët 7 dhe 10 më sipër). Në këtë aspekt, përpjekja e saj e mëpasshme për të sjellë prova shtesë në lidhje me datën në të cilën vjehrra e saj kishte marrë ato para nuk dukej se do të kishte ndikim mbi problematikat përkatëse faktike dhe ligjore të përcaktuara nga organet e *vetting*-ut, veçanërisht në nivel apeli. Po kështu, gjatë hetimit paraprak, kërkuesja ishte në dijeni për kërkesën sipas së cilës ajo duhej të provonte pronësinë e pronës së shkatërruar, kompensimin e përdorur, sipas saj, për të përvetësuar një tjetër pronë të përmendur në deklarimin e *vetting*-ut. Kur kërkuesja i përcaktoi, disi gjerësisht, kursimet e saj dhe kursimet familjare si burimin e përdorur për të përftuar pasuritë e paraqitura në atë deklarim ose për të përmbushur detyrimet pasurore, të tilla si ato për një hua private, duke qenë se ajo ishte një profesioniste me eksperiencë në fushën ligjore, ajo do të duhej të kishte kuptuar se ishte e rëndësishme, që sipas nenit D të aneksit të Kushtetutës, të provonte kapacitetin e saj dhe të familjes së saj për t'i akumuluar këto kursime në mënyrën dhe në shumën e specifikuar prej saj në deklarimin e *vetting*-ut. Nuk ka indicie se ajo nuk kishte pasur mundësi, ose ishte penguar që të paraqiste të gjitha provat përkatëse që tashmë ishin përpara KPK-së, veçanërisht pasi ishte njoftuar se barra e provës kishte kaluar tek ajo.

77. Gjithashtu, kërkuesja nuk e ka provuar pretendimin e saj se mënyra me të cilën ishin kryer procedurat e *vetting*-ut ishte, për sa ka të bëjë me nenin 6, arbitrare dhe ndiqte një qëllim të mëtejshëm për përndjekjen e saj, kryesisht, për bindjet dhe aktivitetet politike të bashkëshortit të saj (krahaso *Xhoxhaj*, cituar më sipër, § 296; *Navalnyy dhe Ofitserov kundër Rusisë,* nr. 46632/13 dhe 28671/14, § 129, 23 shkurt 2016, *Navalnyye kundër Rusisë*, nr. 101/15, § 88, 17 tetor 2017; dhe *Nevzlin kundër Rusisë*, nr. 26679/08, §§ 124-25, 18 janar 2022, në kontekstin e ankesës sipas nenit 18 të Konventës).

3. Përfundim

78. Për sa ka të bëjë me ankesat e tjera, pasi ka shqyrtuar parashtrimet e palëve, Gjykata gjykon se kërkuesja nuk i ka provuar ato dhe as nuk ka ngritur ndonjë argument meritor. Gjykata nuk konstaton asnjë arsye për të mos marrë në konsideratë gjetjet e saj përkatëse te *Xhoxhaj* (cituar më sipër, §§ 283-88, 294-317, 328-36, 341-44 dhe 348-53).

79. Konstatimet e mësipërme janë të mjaftueshme për t'i mundësuar Gjykatës të arrijë në përfundimin se ankesat e kërkueses, siç janë paraqitur dhe provuar në çështjen konkrete, nuk janë të mbështetura në fakte. Në këtë mënyrë, ato duhet të rrëzohen në përputhje me nenin 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës.

II. PRETENDIM PËR SHKELJE TË NENIT 8 TË KONVENTËS

80. Kërkuesja u ankua se ishte shkelur neni 8 i Konventës, për shkak të shkarkimit të saj nga detyra dhe vendimit që e ndalonte atë të praktikonte ligjin si avokate.

81. Pjesët përkatëse të nenit 8 parashikojnë si më poshtë:

"1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private...

2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve"

A. Qëllimi i ankesës përpara Gjykatës

82. Qëllimi i çështjes "referuar në" Gjykatë në ushtrimin e së drejtës për kërkesë individuale përcaktohet nga ankesa e kërkueses. Një ankesë përbëhet nga dy elemente: pretendimet faktike dhe argumentet ligjore. Sipas parimit *jura novit curia*, referuar shkaqeve ligjore të paraqitura nga kërkuesja sipas Konventës dhe Protokolleve të saj, Gjykata nuk gjen lidhje me çështjen, dhe ka fuqinë të vendosë për karakterizimin që do të jepet sipas ligjit për faktet e ankesës, duke e shqyrtuar atë sipas neneve dhe parashikimeve të Konventës që janë ndryshe nga ato mbi të cilat mbështetet kërkuesja. Megjithatë, ajo nuk mund ta mbështesë vendimin e saj mbi fakte që nuk janë trajtuar nga ankesa. Për ta bërë një gjë të tillë, do të ishte njëlloj sikur të merrej një vendim përtej qëllimit të çështjes; me fjalë të tjera, të vendosej mbi çështje që nuk "referohen" sipas interpretimit të nenit 32 të Konventës (shih *Radomilja dhe të Tjerët kundër Kroacisë* [DHM], nr. 37685/10, dhe 22768/12, § 126, 20 mars 2018, dhe *Udaltsov kundër Rusisë*, nr. 76695/11, § 186, 6 tetor 2020).

83. Në kërkesën e saj në Gjykatë, në muajin dhjetor 2018, kërkuesja ngriti dy ankesa, sipas nenit 8 të Konventës: i. për proceset e *vetting*-ut dhe rezultatin e tyre të drejtpërdrejtë, që do të thotë, shkarkimin e saj nga detyra; dhe ii. për ndalimin – që pretendohej se ngrihej sipas legjislacionit të zbatueshëm – që të praktikonte ligjin si avokate private, pas shkarkimit të saj nga detyra. Për këtë ankesë të dytë, në vitin 2020, ajo bëri me dije Gjykatën për korrespondencën e saj me Dhomën Kombëtare të Avokatisë për këtë çështje në muajin nëntor 2018 (shih paragrafin 23 më sipër).

84. Rezulton se qëllimi i ankesës përpara Gjykatës është i kufizuar vetëm te procedurat e *vetting*-ut që rezultuan në vendimin e KPA-së më datë 12 shtator 2018, dhe në ndalimin e mëpasshëm të kërkueses që të ushtrojë ligjin si avokate (anëtare e Shoqatës së Avokatëve).

B. Pranueshmëria

1. Në lidhje me shkarkimin e kërkueses nga detyra

85. Ashtu si në vendimin *Xhoxhaj* (cituar më sipër, § 356), Qeveria argumentoi se ankesa nuk përputhej *ratione materiae* me parashikimet e Konventës dhe se kërkuesja nuk kishte shteruar zgjidhjet vendëse. Kërkuesja nuk ra dakord.

86. Për arsyet e përmendura në *Xhoxhaj* (ibid., §§ 362-67), Gjykata i rrëzon argumentet e Qeverisë dhe gjykon se kjo ankesë nuk është as e pambështetur në fakte dhe as e papranueshme për ndonjë arsye tjetër listuar në nenin 35 të Konventës. Për këtë arsye, ajo duhet të deklarohet e pranueshme.

2. Në lidhje me ndalimin e kërkueses për të ushtruar ligjin

87. Kërkuesja argumentoi se shkarkimi i saj nga detyra në procedurat e *vetting*-ut kishte rezultuar në vendimin për ndalimin e saj në ushtrimin e ligjit si "avokate", sipas legjislacionit shqiptar. Në janar 2020, ajo bëri me dije Gjykatën, se në 9 nëntor 2018, kryetari i Dhomës Kombëtare të Avokatisë kishte rrëzuar kërkesën e saj për t'u regjistruar si avokate, për shkak të shkarkimit të saj si rezultat i procedurave të *vetting*-ut (shih paragrafin 23 më sipër). Sipas saj, ajo përgjigje provonte pa mëdyshje se ndalimi ekzistonte dhe ishte urdhëruar të zbatohej. Ajo nuk to të kishte kurrë mundësi të ushtronte ligjin si avokate private, që nënkupton se mundësitë për të që të mund të gjente punësim në fushën ligjore në përputhje me kualifikimet dhe eksperiencën e saj profesionale ishin reduktuar në masën që e bënte të pamundur ushtrimin e profesionit të saj.

88. Si përgjigje ndaj parashtrimeve të kërkueses në vitin 2020, Qeveria deklaroi se shkresa e datës 9 nëntor 2018 ishte përgjigje për kërkesën e saj për informacione në lidhje me legjislacionin e zbatueshëm dhe nuk kishte lidhje me ankesën e saj përpara Gjykatës për procedurat e *vetting*-ut. Kufizimet në ushtrimin e ligjit si avokate nuk kishin ardhur si rezultat i procedurës së *vetting*-ut. Në çdo rast, nëse shkresa e kundërshtuar do të merrej në konsideratë për një vendim, kërkuesja nuk kishte shteruar zgjidhjet vendëse duke kërkuar një proces në gjykatën administrative në mbështetje të Ligjit për Gjykatat Administrative.

89. Në *Xhoxhaj*, Gjykata shprehej si më poshtë:

"371. Në lidhje me çështjen në fjalë, Gjykata vëren se proceset ishin të udhëhequra dhe përfunduan në zbatim të ligjit nr. 84/2016. Institucionet e rivlerësimit nuk morën asnjë vendim në lidhje me të drejtën e kërkueses për të ushtruar profesionin e avokatit; ata nuk bënë as ndonjë referencë, qoftë edhe në mënyrë të nënkuptuar, në dispozitat e ligjit për avokatinë. Për më shumë, kërkuesja pohoi se ajo kishte një licencë për të ushtruar profesionin e avokatit. Në këto rrethana, Gjykata vëren se ajo nuk mund të pretendojë të jetë

viktimë e shkeljes së të drejtave të saj sipas nenit 8 të Konventës.

372. Fakti që kërkuesja pretendon se mund të bëhet viktimë e mundshme në të ardhmen për shkak të rrezikut të heqjes të së drejtës së avokatisë, në përputhje me ligjin për avokatinë (shih paragrafin 208 më lart), është thjesht një dyshim ose hamendësim nga ana e saj. Deri më sot ajo nuk është prekur nga një vendim i pafavorshëm individual i marrë kundër saj. Sipas këndvështrimit të Gjykatës, ajo është e lirë që të kundërshtojë përpara një gjykate çdo vendim të pafavorshëm që Dhoma e Avokatisë mund të marrë kundër saj në të ardhmen, dhe kështu t'i sigurojë shtetit të paditur mundësinë për të korrigjuar çdo shkelje të pretenduar të të drejtave të saj, sipas Konventës, siç kërkohet nga neni 35/1 i Konventës. Për më shumë, kërkuesja nuk tregoi që fusha e zbatimit e ligjit për avokatinë ishte drejtuar posaçërisht kundër gjyqtarëve ose prokurorëve ndaj të cilëve ishte dhënë një vendim gjatë procesit të rivlerësimit (për krahasim dhe në kontrast *Tănase*, cituar më lart, *dhe Sejdić dhe Finci kundër Bosnjës dhe Hercegovinës* [DHM], nr. 27996/06 dhe 34836/06, GJEDNJ 2009). Për ta përmbledhur, kërkueses nuk do t'i kërkohej që të modifikojë ndonjë sjellje sipas ligjit për avokatinë; ajo do t'u nënshtrohej kërkesave ligjore të këtij ligji.".

90. Kërkuesja nuk ka paraqitur pranë Gjykatës një kopje të korrespondencës së saj me Dhomën Kombëtare të Avokatisë, por vetëm kishte deklaruar se ajo kishte për qëllim të "regjistrohej" si avokate. Rezulton se, të paktën në muajin nëntor 2018, ajo nuk kishte licencën për të ushtruar ligjin si "avokate", sipas interpretimit të Ligjit për Avokatinë (shih paragrafët 46-48 më sipër).

91. Përveç disa referencave në legjislacion, shkresa e datës 9 nëntor 2018, e nënshkruar nga kryetari i Dhomës, përmbante gjetje në lidhje me kërkuesen dhe situatën e saj specifike si rezultat i procedurave të *vetting*-ut. Megjithatë, mbetet e paqartë nëse ajo shkresë ishte një përgjigje formale, brenda asaj zone kompetence sipas Statutit të Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë, apo ndonjë legjislacioni të zbatueshëm, për një kërkesë specifike e tillë si kërkesa për t'u regjistruar. Nëse vendimi për kundërshtimin e kërkesës së kërkueses konsiderohet formal, është e pranueshme që ajo shkresë do të merrej për shqyrtim, sipas ligjit shqiptar, për shembull, sipas Ligjit për Avokatinë dhe/ose Ligjin për Gjykatat Administrative, siç sugjerohet nga Qeveria. Gjithashtu, nuk ka asnjë të dhënë se dispozitat përkatëse të Ligjit për Avokatinë, që në këtë çështje u cituan si baza ligjore për atë që përbënte një ndërhyrje në të drejtat e saj sipas nenit 8 të Konventës, u testuan me anë të shqyrtimit kushtetues (krahaso, *mutatis mutandis, Fullani kundër Shqipërisë* (vendim), nr. 4586/18, §§ 78-80, 20 Shtator 2022). Në çështjen konkrete, Gjykata nuk ka nevojë të bëjë konstatime të tjera për shterimin e problematikës sepse, në çdo rast, nuk është provuar se ai dokument përbënte një vendim personalisht dhe duke ndikuar negativisht qëllimin e kërkueses *vis-a-vis* për të ushtruar ligjin jashtë sistemit të drejtësisë, për shembull, në sektorin privat. Kërkuesja nuk ka marrë hapa për të kundërshtuar ndalimin e saj të supozuar nga e drejta për t'iu bashkuar Shoqatës së Avokatëve.

92. Sipas rrethanave të çështjes konkrete, Gjykata është e mendimit se kjo ankesë është e papajtueshme *ratione personae* me parashikimet e Konventës dhe duhet të rrëzohet në përputhje me Nenin 35 §§ 3 (a) dhe 4.

C. Meritat

93. Ka pasur ndërhyrje në të drejtën e kërkueses për respektimin e jetës së saj private, për shkak të shkarkimit të saj nga detyra (shih *Xhoxhaj*, cituar më sipër, §§ 363-64 dhe 377). Një ndërhyrje në të drejtën e personit për respektimin e jetës private do të jetë shkelje e nenit 8 § 2, për të qenë "në përputhje me ligjin", sipas një ose më shumë qëllimeve legjitime të listuara në të, dhe duke qenë "i nevojshëm në një shoqëri demokratike" për të arritur qëllimin ose qëllimet përkatëse.

1. Nëse ndërhyrja ishte "në përputhje me ligjin"

a) Parashtrimet e palëve

i. Kërkuesja

94. Kërkuesja parashtroi se vendimi për ta shkarkuar nga detyra nuk kishte qenë në përputhje me ligjin shqiptar, për arsyet e përmbledhura në paragrafët 60-63 më sipër. Ligji i *Vetting*-ut ishte shprehur në terma të gjerë dhe të paqartë, pa përmbushur kërkesën e parashikueshmërisë, veçanërisht sepse ligji vendës nuk përcaktonte rrethanat të cilat do të përbënin arsyet për shkarkimin nga detyra. Në lidhje me vlerësimin e pasurive, ishte e paqartë se çfarë lloji mospërputhje apo mangësie arrinte nivelin e kërkuar për të qenë e rëndë për të justifikuar shkarkimin. Organet e

vetting-ut gëzonin diskrecion të papenguar në interpretimin e parashikimeve dhe vlerësimin e rrethanave të çështjes, dhe se fundmi, në marrjen e vendimit nëse një individ duhej të shkarkohej. Mungesa e udhëzimeve e bënte diskrecionin e organeve të *vetting*-ut të hapur dhe dëmtonte parimin e sigurisë ligjore. Pothuajse çdo shkelje nga një prokuror ose mospërputhje me deklarimin fillestar (pavarësisht sesa i vogël dhe i parëndësishëm) mund të merrej nga organet e *vetting*-ut si bazë e mjaftueshme ligjore për një "akuzë" serioze në kontekstin e procesit të *vetting*-ut dhe mund të rezultonte në shkarkimin nga detyra.

ii. Qeveria

95. Qeveria parashtronte se dispozitat në Ligjin e *Vetting*-ut ishin të qarta, të mirëpërcaktuara dhe të detajuara. Ligji nuk përmbante ndonjë kontradiktë dhe parashikonte sigurinë, qartësinë dhe vijimësinë. Koncepti i ligjshmërisë së pasurisë ishte i dukshëm në ligjin vendës, si në statute në lidhje me deklarimin e pasurive ose në parandalimin e pastrimit të parave. Në mënyrë që një pasuri të konsiderohej e ligjshme, duhej të përmbusheshin dy kushte: të ardhurat e përdorura për krijimin ose përftimin e pasurisë duhej të vinin nga një aktivitet i ligjshëm, dhe të ardhurat duhej t'i ishin nënshtruar pagesës së tatimeve dhe detyrimeve të zbatueshme. Përmbushja kumulative e këtyre dy kushteve parashikohej qartazi në nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 3 të Ligjit të *Vetting*-ut.

96. Baza për konstatimin e deklarimit të pamjaftueshëm të pasurive ishte deklarimi i *vetting*-ut të pasurive. Sipas nenit 61(3) të Ligjit të *Vetting*-ut, se bashku me nenin 33, deklarimi i pasurive do të ishte i pamjaftueshëm, nëse ishte konstatuar se kishte mungesë të burimeve financiare, fshehje të pasurive, deklarim të rremë të pasurive ose një konflikt interesi. Deklarimet e mëparshme të pasurive mund të përdoreshin si prova nga organet e *vetting*-ut.

97. Shpenzimet për jetesën përllogariteshin duke iu referuar deklarimit të një individi, të dhënave të marra nga organet e *vetting*-ut nga institucionet kombëtare dhe të huaja, deklarimet e mëparshme dhe provat e mbledhura nga institucionet bankare dhe jo bankare. Prova të tilla do t'u nënshtroheshin procedurave akuzuese, si rezultat i të cilave personi i vetuar/rivlerësuar do të ftohej të paraqiste provat e tij ose të saj në mbështetje të pozicionit të tij ose saj. Të gjitha provat do t'u nënshtroheshin kontrolleve numerike dhe logjike dhe KPK-ja do të merrte një vendim të individualizuar për secilën çështje, në lidhje me faktet specifike.

b) Vlerësimi i Gjykatës

98. Shprehja "në përputhje me ligjin" kërkon që masa e kundërshtuar duhet të mbështetet në ligjin vendës, dhe se ligji konkret duhet të jetë i aksesueshëm për personin e përfshirë dhe i parashikueshëm për pasojat e tij (shih midis autoriteteve të tjerë, *Fernandez Martinez kundër Spanjës* [DHM], nr. 56030/07, § 117, GJEDNJ 2014 (ekstrakte)). Në mënyrë që ligji të përmbushë kërkesat e parashikueshmërisë, ai duhet të parashikojë me saktësi të mjaftueshme kushtet në të cilat mund të zbatohet një masë, për t'i bërë të mundur personave konkretë – nëse do të ishte e nevojshme, me këshillimin e duhur – të rregullonin sjelljen e tyre (shih midis autoriteteve të tjera, *Altay kundër Turqisë (nr. 2),* nr. 11236/09, § 54, 9 prill 2019).

99. Vendimi për të shkarkuar kërkuesen nga detyra ë vitin 2018 kishte bazë ligjore në nenin 61(1) dhe (3) të Ligjit të *Vetting*-ut të hyrë në fuqi në vitin 2016; dhe për sa ka të bëjë me çështjen organet e *vetting*-ut arritën në përfundimin për deklarimin e saj të *vetting*-ut të vitit 2017 për pasuritë, se ajo: i. kishte deklaruar një total pasurish më të madh sesa dyfishi i vlerës së pasurisë të përftuar në mënyrë të ligjshme; dhe ii. nuk kishte bërë deklarim të mjaftueshëm për pasuritë sipas nenit 33 të Ligjit. Dispozita e fundit listonte parametrat për vlerësimin e deklarimit, ku kërkohej që ajo të ishte e saktë, në përputhje me ligjin, e mbështetur me burime të ligjshme financiare, dhe të kishte burime financiare të mjaftueshme dhe të ligjshme për të justifikuar pasuritë, pa fshehje të pasurive dhe pa deklarime të rreme.

100. Që nga hyrja në fuqi të Ligjit për Deklarimin e Pasurive në vitin 2003 dhe deri në momentin kur kërkuesja paraqiti deklarimin e saj të *vetting*-ut në vitin 2017 sipas Ligjit për *Vetting*-un, asaj i ishte kërkuar që të paraqiste deklarime vjetore për interesat privatë, burimet e përdorura për krijimin e tyre, si edhe në lidhje me detyrimet financiare për, *inter alia,* pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat ndaj tyre, pasuritë e luajtshme, detyrimet financiare ndaj personave të tjerë, të ardhurat personale dhe shpenzimet e deklarueshme (shih paragrafin 24 më sipër). Në procesin e *vetting*-ut, vlerësimi i pasurive përfshinte edhe deklarimin dhe

kontrollin e pasurive, ligjshmërinë e burimit të përdorur për përftimin ose krijimin e tyre, përmbushjen e detyrimeve financiare, duke përfshirë interesat privatë të personit të rivlerësuar dhe personave të lidhur me të (shih paragrafin 29 më sipër). Organet e *vetting*-ut mund të përdornin dhe përdorën si prova deklarimet vjetore të pasurive të përmendura më sipër (shih paragrafin 30 më sipër).

101. Në fillim të procesit të *vetting*-ut, kërkueses iu kërkua të paraqiste dokumente mbështetëse me anë të të cilave të justifikonte vërtetësinë e deklarimeve të saj në deklarimin e *vetting*-ut, në lidhje me ligjshmërinë e burimeve të përdorura për krijimin e pasurive (shih paragrafin 30 më sipër). Sipas nenit D § 3 të Aneksit të Kushtetutës, ajo duhej të ofronte shpjegime bindëse në lidhje me ligjshmërinë e burimit të pasurive dhe të ardhurave; pasuritë do të konsideroheshin të ligjshme nëse të ardhurat ishin deklaruar dhe për to ishte paguar tatimi (shih paragrafin 27 më sipër).

102. Sipas Ligjit të *Vetting*-ut, vlerësimi i pasurive dhe një vendim i lidhur me të për shkarkim nga detyra – veçanërisht kur zbatohej neni D § 4 i Aneksit të Kushtetutës, si në çështjen konkrete – i nënshtrohen kërkesës për proporcionalitet (shih paragrafët 28 dhe 34 më sipër), mund të hamendësohet se vetëm problematikat relativisht të rënda mund të merren në konsideratë për të justifikuar sanksionin përfundimtar për shkarkim nga detyra. Gjithashtu, mosdeklarimi i saktë i pasurive kishte qenë vepër penale përpara vitit 2016 (shih paragrafin 25 më sipër).

103. Gjykata arrin në përfundimin se kërkuesja nuk e kishte provuar pretendimin e saj se kishte mungesë të parashikueshmërisë në lidhje me arsyet për shkarkimin e saj nga detyra.

104. Së fundmi, theksohet se ankesa e kërkueses në mbështetje të nenit 6 § 1 të Konventës është i pambështetur në fakte (shih paragrafët 60–63 dhe 78–79 më sipër). Në çështjen konkrete, Gjykata nuk gjykon se ndërhyrja sipas nenit 8 të Konventës nuk ishte në "në përputhje me ligjin" mbështetur në rrethanat përmendur në atë ankesë.

105. Gjykata arrin në përfundimin se ndërhyrja në të drejtën e kërkueses për respektimin e jetës private ishte në përputhje me ligjin, sipas parashikimit në nenin 8 §§ 2 të Konventës (shih, në të njëjtën linjë, *Xhoxhaj*, cituar më sipër, §§ 385-86).

2. Nëse ndërhyrja ndiqte një qëllim legjitim

106. Kërkuesja shprehu kundërshtim pasi ndërhyrja nuk kishte ndjekur ndonjë qëllim legjitim. Qëllimi legjitim i paraqitur nga parashtrimet e Qeverisë, më konkretisht pastrimi i gjyqësorit nga korrupsioni, mund të ishte arritur me anë të mjeteve më pak ndërhyrëse, të tilla si trajnim i detyruar. Komisioni Evropian nuk kishte bërë thirrje për një *vetting* të gjerë në radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë për të zhdukur korrupsionin.

107. Qeveria parashtroi, duke iu referuar raportit për vlerësimin e sistemit gjyqësor në Shqipëri (shih *Xhoxhaj*, cituar më sipër, §§ 4 dhe 390) se ishin identifikuar një sërë problemesh. Këto probleme kishin ngritur nevojën për të bërë ndryshime strukturore, të cilat kishin kulmuar me ndryshimet kushtetuese dhe miratimin e një grupi statutesh të rëndësishëm. Qeveria iu referua qëllimeve legjitime të cilat i kishte identifikuar Gjykata Kushtetuese në shqyrtimin kushtetues të Ligjit të *Vetting*-ut.

108. Duke iu referuar gjetjeve në *Xhoxhaj* (cituar më sipër, § 393) dhe statusit të prokurorëve në sistemin e drejtësisë në Shqipëri (shih paragrafët 36–38 më sipër), Gjykata nuk gjen arsye të dyshojë se qëllimi i ndjekur nga Ligji i *Vetting*-ut në përgjithësi, dhe ndërhyrja në çështjen konkrete (*vetting*-u i një prokuroreje) ishte në të njëjtën linjë me qëllimet e identifikuara në vendimin e Gjykatës Kushtetuese dhe në interesat e sigurisë kombëtare, sigurisë publike dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të të tjerëve, siç parashikon neni 8 § 2 i Konventës.

3. Nëse ndërhyrja ishte "e nevojshme në një shoqëri demokratike"

a) Parashtrimet e palëve

i. Kërkuesja

109. Organet e *vetting*-ut kishin shkelur kufijtë e përcaktuar nga Ligji i *Vetting*-ut dhe e kishin shkarkuar atë nga detyra duke iu referuar deklarimeve të saj vjetore për pasuritë, të cilat i kishte depozituar pranë Inspektoratit të Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, dhe për të cilat ishte dhënë një vlerësim pozitiv. Nuk kishte asnjë mbrojtje procedurale për të parandaluar zbatimin arbitrar të ligjit. Legjislacioni nuk parashikonte shkallën e duhur të sanksioneve për shkeljet disiplinore, dhe nuk ishte përpunuar asnjë rregull për të garantuar

zbatimin e tyre në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

110. Si rezultat i procedurave të *vetting*-ut, ajo ishte stigmatizuar si një person i pavlerë për të kryer funksionet e saj, duke u mbështetur në mospërputhsmëritë e pretenduara në pasuritë e saj dhe në mundësinë e supozuar se rrezikohej besimi i publikut nën gjyqësor. Ajo kishte qenë në kulmin e karrierës së saj si rezultat i shumë viteve dedikimi personal dhe angazhimi profesional si prokurore. Reputacioni, nderi dhe karriera e saj kishin pësuar një goditje të pakorrigjueshme, edhe për shkak të fushatës masive mediatike kundër saj. Ajo jo vetëm që ishte shkarkuar nga detyra si prokurore, por edhe ishte ndaluar nga ushtrimi i funksioneve publike, teksa mundësitë për të gjetur një punë në fushën ligjore në përputhje me kualifikimet dhe eksperiencën e saj ishin reduktuar në atë masë që e bënte ushtrimin e profesionit të saj pothuajse të pamundur.

111. Shkarkim i saj nga detyra ishte shpërpjesëtimor me qëllimin e ndjekur dhe me shkeljen mbi të cilin ishte mbështetur. Legjislacioni nuk përmbante rregulla që garantonin se sanksioni i shkarkimit nga detyra zbatohej në përputhje me parimin e proporcionalitetit. Veçanërisht, legjislacioni nuk parashikonte normën e duhur të sanksioneve për veprat disiplinore, dhe nuk ishin nxjerrë rregulla për garantimin e zbatimit të tyre në përputhje me atë parim. Sipas nenit 58 të Ligjit të *Vetting*-ut, rezultatet e vetme të mundshme të procesit të *vetting*-ut ishin konfirmimi në detyrë, pezullimi nga detyra për një vit dhe shkarkimi nga detyra. Dy llojet e sanksioneve linin pak vend për të disiplinuar një prokuror në mënyrë proporcionale. Autoriteteve të *vetting*-ut iu ishin dhënë mundësi të kufizuara për të balancuar interesat konkurrues të publikë dhe individualë në secilin rast.

112. Arsyet e paraqitura nga KPK-ja nuk ishin të duhurat ose të mjaftueshme për të justifikuar një masë të tillë drakoniane si shkarkimi nga detyra. Mospërputhshmëritë e pretenduara te pasuritë e saj nuk kishin qenë të një natyre aq themelore që të mund ose që duhej të kishin nxitur shkarkimin e saj nga detyra. KPK-ja e kishte shkarkuar nga detyra kryesisht për arsyet e mëposhtme: nuk kishte listuar në deklarimin e saj të *vetting*-ut dy garazhe (edhe pse pronësia ishte provuar nga marrëveshja e blerjes bashkëngjitur me deklarimin, dhe fakti se ajo i kishte përmendur garazhet në deklarimet periodike vjetore); nuk kishte provuar se në vitin 2008 vjehrra e saj i kishte dhënë familjes së saj 752,800 lekë (6,000 euro) për blerjen e apartamentit në Tiranë (edhe pse vjehrra e saj kishte bërë një deklaratë nën betim ku e konfirmonte këtë gjë dhe pavarësisht se kërkuesja e kishte deklaruar atë dhuratë në deklarimet periodike vjetore që në vitin 2008); nuk kishte provuar pronësinë e apartamentit të shkatërruar në Lezhë që ishte blerë në vitin 1998 (edhe pse ajo kishte dorëzuar një kopje të marrëveshjes noteriale nënshkruar në vitin 2011 midis një kompanie ndërtimi dhe bashkëshortit të saj, ku përcaktoheshin kushtet e kompensimit për apartamentin e shembur); dhe nuk kishte provuar se një mik i bashkëshortit të saj kishte pasur mjaftueshëm të ardhura për t'i dhënë atyre një hua të vogël për blerjen e një automjeti të përdorur. Arsyet e dhëna nga organet e *vetting*-ut ishin dukshëm të pamjaftueshme për të justifikuar një masë të tillë drakoniane siç ishte shkarkimi i menjëhershëm nga detyra. Kjo nuk kishte qenë një pasojë e parashikueshme për sjelljen e saj.

ii. Qeveria

113. Qeveria parashtroi se kërkuesja i ishte nënshtruar procesit të *vetting*-ut, i cili është ndryshe nga procedurat e zakonshme disiplinore. Shkarkimi i saj nga detyra kishte qenë proporcional, dhe mbështetur, *inter alia,* në faktin se ajo kishte deklaruar më shumë sesa dyfishi i asaj që ajo mund të provonte si pasuri e ligjshme sipas nenit D § 4 të Aneksit të Kushtetutës. Qëllimi kryesor i procesit të *vetting*-ut, sipas nenit D, ishte verifikimi i burimit të ligjshëm të pasurive dhe burimi i ligjshëm i të ardhurave. Detyrimi kryesor i kërkueses ishte të provonte burimin e ligjshëm të pasurive, gjë të cilën ajo nuk e kishte bërë në mënyrë të arsyeshme. Ajo nuk kishte kundërshtuar gjetjet paraprake të organeve të *vetting*-ut. Masa disiplinore e dhënë ndaj saj kishte qenë proporcionale me shkeljen e kryer prej saj.

b) Vlerësimi i Gjykatës

114. Një ndërhyrje në të drejtën për të respektuar jetën private do të konsiderohej "e nevojshme në një shoqëri demokratike" për një qëllim legjitim, nëse i përgjigjej "nevojës së ngutshme të shoqërisë" dhe, veçanërisht, nëse është proporcionale me qëllimin legjitim të ndjekur dhe nëse arsyet e paraqitura nga autoritetet vendëse për ta justifikuar atë janë "të duhurat dhe të mjaftueshme" (shih *Xhoxhaj* cituar më sipër, § 402).

E ndërsa u takonte autoriteteve vendëse që të bënin vlerësimin fillestar të nevojës, vlerësimi përfundimtar nëse arsyet e paraqitura për ndërhyrje janë të duhurat dhe të mjaftueshme mbetet objekt shqyrtimi nga Gjykata për përputhshmëri me kërkesat e Konventës (ibid.). Shkarkimi nga detyra është një sanksion i rëndë – ndoshta më i rëndi – disiplinor që mund të jepej ndaj një individi. Dhënia e një mase të tillë, e cila ndikon negativisht në jetën private të një individi, kërkon shqyrtimin e provave të forta në lidhje me etikën, integritetin dhe kompetencën profesionale të individit (ibid., § 403).

115. Siç përcaktohet në *Xhoxhaj* (cituar më sipër, §§ 391-92 dhe 404), Ligji i *Vetting*-ut u përgjigjej nivele alarmante të korrupsionit në gjyqësor, siç vlerësohet nga qeverisja vendëse dhe vëzhgues të tjerë të pavarur, dhe nevojës urgjente për të luftuar korrupsionin, i cili ishte nënvizuar edhe në vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Për këtë arsye, Gjykata gjykonte, se në rrethana të tilla, një reformë në sistemin e drejtësisë që sillte një *vetting* të jashtëzakonshëm për të gjithë gjyqtarët në detyrë, së bashku me prokurorët në detyrë, i përgjigjej një "nevoje urgjente të shoqërisë" (ibid., § 404).

116. Mbetet për t'u përcaktuar nëse autoritetet vendëse nuk morën parasysh margjinën e vlerësimit të shtetit përgjegjës kur vendosën të shkarkonin kërkuesen nga pozicioni i prokurores. Gjykata do të shqyrtojë nëse organet e *vetting*-ut kryen një vlerësim të individualizuar të arsyeve që çuan në shkarkimin nga detyra, më konkretisht për vlerësimin e pasurive. Fillimisht u takon autoriteteve vendëse, dhe qartazi gjykatave, që të interpretojnë ligjin vendës. Nëse interpretimi nuk është arbitrar apo qartazi i paarsyeshëm, roli i Gjykatës është i kufizuar në verifikimin e përputhshmërisë me Konventën për efektet e një interpretimi të tillë (shih *Radomilja dhe të Tjerët,* [GHM], cituar më sipër, §149 në kontekstin e nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës, dhe *Xhoxhaj*, cituar më sipër, § 407 në kontekstin e nenit 8).

117. Gjykata thekson se mosrespektimi i detyrimeve nga ana e zyrtarëve publikë në lidhje me deklarimin e pasurisë mund të konsiderohet në përgjithësi serioze. Ato mund të përfshijnë, midis të tjerash, mosdeklarimin e pasurive madhore ose burimet e të ardhurave apo përpjekjet e qëllimshme për t'i fshehur ato nga autoritetet; pamundësia për të justifikuar blerjet madhore me anë të kursimeve të ligjshme dhe të mjaftueshme, ose burimeve në kohën e përftimit; ose një pamundësi për të justifikuar stilin e tepruar të jetesës, ose shpenzimet ekstravagante që është qartazi përtej mjeteve të deklaruara të ligjshme të zyrtarëve përkatës dhe familjes së tij. Gjithashtu, në lidhje me këtë aspekt, Gjykata pranon se mund të jetë e ligjshme që të mbahen në konsideratë të ardhurat dhe deklarimet e bashkëshortit/es të zyrtarit/es, partnerit/es apo pjesëtarëve të tjerë të familjes së ngushtë në vlerësimin e respektimit nga ana e zyrtarit të ligjeve kundër korrupsionit (shih *Samoylova kundër Rusisë*, nr. 49108/11, §§ 85-86, 14 dhjetor 2021). Në të njëjtën kohë, jo çdo rast i vogël i mosrespektimit të regjimeve të deklarimit të pasurive, ose një mospërputhje e parëndësishme midis shpenzimeve dhe burimeve të ligjshme, duhet të nxisë sanksionet më të rënda disiplinore, të tilla shkarkimi nga detyra.

118. Duke u kthyer te çështja konkrete, Gjykata vëren se, pasi nisi hetimi për të tria kriteret dhe pasi u plotësua pjesa e kriterit të pasurisë, KPK-ja mbajti në konsideratë vlerën provuese të provave të mbledhura dhe vendosi të kufizojë vlerësimin në atë kriter. KPK-ja e kaloi barrën e provës te kërkuesja, e cila u njoftua se barra e provës kishte të bënte vetëm me vlerësimin e pasurive.

119. Në përputhje me Ligjin e *Vetting*-ut, kërkueses iu kërkua të provonte burimet e ligjshme të përdorura për përftimin e pasurive, dhe në thelb, faktin se ajo dhe familja e saj jetonin brenda mjeteve të tyre të ligjshme. Në linjë me angazhimet e Shqipërisë mbështetur në legjislacionin ndërkombëtar, kërkesa për të deklaruar pasuritë dhe për të provuar burimin e tyre të ligjshëm është parashikuar në ligjin vendës që prej vitit 2003, ku përshkruhen sanksionet për rastin kur nuk deklarohen pasuritë ose bëhen deklarime të rreme (shih *Xhoxhaj*, cituar më sipër, §§ 201-04). Kjo është arsyeja se përse Ligji i *Vetting*-ut parashikonte përdorimin e deklarimeve të mëparshme të pasurive si provë për të verifikuar vërtetësinë e deklarimit të *vetting*-ut për pasuritë si provë për të verifikuar vërtetësinë e deklarimit të *vetting*-ut për pasuritë; në çështjen konkrete kryesisht nga viti 2007 deri në 2011 në lidhje me pasuritë e përftuara dhe/ose të ardhurat e marra nga kërkuesja dhe bashkëshorti i saj nga viti 2008 deri në 2016.

120. Gjykata thekson gjetjen e KPK-së se pasuritë e deklaruara të kërkueses ishin më shumë

sesa dyfishi i shumës së pasurisë së ligjshme, gjë e cila do të kishte sjellë shkarkimin e saj nga detyra sipas Nenit D § 4 të Aneksit të Kushtetutës. Kjo gjetje ishte rezultat i vlerësimit i të gjitha shpjegimeve dhe provave të paraqitura prej saj, dhe i të gjithë të dhënave të mbledhura gjatë hetimit dhe të vëna në dijeni të kërkueses. Sipas KPA-së, ai përfundim ishte pasoja logjike e arsyetimit në lidhje me secilën pasuri dhe i krahasimit midis shumës së pasurisë së mbledhur në vite dhe të deklaruar në deklarimin e *vetting*-ut në vitin 2017, dhe i vlerësimit të ligjshmërisë së burimeve të të ardhurave. Personi i rivlerësuar duhej të shpjegonte në mënyrë bindëse burimin e ligjshëm të pasurive dhe të ardhurat dhe nuk mund të fshihte, apo të paraqiste në mënyrë të pasaktë pasuritë që zotëronte ose përdorte. Sipas nenit 4 të Ligjit të *Vetting*-ut, vendimi mund të bëhej mbështetur në një ose më shumë kritere ose me anë të një vlerësimi tërësor të të tria kritereve. Parashikimet kushtetuese dhe parashikimet e tjera përkatëse parashikonin masat disiplinore edhe mbështetur në vetëm një kriter.

121. Në lidhje me pasurinë më të shtrenjtë (apartamenti me dy garazhe në Tiranë, i përftuar për 12,345,300 lekë), organet e *vetting*-ut gjykonin se kërkuesja nuk kishte provuar ligjshmërinë e pjesës thelbësore të burimeve të përdorura për përvetësimin e tij. Pas një rishqyrtimi të kujdesshëm të provave në dosjen e çështjes, KPA arriti në përfundimin se 4,749,349 lekë nuk mund të provoheshin se vinin në mënyrë të ligjshme nga kursimet familjare për periudhën 2007-11. KPA-ja kishte juridiksion mbi çështjet e faktit dhe ligjin, dhe kjo gjetje lidhej me aspektin tashmë të shqyrtuar nga KPK-ja, dhe vinte si rezultat i shkakut të apelimit të kërkueses në lidhje me qëndrimin e KPK-së për "dyshimin e tyre të arsyeshëm", në lidhje me situatën reale të kursimeve. Vlerësimi për kursimet mbështetej në informacionet e marra nga deklarimet vjetore të kërkueses. Në lidhje me vlerësimin e shpenzimeve për jetesën, KPA-ja specifikoi se u mbështet në të dhënat zyrtare të publikuara nga agjencia e statistikave për periudhën përkatëse. KPA-ja gjykonte, *inter alia*, se nuk ishte paraqitur asnjë provë e rëndësishme që të përkonte me periudhën kur pretendohej të ishin marrë paratë dhe përdorur për të përftuar prona të caktuara. Gjykata shprehet se vendimet vendëse nuk ishin arbitrare apo të pambështetura në fakte në lidhje me këtë aspekt.

122. Për më tepër, KPA-ja nuk ishte e bindur se kërkuesja kishte provuar burimin e ligjshëm të fondeve të përdorura për të përftuar një tjetër apartament dhe një njësi shërbimesh në Lezhë dhe për blerjen e makinës. Në një sërë rastesh, kërkuesja kërkonte të provonte ligjshmërinë e të ardhurave apo të transaksioneve me anë të provave dokumentare të marra vite më vonë, gjë që ngrinte pikëpyetje legjitime për integritetin e sjelljes së saj dhe gjykimin e saj të shëndoshë si prokurore.

123. Gjykata mund të pranojë se disa nga gjetjet e KPA-së rezultojnë të kenë qenë disi të ashpra ose formaliste, mbështetur në marrëdhëniet kryesor ndërpersonale dhe shkallën e informalitetit të transaksioneve që kishte ekzistuar në Shqipëri më herët gjatë tranzicionin demokratik. Ky është i njëjti rast, për shembull, me gjetjet e KPA-së, në lidhje me formalitetin e dhuratave të bëra nga vjehrra e kërkueses; deklarimi i dy garazheve që i përkisnin apartamentit në Tiranë, ose me shitjen e makinës së vjetër për 4,000 euro. Në të njëjtën kohë, është e qartë se ato pasuri apo transaksione përfshinin shuma disi të vogla, si në terma absolut edhe relativë. Në këtë mënyrë, Gjykata nuk mund të hedhë dyshime ndaj konstatimeve fillestare të KPA-së, në lidhje me parregullsitë e rënda ose mungesën e provave për disa nga pasuritë më të mëdha të kërkueses dhe të familjes së saj, të tilla si shumat e pajustifikuara të kursimeve personale për periudhën 2007-11, mosdhënien e provave për pronësinë apo ndonjë dokument tjetër të vlefshëm për apartamentin e shembur në Lezhë, dhe huan jo substanciale prej 12,000 eurosh nga një mik.

124. Gjykata thekson se një situatë me informalitet të përgjithshëm në vend, edhe pse e kuptueshme në disa aspekte, nuk mund të përjashtojë faktin që një prokurore publike me eksperiencë – apo zyrtarë të tjerë në drejtësi – të përmbushë çështjet e saj me respektin më të madh për ligjshmërinë dhe në një mënyrë që është përtej kritikës publike; ata duhet të ruhen sipas standardit më të lartë etik. Gjithashtu, i ashtuquajturi "rregulli 200%" i siguronte kërkueses një liri veprimi të rëndësishme, në lidhje me vështirësitë objektive në provimin e ligjshmërisë së pasurive, disa prej të cilave ishin përftuar dikur në të shkuarën. Pavarësisht kësaj, ashtu siç përcaktohej nga autoritetet vendëse, kërkuesja nuk provonte në mënyrë bindëse ligjshmërinë as të 50% të pasurive të deklaruara.

125. Gjykata vëren se përfundimet e KPA-së si shkalla e fundit në procedurat e *vetting*-ut në lidhje me vlerësimin e pasurive, siç përshkruhet më sipër dhe marrë në mënyrë kulumative, ishin mjaftueshëm të rënda për të ngritur dyshime të rëndësishme për pasurinë financiare të kërkueses dhe për të justifikuar shkarkimin e saj nga detyra.

126. Gjykata vendos, duke marrë në konsideratë konstatimet e individualizuara të organeve të *vetting*-ut (shih paragrafët 15 dhe 20–22 më sipër), se shkarkimi i kërkueses nga detyra e saj si prokurore ishte proporcionale mbështetur në nenin 8 § 2 të Konventës. Ligji i *Vetting*-ut parashikonte dy lloje sanksionesh disiplinore: shkarkimin nga detyra ose pezullimin me detyrimin për të ndjekur trajnime të detyrueshme. Mungesa e një shkalle të duhur sanksionesh për shkeljet disiplinore mund të mospërputhet me parimin e proporcionalitetit (shih *Oleksandr Volkov kundër Ukrainës,* nr. 21722/11, § 182, GJEDNJ 2003). Legjislacioni i zbatueshëm parashikonte një hierarki më të detajuar sanksionesh disiplinore, që vendoseshin në përfundim të procedurave disiplinore të zakonshme (shih paragrafët 40 dhe 43 më sipër). Megjithatë, procedurat e *vetting*-ut kanë natyrë *sui generis*, pavarësisht ngjashmërive që ato duket se kanë me procedurat e zakonshme disiplinore. Ato ishin marrë si përgjigje ndaj pranisë së përhapur të korrupsionit në sistemin e drejtësisë për të zhdukur elementet korruptive dhe për të ruajtur pjesën e shëndetshme të sistemit. Gjykata u referohet konstatimeve të saj në *Xhoxhaj* (cituar më sipër, § 412) se, duke marrë në konsideratë rrethanat e jashtëzakonshme, të cilat paraprinin hyrjen në fuqi të Ligjit të *Vetting*-ut, një shkallë më e kufizuar sanksionesh është me frymën e procesit të *vetting*-ut në rastin kur një person nuk përmbush një ose të tria kriteret e parashikuara në Ligjin e *Vetting*-ut.

4. Përfundim

127. Gjykata arrin në përfundimin se procedurat e *vetting*-ut dhe shkarkimi i kërkueses nga detyra përputheshin me kërkesat e nenit 8 të Konventës.

128. Pas disa pasojave të caktuara në lidhje me konstatimet e bëra nga organet e *vetting*-ut dhe shkarkimit të kërkueses nga detyra, Gjykata më herët ka gjykuar se neni 8 i Konventës nuk mund të referohet për t'u ankuar për humbjen e reputacionit gjë që është pasojë e parashikueshme e veprimeve të një dikujt, si për shembull kryerja e një vepre penale ose ndonjë shkelje tjetër që sillte një masë me përgjegjësi ligjore me efekte negative që ishin të parashikueshme për "jetën private" (shih *Denisov kundër Ukrainës* [DHM], nr. 76639/11, § 98, 25 shtator 2018; shih edhe mbi disa kufizime të caktuara të atij parimi, *M.L. kundër Sllovakisë*, nr. 34159/17, §§ 38-39, 14 tetor 2021). Në çështjen konkrete, konstatimet e organeve të *vetting*-ut dhe shkarkimi i kërkueses nga detyra ishin rezultat i procedurave që përputheshin me kërkesat e nenit 6 dhe 8 të Konventës.

129. Në po të njëjtën mënyrë, Gjykata nuk anashkalonte faktin se sipas Ligjit për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, shkarkimi i kërkueses nga detyra sillte ndalimin e përhershëm për të rihyrë në sistemin e drejtësisë. Duke qenë se ajo nuk dorëzoi një ankesë të veçantë pranë Gjykatës në lidhje me pasojën – që mësa duket ishte e drejtpërdrejtë dhe e pashmangshme – e shkarkimit të saj nga detyra në proceset e *vetting*-ut (shih paragrafët 83–84 më sipër), Gjykata përsërit se ajo ka marrë në konsideratë (shih *Xhoxhaj* cituar më sipër, § 413) faktin se gjyqtarët, veçanërisht ata që mbajnë poste që sjellin nivel të lartë përgjegjësie, të tilla si postet në të cilat kërkuesi në atë çështje dëshironte që të rikthehej për të punuar, kishin një pjesë të pushtetit sovran të shtetit. Edhe në *Xhoxhaj*, Gjykata deklaroi se ndalimi i përhershëm ndaj kërkuesit, një gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese, dhe ndaj individëve të tjerë të shkarkuar nga detyra për shkelje të rënda etike, nuk ishte i papërputhshëm apo joproporcional me objektivin legjitim të ndjekur nga shteti – sipas kontekstit vendës për konsolidimin e shtetit të së drejtës në atë periudhë – për të garantuar integritetin e gjyqësorit dhe besimin e publikut në sistemin e drejtësisë (ibid.). Duke pasur parasysh statusin e prokurorëve në sistemin e drejtësisë në Shqipëri (shih paragrafët 36–38 më sipër), Gjykata vendos se aspekte të ngjashme detyruese zbatoheshin në lidhje me shkarkimin nga detyra e prokurorëve dhe ndalimin për të rihyrë në sistemin e drejtësisë (shih edhe paragrafët 51–57 më sipër).

130. Nuk është shkelur neni 8 i Konventës për sa ka të bëjë me shkarkimin e kërkueses nga detyra.

III. PRETENDIMI PËR SHKELJE TË NENIT 13 TË KONVENTËS

131. Kërkuesja u ankua se nuk kishte pasur një zgjidhje efektive, sipas nenit 13 të Konventës, në lidhje me ankesën e saj sipas nenit 8 për vendimin e KPK-së në çështjen e saj.

132. Neni 13 parashikon si më poshtë:

"Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.".

133. Kërkuesja argumentoi se nuk i ishte dhënë një zgjidhje efektive për të kundërshtuar shkarkimin e paligjshëm, arbitrar dhe të dhënë para kohe. Ajo iu referua mangësive në procesin e *vetting*-ut dhe procedurave specifike të *vetting*-ut ndaj saj, veçanërisht përpara KPA-së. Gjithashtu, ajo iu referua pamundësisë për të depozituar një ankesë kushtetuese (neni A § 1 i aneksit të Kushtetutës).

134. Qeveria nuk ra dakord.

135. Për sa ka të bëjë me faktin se kërkuesja e ka lidhur ankesën e saj në mbështetje të nenit 13 me ankesat e saj procedurale (shih paragrafët 60–63 dhe 94 më sipër), pjesa civile e nenit 6 § 1 të Konventës është *lex specialis* (shih *Grzeda kundër Polonisë, [DHM],* nr. 43572/18, § 352, 15 mars 2022). Gjithashtu, duke pasur parasysh se ankesat sipas nenit 6 janë të papranueshme, Gjykata arrin në përfundimin se ky aspekt i ankesës, sipas nenit 13 duhet të rrëzohet si i papranueshëm.

136. Në lidhje me nenin 13 për ankesën sipas nenit 8 në kontekstin e procedurave të *vetting*-ut, kërkuesja depozitoi një apelim ndaj vendimit të KPK-së, i cili urdhëronte shkarkimin e saj nga detyra. KPA-ja, e cila kishte juridiksion të plotë ndaj çështjeve të faktit dhe ligjit, shqyrtoi meritat e apelimit të saj, duke përfshirë padrejtësinë dhe shpërpjesëtimin e shkarkimit të saj nga detyra. Fakti se KPA-ja e rrëzoi apelimin e saj nuk është mjaftueshëm për Gjykatën të vendosë se kjo nuk ishte një zgjidhje efektive (shih *Xhoxhaj*, cituar më sipër, §§ 286 dhe 416). Në këto rrethana, Gjykata vendos se kjo pjesë e ankesës duhet të rrëzohet si e pambështetur në fakte në përputhje me nenin 35 §§ 3 (a) të Konventës.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA,

1. E deklaron, në mënyrë unanime, ankesën në mbështetje të nenit 8 të Konventës (në lidhje me shkarkimin nga detyra) të pranueshme;

2. Deklaron, me shumicë, pjesën tjetër të kërkesës të papranueshme;

3. Vendos, me gjashtë vota pro dhe një kundër, se nuk është shkelur neni 8 i Konventës.

Hartuar në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më datë 13 dhjetor 2022, sipas Rregullit 77 §§ 2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

Milan Blaško
SEKRETAR

Pere Pastor Vilanova
KRYETAR

Në mbështetje të nenit 45 § 2 të Konventës dhe Rregullit 74 § 2 të Rregullores së Gjykatës, opinioni i Gjyqtarit Serghides i është aneksuar këtij vendimi.

OPINIONI PJESËRISHT KUNDËRSHTUES I GJYQTARIT SERGHIDES

1. Unë jam dakord me paragrafin 1 të përcaktimeve operative të vendimit ku gjykohet se ankesa sipas nenit 8 të Konventës është e pranueshme.

2. Megjithatë, nuk bie dakord me paragrafin 2 të përcaktimeve operative të vendimit sipas së cilit pjesa tjetër e kërkesës është e papranueshme. Veçanërisht, jam i mendimit, se ankesa sipas nenit 6 të Konventës, jo vetëm që është e pranueshme, por është shkelur edhe ky nen, pasi procedurat e *vetting*-ut që vendosën për shkarkimin e kërkueses si prokurore nuk ishin të drejta sipas interpretimit të nenit 6 § 1. Gjithashtu nuk bie dakord me paragrafin 3 të përcaktimeve operative, ku gjykohet se nuk është shkelur neni 8 i Konventës.

3. Ky opinion merr formën e një deklarate ku nuk bihet dakord me vendimin ("thjesht një deklaratë mospajtimi"), në lidhje me paragrafët 2 dhe 3 të përcaktimeve orperative (në lidhje me ankesat, sipas neneve 6 dhe 8 të Konventës, respektivisht) dhe për këtë arsye nuk merr formën e një opinioni të veçantë me të drejta të plota apo formën e një vote të thjeshtë anonime kundër këtyre paragrafëve. Një deklaratë mospajtimi me vendimin ose një pjesë të tij është një zgjidhje alternative e parashikuar nga Rregulli 74 § 2 i Rregullores së Gjykatës për gjyqtarët që dëshirojnë të shprehin mospajtim. Ky opinion është veçanërisht i përshtatshëm për mua në çështjen konkrete, pasi unë tashmë kam shprehur këndvështrimet e mia edhe në dy kërkesa disi të

ngjashme kundër Shqipërisë (shih, *mutatis mutandis,* qasjen time në opinionin kundërshtues në *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, nr. 15227/19, 9 shkurt 2021, dhe opinionin tim pjesërisht pajtues dhe pjesërisht kundërshtues në *Besnik Cani kundër Shqipërisë,* nr. 37474/20, 4 tetor 2022 (ende jo i formës së prerë)).

VENDIM
Nr. 26, datë 16.5.2023

NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj,	kryetare;
Marsida Xhaferllari,	anëtare;
Elsa Toska,	anëtare;
Sonila Bejtja,	anëtare;
Sandër Beci,	anëtar;
Ilir Toska,	anëtar;
Genti Ibrahimi,	anëtar;
Marjana Semini,	anëtare;
Fiona Papajorgji,	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 16.5.2023, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 14 (E) 2022 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Bejaze Veizaj, Tefta Veizaj, Esat Veizaj

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Valter Veizaj, Mirka Veizaj, Violeta Veizaj, Pajtim Veizaj, Astrit Veizaj, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë

OBJEKTI: Ndreqje gabimi në vendimin nr. 31, datë 3.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese.

BAZA LIGJORE**:** Neni 80, i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar *(ligji nr. 8577/2000).*

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi kërkesën e kërkuesve, të cilët kanë kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjekteve të interesuara, Valter Veizaj dhe Mirka Veizaj, që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjekteve të tjera të interesuara, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I
Rrethanat e çështjes

1. Shtetasit Bejaze Veizaj, Tefta Veizaj dhe Esat Veizaj, me kërkesën e datës 18.2.2022, i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese *(Gjykata*) për shfuqizimin e vendimeve nr. 752, datë 29.3.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, nr. 1158, datë 21.10.2015 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe nr. 00-2021-1694, datë 18.10.2021 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

2. Gjykata, me vendimin nr. 31, datë 3.11.2022, ka vendosur: "*1. Pranimin pjesërisht të kërkesës. 2. Shfuqizimin e vendimit nr. 1158, datë 21.10.2015 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe vendimit nr. 00-2021-1694, datë 18.10.2021 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. 3. Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit Vlorë.".*

3. Pas publikimit të vendimit të Gjykatës, në datën 9.12.2022, njëri nga kërkuesit në atë gjykim kushtetues, Esat Veizaj, ka paraqitur kërkesë për saktësimin e vendimit, konkretisht për ndreqjen e paragrafit 1 të vendimit nr. 31, datë 3.11.2022, sipas të cilit: *"1. Kërkuesit Bejaze Veizaj, Tefta Veizaj dhe Esat Veizaj janë trashëgimtarë të shtetasit H. V. (gjyshi i tyre), 3 fëmijët e të cilit (baballarë të paditësve dhe të padituve në procesin gjyqësor të kundërshtuar), pasi ai ka ndërruar jetë, kanë ndarë në tri pjesë, secila me hyrje më vete, pasurinë e paluajtshme banesë dykatëshe, e ndodhur në lagjen "Partizani" në qytetin e Vlorës, të regjistruar në emër të djalit Z.V.".*

4. Sipas kërkuesit, në këtë paragraf ka pasaktësi, sepse kërkuesit janë trashëgimtarë të shtetasit Z.V dhe jo të shtetasit H.V. Bejaze Veizaj në të vërtetë është bashkëshortja e shtetasit Z.V., ndërsa Tefta dhe Esat Veizaj janë fëmijët e Bejaze Veizajt dhe të shtetasit Z.V. Ky i fundit është trashëgimtar ligjor i shtetasit H.V., ndërsa pasuria, sipas ligjit të kohës, është pasuri bashkëshortore e Bejaze Veizaj dhe Z.V., e fituar gjatë martesës.

5. Me vendimin e datës 27.1.2023, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e kësaj çështjeje për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve. Në datën 7.4.2023, të tre kërkuesit kanë saktësuar se ndreqjen e gabimit në vendimin nr. 31, datë 3.11.2022 e kanë kërkuar shtetasit

Bejaze Veizaj, Tefta Veizaj dhe Esat Veizaj (pala kërkuese në këtë vendim).

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

6. ***Kërkuesit*** kanë pretenduar se paragrafi nr. 1, i vendimit nr. 31, datë 3.11.2022, ka pasaktësi, sepse kërkuesit janë trashëgimtarë të shtetasit Z.V. dhe jo të shtetasit H.V., ndërsa pasuria e paluajtshme, sipas ligjit të kohës, është pasuri bashkëshortore e fituar gjatë martesës midis shtetasve Z.V. dhe Bejaze Veizaj. Sipas tyre, subjektet e interesuara në atë gjykim kanë paraqitur dokumente të falsifikuara, duke shtrembëruar faktet dhe rrethanat e çështjes.

7. ***Subjektet e interesuara, Valter Veizaj dhe Mrika Veizaj,*** kanë prapësuar se kërkesa është abuzive, pasi vendimi nr. 31, datë 3.11.2022 nuk ka gabime në shkrim, është i qartë dhe lehtësisht i kuptueshëm.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

8. Në rastet kur Gjykata vihet në lëvizje për ndreqjen e gabimit në vendimin e saj, legjitimimi i kërkuesit dhe procedura parashikohen në nenin 80, të ligjit nr. 8577/2000. Sipas kësaj dispozite, Gjykata ka të drejtë, me kërkesë, të ndreqë gabimet në shkrim, në llogari ose ndonjë pasaktësi të dukshme të lejuar në vendim, pa ndryshuar thelbin e vendimmarrjes, brenda 2 muajve nga shpallja e vendimit. Vendimi i Gjykatës në këto raste publikohet në Fletoren Zyrtare. I njëjti rregull parashikohet edhe në nenin 43, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, sipas të cilit kur kërkesa ka të bëjë me një vendim përfundimtar, kompetente për shqyrtimin e saj është Gjykata.

9. Në këto kushte, Gjykata, pasi administroi vendimin e saj nr. 31, datë 3.11.2022, konstaton se kërkuesit, si palë pjesëmarrëse në gjykimin e mëparshëm që është përmbyllur me vendimin që kërkohet të ndreqet, plotësojnë kriterin për legjitimimin *ratione personae* të tyre. Po ashtu, vërehet se ata i janë drejtuar Gjykatës në datën 9.12.2022, ndërsa vendimi objekt kërkese është dhënë nga kjo Gjykatë në datën 3.11.2022. Për rrjedhojë, kërkuesit legjitimohen edhe *ratione temporis,* pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 2-mujor të parashikuar në nenin 80, të ligjit nr. 8577/2000.

10. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae*, në kuptim të kompetencës lëndore të Gjykatës, vihet re se kërkuesit në kërkesën e tyre kanë pretenduar ndreqjen e gabimit të vendimit nr. 31, datë 3.11.2022, pasi në paragrafin 1 të tij ka pasaktësi si në lidhje me trashëgimtarët e shtetasit Z.V., ashtu edhe me pronësinë e pasurisë së paluajtshme.

11. Gjykata vëren se me vendimin nr. 31, datë 3.11.2022, është vendosur kthimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit Vlorë, për shkak se u konstatua cenimi i së drejtës së aksesit të kërkuesve në atë gjykatë. Në paragrafin 1 të vendimit të lartpërmendur është bërë një gabim material në lidhje me faktin se shtetasja Bejaze Veizaj nuk është trashëgimtare e shtetasit H.V., por e bashkëshortit të saj Z.V., i cili është djali i H.V., kurse Esat dhe Tefta Veizaj janë fëmijët e Bejaze Veizaj dhe Z.V. Gjykata konstaton se faktet në lidhje me të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme janë objekt i gjykimit që po zhvillohet në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm dhe sipas materialeve të depozituara në gjykimin kushtetues, konkretisht notës së transkriptimit 11, volumi XVII, viti 1953, në emër të Z.V. rezulton e regjistruar pasuria e paluajtshme banesë dykatëshe, e ndodhur në lagjen "Partizani" në qytetin e Vlorës.

12. Për sa më lart, duke qenë se përmbajtja e vendimit nr. 31, datë 3.11.2022, ka një gabim material në lidhje me trashëgimtarët e H.V., dhe ndreqja e tij nuk ndryshon thelbin e vendimmarrjes, Gjykata vlerëson se kërkimi për saktësimin e këtij vendimi duhet të pranohet. Ndërsa për sa i përket pretendimit tjetër të kërkuesve që ka të bëjë me pasurinë e paluajtshme, objekt i konfliktit gjyqësor, ai do t'i nënshtrohet vlerësimit të gjykatave të zakonshme gjatë rishqyrtimit të çështjes, ndaj nuk mund të merret në shqyrtim.

13. Si përfundim, paragrafi 1 i vendimit nr. 31, datë 3.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese, bëhet: *"Kërkuesit janë trashëgimtarë ligjorë të Z.V., ky i fundit djali i H.V. Në emër të Z.V. rezulton e regjistruar pasuria e paluajtshme banesë dykatëshe, e ndodhur në lagjen "Partizani" në qytetin e Vlorës."*.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, bazuar në nenin 80, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Saktësimin e paragrafit 1 të vendimit nr. 31, datë 3.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese, i cili bëhet si vijon: *"Kërkuesit janë trashëgimtarë ligjorë të Z.V., ky i fundit djali i H.V. Në emër të Z.V. rezulton e regjistruar pasuria e paluajtshme banesë dykatëshe, e ndodhur në lagjen "Partizani" në qytetin e Vlorës."*.

2. Një kopje e këtij vendimi i bashkohet vendimit përfundimtar nr. 31, datë 3.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese.

3. Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 16.5.2023.
Shpallur më 15.6.2023.

Kryetare: Holta Zaçaj
Anëtarë: Elsa Toska, Marsida Xhaferllari, Ilir Toska, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Fiona Papajorgji, Marjana Semini, Genti Ibrahimi

VENDIM
Nr. 328, datë 14.6.2023

PËR NJË NDRYSHIM DHE SHTESË NË VENDIMIN NR. 271, DATË 25.5.2023, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR, "PËR FILLIMIN E FUNKSIONIMIT TË GJYKATËS ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË TIRANË TË RIORGANIZUAR"

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 135, pika 1, 147, pika 1, 147/a, shkronja "ë", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 13 dhe 66, të ligjit nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; nenin 44, të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe nenin 61, paragrafi 2, shkronja "ë", të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

VENDOSI:

1. Në nenin 7, të vendimit nr. 271, datë 25.5.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, "Për fillimin e funksionimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë të riorganizuar" bëhet ky ndryshim dhe shtesë si më poshtë:

a) pas togfjalëshit "Gjykata Administrative" nyja e përparme "*të*" ndryshon dhe zëvendësohet me nyjën e përparme "*ë*";

b) pas togfjalëshit "Gjykata Administrative të Shkallës së Parë Tiranë" duhet shtuar togfjalëshi "*brenda muajit korrik 2023,*",

pra neni 7 i vendimit të sipërcituar ndryshon si më poshtë:

"*Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, brenda muajit korrik 2023, mbështetur në legjislacionin në fuqi, përmbush të gjitha detyrimet dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga mbyllja, në datën 30.6.2023, e aktivitetit ekonomiko-financiar të gjykatave administrative të shkallës së parë Durrës, Korçë dhe Shkodër.*".

Ky vendim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
KRYETARE
Naureda Llagami

URDHËR
Nr. 81, datë 16.6.2023

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; ligjit nr. 9887/2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të ndryshuar; si dhe rregullores së brendshme të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, miratuar me urdhrin e Komisionerit nr. 71, datë 21.5.2021, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave për nënshkrimin e akteve administrative në kompetencë të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sipas rregullores së institucionit, te znj. Elona Hoxhaj, drejtor i përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme për të Drejtën e Informimit, nga data 19.6.2023 deri në datë 23.6.2023.

2. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONER
Besnik Dervishi

NJOFTIM
Nr. 9097/1, datë 13.6.2023

PËR KORRIGJIMIN E DATËS SË HYRJES NË FUQI TË DISA MARRËVESHJEVE NDËRKOMBËTARE

1. Marrëveshja për lirinë e lëvizjes me kartë identiteti në Ballkanin Perëndimor, nënshkruar në Berlin, më 3.11.2022, ka hyrë në fuqi më 1.6.2023.

2. Marrëveshja për njohjen e kualifikimeve profesionale të mjekëve, stomatologëve dhe arkitektëve në kontekstin e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore, nënshkruar në Berlin më 3.11.2022, ka hyrë në fuqi më 1.6.2023.

3. Marrëveshja për njohjen e kualifikimeve të arsimit të lartë në Ballkanin Perëndimor, nënshkruar në Berlin, më 3.11.2022, ka hyrë në fuqi më 1.6.2023.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I MINISTRISË PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME
Gazmend Turdiu

KËRKESË
Nr. 107/5, datë 16.6.2023

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit 'Rikonstruksioni i rrugës 'Kastriot Muço' (nga kryqëzimi me rrugën 'Mujo Ulqinaku', deri në intersektin me hekurudhën) Fier"', me vlerë totale paraprake të shpronësimit 5,069,137.30 (pesë milionë e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e tridhjetë e shtatë pikë tridhjetë) lekë.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Fier.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohet sipas vlerësimit paraprak të llogaritur:

Për pasuritë e llojit "truall", bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë".

Për pasuritë e llojit "ndërtesë" është bërë bazuar në VKM-në nr. 138, datë 23.8.2000, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive, pronë private, që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", të ndryshuar.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara, për përfundimin e procedurave të shpronësimit, pranë Bashkisë Fier, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 5,069,137.30 (pesë milionë e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e tridhjetë e shtatë pikë tridhjetë) lekë.

DREJTOR I PËGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM TË SHPRONËSIMEVE
Egra Ibrahimi

LISTA EMERORE PARAPRAKE E PRONARËVE QE SHPRONËSOHEN PËR PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "RIKONSTRUKSIONI I RRUGËS 'KASTRIOT MUÇO' (NGA KRYQËZIMI ME RRUGËN 'MUJO ULQINAKU', DERI NË INTERSEKTIN ME HEKURUDHËN) FIER"

Nr	Emër Atësia Mbiemër	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. e truallit gjithsej (m^2)	Sip. e ndërtesës (m^2)	Sip. e truallit që preket (m^2)	Sip. e objektit te shërbimit (m^2)	Çmimi i objektit të banimit (l/m2)	Çmimi i truallit (l/m^2)	Vlera e objektit të shërbimit sipas situacionit (lek)	Vlera e objektit të banimit (lek)	Vlera e truallit (lek)	Vlera totale (lek)	Shënime	Konfirm. ASHK
1	Trifon Koli Mërtiri	8533	8/399	Truall	419.5	128.7	17.3			11,026.0		-	190,749.80	190,749.80		Me certifikatë pronësie
2	Gezim Nuredin Haxhiaj	8533	2/201	Truall	180	65	5			11,026.0		-	55,130.00	55,130.00		Me certifikatë pronësie
3	Gezim Nuredin Haxhiaj	8533	2/359	Truall	80	30	10.9			11,026.0		-	120,183.40	120,183.40		Me certifikatë pronësie
4	Astrit Merkaj	8533	2/358	Truall	300	60	17.6			11,026.0		-	194,057.60	194,057.60		Me certifikatë pronësie
5	Hajrije Sadik Ristani, Nikollaq Llazi Ristani	8533	2/425	Truall	210.2	162.4	35	28		11,026.0	790,498.0	-	385,910.00	1,176,408.00	Me ref. 0018654 dhe me vendim legalizimi nr. 675, datë 29.9.2021, regjistrohet objekti godinë e kombinuar dy kate. (2) + parcela ndërtimore miratuar me ligjin nr. 20/2020, neni 22 (faturat datë 9.11.2021), kati përdhe 162.4 m2 (sip. funksion ekonomik 148 m^2, sip. funksion banimi 14 m2) parcela ndërtimore 210.2 m^2.	Me certifikatë pronësie
6	Llazar Sotir Sota	8533	2/175	Truall	326	61	21.5			11,026.0		-	237,059.00	237,059.00		Me certifikatë pronësie
7	Blerina Dhimo Sota, Bora Dhimo Sota, Violeta Mihal Sota	8533	2/136	Truall	293	92	13			11,026.0		-	143,338.00	143,338.00		Me certifikatë pronësie
8	Maksim Miti Sota	8533	2/176	Truall	550	102	33.85			11,026.0		-	373,230.10	373,230.10		Me certifikatë pronësie
9	Pandeli Irakli Shukallari, Luljeta Piro Shukallari	8533	2/379	Truall	296	52	18.2			11,026.0		-	200,673.20	200,673.20		Me certifikatë pronësie
10	Agron Luli Naçi, Merita Piro Naçi	8533	2/380	Truall	317	52	27.4			11,026.0		-	302,112.40	302,112.40	Plotësim dokumentacioni.	Me certifikatë pronësie
11	Kristaq Nasi Rrapushi	8533	2/360	Truall	390	72	28.3			11,026.0		-	312,035.80	312,035.80		Me certifikatë pronësie
12	Maksim Refat Hodaj	8533	2/179	Truall	860	81.0	160.00			11,026.0		-	1,764,160.00	1,764,160.00		Me certifikatë pronësie
13	Pronar i Pavërtetuar	8533	2/171	Truall	237	93.0	14.60						-		Sipas informacionit zyrtar nga ASHK FIER dt. 9..6.2022.	
14	Pronar i Pavërtetuar	8533	2/170	Truall	531	179.0	30.00						-		Sipas informacionit zyrtar nga ASHK FIER dt. 9.6.2022.	
15	Pronar i Pavërtetuar	8533	2/135	Truall	330	90.0	20.00						-		Sipas informacionit zyrtar nga ASHK FIER dt. 9.6.2022.	
16	Shtet	8533	8/114	Truall	381		29.40						-		Sipas informacionit zyrtar nga ASHK FIER dt. 9.6.2022.	
17	Shtet	8533	8/117	Truall	429		37.44						-		Sipas informacionit zyrtar nga ASHK FIER dt. 9.6.2022.	
18	Shtet	8533	8/38	Truall	724		18.64						-		Sipas informacionit zyrtar nga ASHK FIER dt. 9.6.2022.	
19	Shtet	8533	8/400	Truall	203.5	49.3	8.30						-		Sipas informacionit zyrtar	

															nga ASHK FIER dt. 9.6.2022.	
20	Pasuri pa informacion	8533	8/3				13.80						-		Sipas informacionit zyrtar nga ASHK FIER dt. 9.6.2022.	
21	Pasuri pa informacion	8533	8/4				17.89						-		Sipas informacionit zyrtar nga ASHK FIER dt. 9.6.2022.	
22	Pronar i pavërtetuar	8533	2/281	Truall	394	50.0	23.80						-		Sipas informacionit zyrtar nga ASHK FIER dt. 1.3.2023.	
23	Shtet	8533	8/448	Truall	232.9		12.30						-		Sipas informacionit zyrtar nga ASHK FIER dt. 1.3.2023.	
24	Pasuri pa informacion	8533	8/490				36.75						-		Sipas informacionit zyrtar nga ASHK FIER dt. 1.3.2023.	
25	Pasuri pa informacion	8533	8/45				55.40						-		Sipas informacionit zyrtar nga ASHK FIER dt. 1.3.2023.	
SHUMA TOTALE														**5,069,137.30**		

Shënim:

1. Vlerësimi i tokës truall është llogaritur bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë".

2. Për pasuritë e llojit "ndërtesë" vlerësimi është bërë bazuar në VKM-në nr. 138, datë 23.8.2000, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive, pronë private, që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", të ndryshuar.

KËRKESË
Nr. 377/6, datë 14.6.2023

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësim shpall për disa shtesa në VKM-në nr. 866, datë 27.12.2022, "Për shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor 'Sistemim asfaltim e masa inxhinierike në km 21+050-22+050 në rrugën Qafëthanë–Lin–Pogradec"'.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, për pasuritë e llojit "arë", sipas VKM-së bazë nr. 866, datë 27.12.2022, në të cilën në mungesë të çmimit të zërit kadastral të llojit "arë", në VKM-në nr. 89/2016, është marrë çmimi i zonës më të afërt, në masën 192 lekë/m^2.

Personat që preken nga ky projekt të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në listë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Autoritetin Rrugor Shqiptar, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësim.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 199,680 (njëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Egra Ibrahimi

LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE QË PREKEN NGA PROJEKTI PËR DISA SHTESA NË VKM-në NR. 866, DATË 27.12.2022, "PËR SHPRONËSIM, PËR INTERES PUBLIK, PËR PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR 'SISTEMIM ASFALTIM E MASA INXHINIERIKE NË KM 21+050-22+050' NË RRUGËN QAFËTHANË–LIN–POGRADEC"

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Të dhënat e pasurisë			Tokë "arë"				Vlera totale (lekë)	Shënime (të konfirmuar nga ASHK-ja)
				Zona kadastrale	Numri i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. totale m^2	Sipërfaqja e shpronësuar (m^2)	Çmimi (lekë/m^2)	Vlera lekë		
1	Vangjo	Jovan	Gjika	8582	20/105	Vreshtë	1,270.00	655	192	125,760.00	125,760.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
2	Aleks	Kajo	Topalli	8582	20/171	Arë	500.00	385	192	73,920.00	73,920.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
	SHUMA TOTALE									199,680.00	199,680.00	

NR. REGJ. THEM. (1447)
Korçë, më datë 15.6.2023

SHKURTIM VENDIMI

PËR FILLIMIN E PROCEDURËS SË FALIMENTIMIT

Sot, më datë 15.6.2023, unë gjyqtarja Eglantina Mikani, gjyqtare pranë Gjykatës të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, pasi mora në rishqyrtim në dhomë këshillimi aktet e çështjes civile regjistruar me nr. 1447, e cila i përket:

Kërkues: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Tiranë, me adresë: bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3, Tiranë

Person i tretë: Shoqëria "Mika Korçë" sh.a., me NIPT: J64103104K, me adresë: Unaza e Qytetit, Korçë.

Me objekt: Për fillimin e procedurës së falimentimit.

Baza ligjore: Nenet 9, 11, 13, 14, 17 të ligjit nr. 1 10/2016, datë 27.10.2016, "Për falimentimin", si dhe aktin e ekspertimit datë 25.5.2023 të hartuar nga eksperti kontabël z. Luan Muça (i licencuar si auditues ligjor/administrator falimenti), bazuar në nenet 306-310 të K. Pr. Civile, nenin 29 e vijues të ligjit nr. 110/2016, datë 27.10.2016, "Për falimentimin", ndër të tjera,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës së palës kërkuese, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Tiranë.

2. Fillimin në datë 15.6.2023 të procedurës së falimentimit të shoqërisë "Mika Korçë" sh.a., me veprimtari të saj: "grumbullimin e duhanit nga fermerët, përpunimin dhe eksportimin e duhanit; shfrytëzimin dhe rinovimin e aseteve ekzistuese, si dhe ndërtimin e aseteve të reja përpunuese të duhanit; zbatimin e teknologjive të reja për përpunimin dhe fermentimin e duhanit; dhënien e ndihmës shkencore agronomike me teknologji në fushën e kultivimit të duhanit, fermerëve privatë; etj. ..." me NIPT: J64103104K, me seli në adresën: Unaza e Qytetit, Korçë, Shqipëri.

3. Caktimin si administrator të falimentimit për shoqërinë "Mika Korçë" sh.a., z. Luan Muça, i datëlindjes 18.9.1961, me nr. personal identifikimi G10918009M, mbajtës i licencës me nr. 11, datë 15.10.2012 (administrator falimentimi), me adresë: Tepelenë, lagjja "Demokracia", tek ish-zyrat e N.T.A. dhe NIPT: K38708553S.

4. Urdhërohet publikimi/botimi i një kopjeje të shkurtuar të vendimit në faqen zyrtare të Gjykatës të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, të Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe në Fletoren Zyrtare.

5. T'i kërkojë çdo personi ose subjekti që pretendon të jetë kreditor i debitorit për të paraqitur pretendimet e tij ndaj administratorit të falimentimit z. Luan Muça, brenda 45 ditëve nga publikimi i vendimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

6. Të caktojë datën 28.9.2023, ora 11:00, si datë në të cilën do të mbahet mbledhja mbi raportimin e kreditorëve të shoqërisë "Mika Korçë" sh.a.

7. T'i kërkojë çdo personi fizik ose juridik, i cili ka detyrime ndaj debitorit, shoqërisë "Mika Korçë" sh.a. t'ia paguajë ato ndaj administratorit të falimentimit z. Luan Muça.

8. Administratori i falimentimit z. Luan Muça t'i paraqesë një kopje të përmbledhur të vendimit secilit prej kreditorëve të njohur të debitorit.

9. Administratori i falimentimit z. Luan Muça të paraqesë menjëherë një kopje të vendimit për fillimin e procedurës së falimentimit në organin e regjistrimit, i cili disponon regjistrin tregtar ku pala debitore shoqëria "Mika Korçë" sh.a. figuron e regjistruar.

10. Administratori i falimentimit z. Luan Muça t'i komunikoje vendimin e fillimit të procedurës së falimentimit Zyrës Qendrore të ASHK-së, me qëllim bërjen e shënimeve përkatëse në regjistrat e pasurive të paluajtshme për çdo pasuri të paluajtshme ku debitori është regjistruar si pronar, si dhe për të gjitha të drejtat e tjera ligjore të debitorit, të regjistruara në regjistrin e pasurive të paluajtshme.

11. Administratori i falimentimit z. Luan Muça të komunikojë vendimin e fillimit të procedurës së falimentimit në të gjithë regjistrat e tjerë publikë, duke përfshirë, por pa u kufizuar, në regjistrin e barrëve siguruese dhe regjistrat e autoriteteve të tjera publike që janë përgjegjëse për regjistrimin e pasurive ose të të drejtave të tjera të debitorit mbi pasuritë që përbëjnë masën e falimentimit.

12. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë "Mika Korçë" sh.a. t'i njoftohet palës kërkuese, Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë, Tiranë, si përfaqësuese e aksionarit shtet, në cilësinë e debitorit të shoqërisë "Mika Korçë" sh.a.; administratorit të falimentimit të kësaj shoqërie z. Luan Muça, si dhe vetë shoqërisë "Mika Korçë" sh.a. (për këtë të fundit nëpërmjet shpalljes publike).

13. Një kopje e vendimit për fillimin e procedurës së falimentimit të shoqërisë "Mika Korçë" sh.a. t'i dërgohet Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe Qendrës të Botimeve Zyrtare, me qëllim publikimin e shkurtimit të tij.

14. Shpenzimet gjyqësore, të cilat përbëhen nga tarifa mbi aktet, shpenzimet për ekspertin dhe shpenzimet për njoftimet, bazuar në nenin 106 të Kodit të Procedurës Civile, i ngarkohen palës kërkuese.

15. Kundër këtij vendimi pala kërkuese ka të drejtë të bëjë ankim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në Tiranë, brenda 15 ditëve, afat ky që fillon nga e nesërmja e njoftimit të arsyetuar të tij.

Korçë, sot, më datë 15.6.2023.

GJYQTARE
Eglantina Mikani

KËRKESË

Shtetasi Demo Lumani kërkon, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, shpalljen e vdekjes së shtetases Violeta Miço Shqevi në datën 7.3.1997.

KËRKUES
Demo Lumani

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2023 - Numri: 91
Datë: 2023/06/22 13:56:50
fc41dce2-c1a6-4046-90da-731219b495f6

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 256 lekë